

## PROCESVERBALI

Nga mbledhja IX-të e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 31.07.2018, duke filluar nga ora 10:20, në sallën e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm 39 anëtarë.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, OSBE-ja, Zyra e EULEX-it, KFOR-it dhe përfaqësuesit e medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Artan Abrashi, kryesues.

Kryesuesi, ftoj Kuvendin për një minutë heshtje për vdekjen e Adem Demaçit.

U mbajt një minutë heshtje nga ana e Kuvendit.

**Kryesuesi:** Më qenë se procesverbali nuk ka qenë gati për këtë mbledhje, pasi që personat përgjegjës kanë qenë në pushime, atëherë procesverbali i mbledhjes së kaluar shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme. Atëherë kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin e rendit të ditës për këtë mbledhjeje.

Për këtë mbledhje janë paraparë këto pika për:

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
2. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
3. Shqyrtim – diskutim për Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Prizrenit, për vitin 2017;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimvendimit për themelimin e Komisionit Komunal, për zgjedhjen e këshillave, të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, në territorin e Komunës së Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimvendimit për formimin e Komisionit për Themelimin e Orkestrës së Komunës së Prizrenit;
6. Informatë mbi raportin e performancës së Komunës së Prizrenit për vitin 2016 – 2017;
7. Shqyrtimi i raportit financiar për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2018;
8. Informatë për përfundimin e vitit shkollor;

9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimvendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-4, të datës 29 dhjetor 2005;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimvendimit për shpalljen e ankandit-tenderit publik për dhënie në shfrytëzim-qira të objekteve dhe lokaleve pronë komunale;
11. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës, Nr. 001/011-96211, të datës 28 qershor 2018, sipas rekomandimeve të MMPH-së.

**Pika e parë:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesi**, a ka dikush të shtoi diçka për rënd dite të cilin e kemi paraparë për këtë mbledhje.

**Alush Shala (PDK):** Ne, në KPF, jemi marrë vesh për krijimin e komisionit për orkestrën e qytetit, por jo për filarmoni. Sepse as me ligj nuk parashihet që komunat të kenë filarmoni. Kemi ra dakord thuaja të gjithë, që një buxhet çfarë i duhet një filarmonie, minimum shkon në 1.000.000 € nuk kemi aspak mundësi për ta bërë. Andaj, nëse flitet për politikë, apo për t'ia bërë qejfin dikujt që do të bëjmë shef këtu apo kudo, nuk është mirë që ne të flasim para qytetarëve të komunës. Sa i përket orkestrës së qytetit, PDK-ja dhe unë personalisht jemi dakord, ndërsa për filarmoni mendoj që as s'ka mundësi as kushte.

**Kryesuesi:** Ajo ka shkuar tashmë si propozim i KPF-së. Kështu që e diskutojmë këtë në pikën kur të vije radha.

**Shukri Quni (PDK):** Unë në mbledhjen e kaluar propozova që të hy në rend dite kthimi i vitit 1878, në emblemën e komunës së Prizrenit. Kështu që në këtë rend të ditës s'po e shoh sot. Apo është duke u përgatit, ajo është edhe më mirë. Po ne si kuvendarë kemi të drejtë me kërkua me hy në rend dite çdo pikë. Ajo a hynë në rend dite a jo, varët edhe prej kolegëve këtu, se kjo qitet edhe në votim. Nëse kolegët kuvendarë nuk janë për me diskutua edhe mu kthye viti 1878 në emblemën e komunës së Prizrenit, atëherë vota është ajo që e përcakton. Këtë duhet me marrë seriozisht dhe me diskutua. Nuk është e thënë që mu bo kjo ad-hok, po mu përgatit kogja mirë, po jo me lënë në harresë. Po e shoh që bile as nuk është kah diskutohet. Unë këtë çështje do ta diskutoi sa herë ka me pas mbledhje Kuvendi. Sepse pikërisht jeni ju që keni protestua para Kuvendit komunal. Edhe hala është ngjyra aty që nuk është heq, po shkelim për çdo ditë. Çdo ditë po shkelim mbi gjakun e dëshmorëve. Se kur është derdhë

ajo ngjyrë, e keni konsideruar se ajo është gjak i dëshmorëve. Ngjyra nuk është gjak, këtë mos të harrojmë. Edhe nuk është mirë me luajt me ato. Se duhet gjithnjë njeriu me mendua se çka do të vjen edhe nesër. E për atë kam me qenë këmbëngulës. Lirisht mos të më përkrahë askush, edhe kolegët e mi kuvendarë të PDK-së. Po këta nuk e kanë përjetua atë protestën aty para Kuvendit komunal, e kam përjetua unë. Kogja është dashtë mu matë mirë, besa edhe Hazizi po edhe Fatmiri. Edhe mi dhënë shumë hapit me kapërcye atë. E kështu që do ta kesh për çdo mbledhje këtë kërkesë që me hy në rend të ditës. A hynë a kthehet a s'kthehet ajo nuk varët as prej meje as prej teje. Është vota ajo që e përcakton.

**Kryesuesi:** Nëse nuk ka dikush diçka tjetër të shtoi rreth rendit të ditës, atëherë 39 anëtarë jemi prezentë në sallë dhe e hedhë në votim këtë propozim për rend dite, kush është për?

Për?- 31.

Kundër? – 2.

Abstenim? – 6.

Me 31 vota për, 2 kundër dhe 6 abstenime aprovohet rendi i ditës i propozuar për këtë mbledhje.

**Pika e dytë:**

**Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme.**

**Adem Shabanaj (LVV):** Unë sot nuk kam ndonjë pyetje apo çështje për të ngritë. Mirëpo propozoj dhe kërkoj nga organet kompetente, si zyra e kryesuesit dhe kryetarit edhe nga Kuvendi këtu, që për seancën tjetër të shtohet si pikë e rendit të ditës emërimi i bibliotekës ndërkomunale me emrin e veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare Adem Demaçi.

**Simir Krasniqi (PDK):** Unë kam disa pyetje që do ti paraqes sot. Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike Levent Kasemin. Pasi që di herë është bërë kërkesë nga banorët e fshatit Jeshkovë për ndërtimin e kanalizimit, sepse në këtë fshat nuk ka kanalizim dhe është nevojë urgjente për ndërtimin e kanalizimit. Andaj të gjendet mundësia me rishikim të buxhetit. Edhe pse këtë vit nuk do të ketë rishikim, por është e mundur, pasi që deri në 15% mund të ketë ndryshime planifikimi i buxhetit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2018. Të futet edhe ndërtimi i kanalizimit për fshatin Jeshkovë. Pyetja e dytë për kryetarin e komunës, për anulimin e konkursit për drejtorët e zëvendësdrejtorët

e shkollave të komunës së Prizrenit. Ne si kuvendarë të PDK-së, kërkojmë nga ju kryetar të na paraqitni shkeljet ligjore, që janë bërë në përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave. Ku drejtori i Arsimit Skender Susuri, në seancën e kaluar ka thënë, që unë i qëndroj mbrapa këtij konkursi dhe përzgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve. Dhe nuk do ta lejoj kryetarin Haskuka që ta anulohet konkursin. Ku nga ana e komisionit nuk ka shkelje ligjore. Janë respektuar në përpikëmeri dispozitat ligjore për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave, siç janë: Ligji për arsimin para universitar të Republikës së Kosovës me nr. 04L32. Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës 03L068. Udhëzimi administrativ me nr. 8/14 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit për shkolla. Kurse ju si sulltan anuloni konkursin. Nuk e di se ku mbeten fjalët e drejtorit të Arsimit Skender Susuri. Ku në deklaratat e tij patë thënë, që unë nuk do të lejoj që ky konkurs të anulohet. Në qoftë se është e nevojshme unë do të bëjë ankesë edhe në MASHT. Në qoftë se anulohet konkursi i përzgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve. Po ashtu ju pyes, pse e anuluar edhe konkursin e dytë të përzgjedhjes së drejtorëve edhe zëvendësdrejtorëve. Nuk po mundeni me i plotësuar kërkesat e partisë tuaj VV-së dhe marrëveshjes politike në mes të koalicionit apo ku qëndron problemi. Kërkoj një përgjigje nga ju kryetar.

**Dafina Blaca (PDK):** Unë sot kam disa çështje. Kërkoj nga kryetari i komunës, të na informoj në lidhje me pronat e shpallura dhe të aprovuara nga Kuvendi komunal në legjislaturën e kaluar. Si prona me interes nacional. Pronat e PIK Progresit, ngastra kadastrale, apo parcela është në lagjen “Jeta e Re” rruga Arbana konkretisht afër Spahi Petrol me nr. 615/1, 624 dhe 625/1. Kërkojmë që prona të pastrohet dhe e njëjta të rrethohet më qellim që të mund të shfrytëzohet nga komuniteti. Meqë pronat janë të aprovuara nga Kuvendi komunal, kërkoj nga kryetari që të negocioj me AKP-në dhe të jepen nën menaxhimin e bashkësisë lokale. Ku një veprim i tillë do të mundësonte realizimin e ndonjë projekti esenciale apo të domosdoshëm për këtë lagje të qytetit. Ku do të mund të ndërtojnë ndonjë çerdhe, ndonjë shkollë të bujqësisë, apo të bëhet ndonjë debat publike në lidhje me këtë hapësirë. Gjithashtu një ngastër tjetër kadastrale, është me numër 561/3, e cila duhet të merret më seriozisht, është ajo e stadiumit të futbollit ish Koritniku në lagjen “Jeta e Re”. Nuk kam burime të sigurta rreth pronësisë të kësaj ngastre kadastrale. Por besohet se figuron si pronë e Progresit. E ngrejë këtë çështje pasi është një shqetësim i qytetarëve. Duke kërkuar nga Kuvendi komunal të veproj urgjentisht të identifikohen këto parcela. Dhe të shpallet pronë me interes të përgjithshëm. Më qëllim të shfrytëzimit nga komuniteti. Banorët e lagjes “Arbanë” dhe “Jeta e Re”, kanë kërkuar nga Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe

Sport, që të mirëmbajnë këtë fushë të futbollit ish Koritniku. E cila ka mbetur si të ishte si një pronë e një shteti të huaj. Madje aty hudhën edhe mbeturina kërkojnë që të investohet në mirëmbajtje, si dhe në vendosjen e rrethojave. Kjo është diçka shumë urgjente, të vendosen rrethojat në këtë fushë. Që të ofrohen kushtet minimale ku të rinjtë e kësaj lagje të vazhdojnë traditë, që kishin ndër vite me sport. Në njërin nga seancat e kaluara kam paraqitur edhe shqetësimin lidhur me pronat e uzurpuara, u më është kthyer një përgjigje mjaftë jo serioze. Ku është thënë se nuk kemi informacione në lidhje me pronat e uzurpuara. Kjo është një papërgjegjësi e kësaj qeverie. Për shkak të neglizhencës dhe paafësisë së tyre, vuajnë qytetarët. Sepse shumë projekte mbesin të përealizuara për shkak të mungesë së hapësirës. Ku në realitet kemi shumë prona të uzurpuara. Por fatkeqësisht këto mbesin në mëshirën e një qeverie që ende bënë pazare të ndryshme. Lidhur me këtë çështje, unë posedoj dokumente të cilat vërtetojnë njërin nga pronat e uzurpuara të cilët do t'ia dorëzoj drejtorit të Urbanizimit, duke shpresuar që Drejtoria e Urbanizimit do të merr më seriozisht këtë çështje dhe do të kemi veprime konkrete.

**Bardh Avdaj (PDK):** Unë kam një pyetje për kryetarin Haskuka. Pas anulimit të konkursit për përzgjedhjen e drejtorëve të Arsimit, i cili u hudh në pah mllefi i atyre që udhëheqin me politikat ditore. Shtroj pyetjen si kryetar i komunës, a do të merr masa për shkarkimin e drejtorit të Arsimit. Po ju njoftoj për një rast! Si është e mundur që drejtor i një shkolle të përzgjidhet dikush i cili s'ka pasur asnjë ditë përvojë menaxheriale dhe i cili është bartur në punë në një fshat tjetër. Sa për t'ia dhënë kafshatën e gojës me dy nxënës. Dhe përzgjidhet drejtor në shkollën i cili ka qenë i përzgjedhur në shollën më të mirë në tre vitet e fundit. Andaj shtroj pyetjen. A nuk është kjo fyerje që u bëhet mësimdhënësve të kësaj shkolle. Fyerje që u bëhet qytetarëve të Prizrenit dhe institucioneve arsimore të komunës. A duhet dikush të jep përgjegjësi për këtë. Ky është vetëm një rast. Dhe jam i sigurt se ka shumë të ngjashme. Andaj shtroj pyetjen. A do të shkarkohet drejtori i Arsimit, sepse nuk mjafton vetëm anulimi i konkursit pas gjithë këtyre rasteve.

**Haziz Hodaj (LDK):** Unë më tepër e kam si kërkesë, po natyrisht edhe si pyetje. Para do kohe ne kemi themeluar një komision për fshatin Zym. Dhe ai komision sigurisht që është duke funksionuar dhe duke bërë punë. Mirëpo nga kryetari i komisionit është bërë një kërkesë në shërbimin teknik të komunës. Që zyra e lëshuar prej zyrës civile që është në Zym, nuk është e pajisur me asnjë pajisje që do duhej zyra me pas. As kompjuter as printer, as letër etj. gjërat elementare. Është bo një kërkesë të shërbimit teknik dhe përgjigja është kthye që është çështje e Kuvendit kjo. Atëherë unë nuk e di Kuvendi a është i kësaj komune apo i cilës komunë. Nuk është shumë problematike që të pajiset ajo



zyre me gjërat elementare dhe të funksionoj si duhet. Dhe pyetjen e dytë e kam për kryetarin e komunës. A është ndërmarrë diçka rreth zhbllokimit të rrugës “Ali Pashë Tepelena”. Ne kemi edhe përfaqësues të lagjes këtu. Fatmirësisht në atë lagje të gjitha partitë politike kemi shkua dhe premtuar se kjo rrugë do të zhbllokohet në afatin sa më të shkurtë të mundshëm. Kështu do ta pyesja kryetarin, do ta lusja që të ndërmerr diçka urgjente sepse ajo lagje mbi 200 shtëpi janë të bllokuara aty. Edhe rastet më të dhimbshme edhe vdekjet tani bartën kufomat me krah deri në rrugën kryesore. E lere më shërbimet tjera që do duhej ti kishte secila familje. Kështu që edhe pyetje, po edhe lutje që të ndermirët sa më urgjent në këtë drejtim diçka.

**Petrit Hoxhaj (LDK):** Sot nga kjo foltore dua ta ngrej zërin për disa probleme që i kam ngritur pothuaj që shtatë muaj nga ky vend. Dhe pothuaj se shumë pak janë marrë për bazë kërkesat e kuvendarëve. Vetëm dy përgjigje kam marrë nga dy nga drejtoresha Flaka dhe drejtori Islami. Dhe i falënderoj për bashkëpunimin që kanë pas brenda këtyre shtatë muajve. Dua t’ia nis nga ju Kryesues i asamblesë komunale. Ne kemi dorëzuar një kërkesë me shkrim për juve për pajisje me laptop për kuvendarët. Mirëpo, nuk është kthye asnjë përgjigje nga ekipi i juaj, se ku ka ngec dhe ku është problemi. Ndërsa për mbushjet sot i morëm. Shpresoj se në sezonin e dytë të këtij viti të pajisemi, pasi se ne e konsiderojmë si mjet të punës. I nderuar kryetar nuk e di që këshilltarët e juaj politik a ju kanë treguar se klubet e ndryshme sportive në Prizren, nuk kanë hapësira për ti ushtruar veprimtaritë e tyre, pasi të gjithëve ua kanë mbyllur derën. Më lejo të cekim klubin e Mundjes “Area”. Përkundër kërkesës që kanë bërë për tu takuar me juve. Pasi që në shtator ata fillojnë garën brenda dhe jashtë vendit të Kosovës. I vetmi vend që këta po e shfrytëzojnë, janë livadhet në transit. Po ashtu edhe klubet e basketbollit pingpongut, e shumë të tjera të cilat s’kanë ku mi ushtuar veprimtaritë e tyre. Dhe kërkoj që në afat sa më të shkurtë të formohet komisioni për rini, sport dhe kulturë. Që të merren rreth menaxhimit të qendrës sportive apo edhe sallave tjera sportive nëpër institucione të tjera shkollore. I nderuar kryetar brenda javës fillon “DokuFesti”. Çfarë hapa kemi marrë ne si komunë për pritjen e turistëve. A do ti presim me tarabuke tek çeshmja e Shatërvanit, apo edhe me klarinetist nga Gjirokastra. Apo edhe daullengji nga Shkodra. Mendoj që kam qenë i pari që kam ngritur këtë çështje të lypsarëve. Organizatave tjera të grabitjes së qytetarëve. Besa kur ka ardhur në pyetje qytetari edhe drejtorinë e Bujqësisë, mikun tim e kam kritikua për qentë endacak. Sepse në rend të parë është siguria e qytetarit, dhe pastaj është jarania dhe shoqëria. Shqetësimi tjetër vjen direkt nga qytetaret të cilët gjatë kohës së parkut të qytetit, i kanë dërguar disa

fotografi ku filluar të ndryshoj forma e këtij. Ka filluar të bëhet drejtpërdrejtë edhe betonizimi i parkut. Duke e shfrytëzuar.... Por çka është më shqetësuese i nderuar kryetar dhe kërkoj direkt nga komisioni. Që lojërat të cilat janë në këtë park, ku shumicën e kohës e shfrytëzojnë familjarët. Aty ka foto pornografike. Dhe kërkoj nga Drejtorja e Inspektoratit që të mirën masa sa më shpejt që të hiqen këto foto dhe të zëvendësohen me foto të filmave vizatimor. Kështu që kërkoj që për një kohë sa më të shpejt që të hiqen këto fotografi sepse aty janë fëmijët tanë të cilët e shfrytëzojnë parkun e qytetit.

**Kryesuesi:** Vetëm edhe njëherë t'ju përkujtoj anëtarë të Kuvendit. Rregullorja na kufizon vetëm dy minuta. Nuk e kam qëllimin me ndal, po do të detyrohem për shkak të mbarëvajtjes së mbledhjes. Edhe vetë jemi dëshmitarë që po na zgjasin shumë. Dhe çështjet që nuk arrin me u përfundua Ju kisha lut që ato ti adresoni në drejtorinë përkatëse. Me kërkesën që të merren masat e nevojshme. Shpresoj në mirëkuptim. Në radhë është Ilir Gashi.

**Ilir Gashi (LVV):** Duke e pas parasysh se zanatet në qytet po harrohen. Propozoj në drejtorinë përkatëse të hapet një muze i artizanateve, ku do të ekspozoheshin punimet në veçanti ato të Filigranit, mjetet që janë përdorur si dhe artefakte tjera. Një pyetje tjetër e kam serish drejtorisë përkatëse. Ku kanë mbetur punimet apo procesi për varrezat e reja në Landovicë.

**Nazife Kokollari (LVV):** Kisha një pyetje për Drejtorinë e Kulturës. A është në dijeni se punëtorët e Teatrit Profesional, tash e disa muaj nuk marrin paga. Edhe pse kontrata i skadon deri në fund të vitit.

**Ilir Baldedaj (AAK):** Unë dua ta falënderoj kryetarin e komunës për anulimin e konkursit të drejtorëve të shkollave, sepse unë kam qenë një ndër më të zëshmit. Edhe VV-ja, edhe Nisma edhe LDK-ja në opozitë kur kanë qenë, kanë fol për kapje të shtetit, për kapje të shkollave, për kapje të administratës. Dhe realisht mundeni me ç'kap tash prej PDK-së dhe me kap ju. Si është e mundur për drejtorin e Arsimit dhe për kryetarin e Komunës, sepse është një venim, që në mandatin e kaluar procedura për rekrutimin e drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe sekretarëve të shkollave i ka udhëheqë zyra e personelit. Dhe tani në këtë rast i ka udhëheqë Drejtorja e Arsimit. E kemi një vendim Këshilli i pavarur i cili e urdhëron zyrën e personelit në mandatin e kaluar, që duhet të merret. Sepse ata cilësohen shërbyes civil. Edhe drejtorët, zëvendësdrejtorët dhe sekretarët e shkollave. A ka këtu për shkak të çështje të pazareve dhe nuk i besoni zyrës së personelit, apo është ndonjë çështje tjetër. Për Drejtorin e Arsimit, si është e mundur që 400 e disa nxënës, të formohet komision dhe i kërkohet profesorëve që ti kalojnë ata nxënës. Edhe kryetari i komunës është ligjërues. Edhe drejtori Skender ka qenë pedagog. A është duke

u luajt me dinjitetin e profesorëve dhe arsimtarëve. Kur një komision i urdhëron ti kalojnë nxënësit e shkollës. Se nëse një arsimtarë nuk ka mund për një vit shkollor t'ia nxjerr ati nxënësi një dysh. Dhe ky komision shkon e urdhëron. Unë besoj që po luani me dinjitetin e profesorit dhe të arsimtarit. Pyes drejtorin e Urbanizmit, kur do të fillon hapja e rrugëve sipas planit zhvillimor komunal. Për drejtorin e Shërbimeve Publike kam një pyetje. Kur do të fillon rregullimi i rrugës Dedaj-Lubizhdë, sepse është skandaloze. Dhe një projekt Zym-Deja, është një projekt i cili është i nisur dhe gjysma e rrugës është e shtruar asfalt. Dhe pjesa tjetër nuk kam pa ndonjë lëvizje që është bërë. Për drejtorin e Kulturës, ka disa raste që kam ngritë çështje. Por akoma nuk kam marrë asnjë përgjigje as me shkrim. Po e pyes drejtorin, me çfarë të drejte merr pjesë në mbledhjet e lidhjes klubit "Liria". Dhe shkon mban fjalime me sportistet, lojtarë të "Lirisë". Dhe kjo është ndërhyrje tipike e politizimit të sportit.

**Vjollca Kabashi (AAK):** Desha të bëjë një kërkesë tek drejtori i Shërbimeve Publike. Kërkesë për rrugën në lagjen e Duhit në fshatin Korishë. Rruga e Duhit me gjatësi 480 metra, e gjerë me 5 metra. E ndërtuar me mjete të qytetarëve para lufte, është dëmtuar për shkak të punimeve nëntokësore të cilat në atë kohë kanë qenë pa punuar. Pas luftës nëpër rrugë është punuar rrjeti i kanalizimit, ujësjellësit dhe rruga është dëmtuar tërësisht. E për këtë rrugë është bërë edhe një kërkesë edhe nga banorët e lagjes. Edhe shtoj një kërkesë prapë drejtorit që ka mundësi të intervenoj në këtë rrugë.

**Alush Shala:** Unë pyetjet do ti bëjë të shkurta, por besoj përgjigjet kisha dashtë të zgjeruara dhe të sakta. Filloj me problemin dhe kërkesën time të kamotshme. Problemi i ujit në lagjen "11 Marsi", "2 Korrik" dhe "Dardani"? Kemi probleme mjaftë dhe për këtë jeni të njoftuar. Pastaj pyes drejtorin e Arsimit z. Skender Susuri, për çështjen e Çerdhes, a ka fillua, çfarë projekti ka, çfarë kosto ka, kur përfundon? Po ashtu pyes edhe për shkollën e cila do të bëhet në lagjen "11 Marsi" apo "2 Korriku". Për neve nuk ka shumë rëndësi, po është me rëndësi me ia afrua mundësin e fëmijëve që mos ti bëjnë 4-5 kilometra. Njëkohësisht ia bëjë pyetjen po drejtorit të Arsimit. Deri ku kanë arrit procedurat për fillimin e ndërtimit të shkollës të muzikës të vendi i caktuar ish Benafi. Nuk qenka drejtori i Inspektoratit, por vazhdoj t'ia bëjë pyetjen. Pse prapë vazhdojnë të mbeten auto veturat apo makinat transportuese për bartjen e kufomave në çdo hyrje të qytetit. Jeni edhe ju kryetar këtu, besoj jeni edhe dëshmitarë, dhe është një pasqyrë mjaftë e keqe. Në çdo hyrje të qytetit e kemi nga një apo dy makina që janë për bartjen e kufomave. Nuk e di a kanë leje. Edhe nëse kanë leje, besoj që është keq, si pasqyrë për qytetin tonë. Mos të flasim për te ish vendi i Benafit, që është bërë një varrezë makinash. Kam një kërkesë nga drejtori i Shërbimeve Publike. Po që se doni i kam edhe fotot



drejtor t'ju tregoj. Që nga rrethi në Bazhdarhane, deri te hyrja e parë që kthehet poshtë për Qylhan. Do më thënë nga rruga “Ahmet Prishtina”, në drejtimin e rrugës “Edit Durham”, është mundësia e hapjes së një shiriti. Ka mundësi, janë shenjat që janë ndalim, ndalimi dhe ndalim parkimi, në fakt aty gjithmonë janë të parkuar makinat. A ka mundësi është për ti hap dy drejtime. Në drejtimin e shkollës “Lek Dukagjini”. Ndërsa njëra siç është. Kështu që do ta zhblokoni mjaftë këtë pjesë. Në Ortakoll, që bashkohet me lagjen Arbana, mu te autolarja Xhafa, është një mundësi për hapjen e një rreth rrotullimi dhe hapjen e një parkingu për autobusët së paku urban. Se sipas një parallogaritje ka mbi 1200 metër, gati 2 km pa asnjë stacion të autobusëve, Arbanë-Prizren. S'kemi asnjë vend parkim, asnjë mbikalim. Edhe kjo për Shërbimet Publike. Ndriçimi i varrezave të Dëshmorëve në Landovicë. Nëse ka mundësi, por nëse s'ka mundësi do të kisha kërkuar edhe ndihmën nga kolegët tanë, që edhe me mjete vetanake ta bëjmë ndriçimin. Sepse nuk meritojnë varrezat tona të mbesin në errësirë. Edhe një kërkesë e përbashkët besoj do të jetë. Kam biseduar edhe me drejtorin Fatmir Memaj, për një problem madhor që është ligji për hekurudhat, po e cekim me numër. Nr.04/L063 nr. 129, i cili vërtetë shkel të drejtat e lirive dhe të pronave të njeriut. Andaj kryetar, ta keni parasysh, sepse aty kanë mbet pronat shkrete. As nuk mund të ndërtohet as nuk mund të shitet, po as nuk mund zhvillohet asgjë. Ato janë shumë pak pronat, të cilat kanë mbete në këtë gjendje. Andaj tu kisha lutur që të merresh me këtë problem, ose do të filloj me Avokatin e Popullit.

**Sadije Osaj (LDK):** Të nderuar, jam banore në “7 Shtatori” Kurilë dhe jetoj në rrugën “Kurilë”. Sa për dijeninë tuaj, po mundohem me një përshkrim të shkurtër t'ju njoftoj se lagja “7 Shtatori” Kurila është e ndërtuar si pjesa dërmuese e komunës së Prizrenit. Me infrastrukturë rrugore, kanalizim, ujëra të zeza si dhe ato atmosferike gjatë viteve 2001-2007. Respektivisht në kohën e LDK-së. Në atë kohë buxheti komunal ka qenë i pamjaftueshëm. Prandaj qytetarët e komunës së Prizrenit me vullnetin e tyre kanë participuar, ose bashkëfinancuar me mjete prej 30-50%, për ndërtimin e infrastrukturës rrugore, kanalizim etj. Kështu ka ndodhur edhe në lagjen “7 Shtatori” Kurila. Në rrugën Kurila nuk është ndërtuar kanalizimi i ujërave të zeza dhe ato atmosferike. Por është ndërtuar vetëm rruga me kupëza të betonit. Arsyeja ka qenë se kompania e Ujësjetës Hidroregjioni Jugor, në atë kohë nuk ka pasur mjete financiare, për ndërtuar gypat e ujësjetës. Të cilët kanë qenë, edhe sot janë të asbestit. Kërkesa ime në emër të banorëve të lagjes Kurila është që kanalizimi i ujërave të zeza, i cili është i ndërtuar me rase, që në kohën e Turqisë, është jo funksional. Gjatë të reshurave atmosferike, ujërat e zeza kthehen dhe banorët vazhdimisht kanë probleme. Unë mendoj ndoshta e vetmja rrugë në qytetin e

Prizrenit, që ka mbetur kanalizimi i ujërave të zeza që ka mbetur me rasa, është rruga Kurila. Prandaj e lus drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, që sa më shpejt ta fus në agjendën e vetë ndërtimin e kanalizimit të ujërave të zeza, ato atmosferike dhe rrjetin e ujësjellësit, bashkë me ndërtimin e rrugës me kupëza. Kam një kërkesë, e cila është pak e ndjeshme. E di që e keni pranuar edhe ju. Shoqata e grave në luftë kundër kancerit të gjirit në Prizren Renesanca, është formuar nga një grup i grave të cilat kanë qenë të atakuara nga kanceri i gjirit dhe ofron aktivitete mbështetëse. Ofrimin e shumë shërbimeve këshilluese terapeutike dhe shëndetësore. Mirëpo, takimet vazhdojnë të mbahen nëpër kafene. Që shpesh për atë çmim të kafes, anëtarët ngushtohen edhe të vinë. Për të funksionuar shoqata, duhet të ketë mbështetjen e të gjitha institucioneve. Andaj mendoj se është një kërkesë urgjente dhe shumë e nevojshme, që mund të ndikoj në preventivën dhe në shërimin më dinjitoz të kësaj sëmundjeje. Duke ofruar një lokal komunal, me një qira simbolike. Duke qenë në dijeni qendra sociale i ndanë personave të atakuara nga kanceri i gjirit vetëm 75 € në muaj. Kur dihet se mesatarja e kutive të hapave për një muaj kushton 20 € e më tepër. Kjo vlen për personat që janë në moshën e pensionimit. Gjë që kushtëzon që këta persona nuk guxojnë të punojnë asnjë punë tjetër, sepse do ti humbin edhe ato 75 €. Atëherë pyesim vetën kur kemi bërë mamografinë për herë të fundit. Për të arritur suksesin kërkohet që të mobilizohet e tërë shoqëria dhe atë jo vetëm një muaj në vit, në muajin tetor. Kështu që në emër të grave 16 asamblastëve, këtu në Prizren, kërkoj që kontrollimi i grave mamografia të jetë falas gjatë tërë vitit, sepse shoqëria jonë nuk ka sigurime shëndetësore.

**Memnuna Ajdini (Vakat):** Najpre u da se složim sa koleginicom za ovaj zahtev. Jako bitan zahteve za žene. I ja mislim da e biti podržana ako smatroma da je to vrlo bitno. A trebalo bi da podržimo ovaj predlog. Ja sam izašla povodom pitanja koje više puta sam postavila. I nažalost još uvek nemam nikakav odgovor. Niti je nešto ura eno po tom pitanju. Radi se dakle za Direktorijatu za Javne Usluge, i radi se za put relacija Prizren-Prevalac. I deonica Prizren-Re ane. Gde se još uvek nažalost rade radovi. Koje e izgleda potrajati podugo, možda i do zime, i ne e se završiti. Pa sam ja u više navrat predlagala da se ubrže radovi. Ubrzavanje radova tražila sam sa pove anjem broja radnika. Sa ak radom u no noj smeni. Nažalost nije se odra eno tako. Nego se radovi rade vrlo plaljavo sa malim brojem radnika. Što definitivno možemo videti da još ovjek se radi, i da e to jako dugo trajati. Svakako ono što ja zahtevam i predlažem jeste da se baobustave radovi. Obzirom da smo u sezoni, kada imamo veliki broj turista, kada imamo veliki broj naših ljudi iz diaspre. Kada su esta slavlja i naša tradicija se na inom proslave porodi nih veselja. Tako da ova deonica je zaista katastrofalna za sve nas. Pa normalno i za meštane kji svakim

danom putuju iz regije Župe. Moj predlog je zaista da se obustavi bar ovaj mesec. Pa da se to kasnije radi. I to užurbanije sa mnogo efikasnijem na inom radi, i sa ve im brojem ljudi. Drugo pitanje se odnosi za Direktorijat Obrazovanja. Gde su u više navrata dati zahtevi i za školu u Draj i i. Koja nažalost još uvek nije po ela da se radi. Oni o ekuju i nadam se da e za ovaj mandat da se uradi u potpunosti ta škola. I da se useli i to u najskorijem vremenskom periodu. Tako e zahtev koji je dat iz škole Manestirice „Svjetlost“. Gde se traži grejanje. Nadam da e to biti uvršteno. I da e pre zimske sezone da se taj rad završi, to jest grejanje. I tako e škola u Grn aru, koja škola nije dovršena. I završetci radova o ekuju oko 60.000 €dotatnih. Koji su planirani za idu u godinu. Ja zahtevam da se to povu e za ovu godinu. I da to bude odra eno što pre. Stalno zahtevai iz Župe i Podgore se prolongiraju. Molim vas, o ekujemo da zahtevi koji su davani i pre više godina. Da se završavaju onako kako idu po prioritetu. A što se ti a pitanje podrpredsednika, to je još dodatno pitanje. Koje nadam se i o ekujem da se što pre reši.

**Sultan Badallaj (PDK):** Unë do ta filloj me rastin e drejtorëve të konkursit të shkollave. Rasti i konkursit për drejtor të shkollave është një prej skandaleve shokuese të kësaj qeverisje. Anulimi i konkursit pa asnjë shpjegim. Kjo të jep me kuptua për një rrugë në drejtim pa krye. Por ajo që është kryesore në këtë të keqe, duhet të ceket se drejtori me përgjegjësi dhe kompetencë të plot po i rri mbrapa atij procesi, konkursi. Ndërsa kryetari në udhëtim e anulon po të njëjtin. Tash është rishpall konkursi. Si bëhet rishpallja pa u ndriçua anulimi i tij dhe sillni sikur nuk ka ndodhur asgjë. Jo të nderuar kjo është skandaloze edhe një njollë e zezë për qytetin. Është mirë që le ta dinë edhe qytetarët e Prizrenit se me çfarë qeverisje kanë të bëjnë. Prandaj për të eliminuar këtë të keqe duhet kërkuar shkaqet e saj. Ne këto shkaqe nuk i kemi. Por ekzistojnë shkaqet, sepse nuk ka problem pa shkak ose arsye. Atëherë në këtë lojë dikush duhet të shkoj në përgjegjësi. Çështja tjetër është po ashtu edhe tenderi i emërtimit dhe shenjzimit të rrugëve, që ka shumë paqartësi dhe parregullsi. Operatori ekonomik është duke punuar. OSHP-ja si organ më i lartë i prokurimit publik, dy herë ka pru vendim për shkëputjen e kontratës, për shkak të parregullsive. Përkundër kësaj ju se keni përfillë vendimin e organit shqyrtues të prokurimit. Pra, keni të bëni me një shkelje flagrante të ligjeve. Kemi edhe rastin e tenderit për teleferikun, që e dimë të gjithë, të cilin e keni anuluar. Kur dihet se organi shqyrtues i prokurimit publik e ka kthye për rivlerësim. Pra kemi në të dy rastet kritere të dyfishta. Pra në rastin e parë kemi dy vendime për shkëputjen e kontratës. Përkundër kësaj ju e keni shpërblyer operatorin ekonomik. Ndërsa rastin e dytë, kemi rivlerësim të tenderit dhe ju e keni anulua këtë.

**Samra Iljazi (NDS):** Moje prvo pitanje se odnosi na potporni zid glavne ulice u Novom Selu. Koji je u jako lošem stanje. I koji može se sruši u svakom trenutku. Zahteve za reparaciju zida je predat Direktorijatu za Javne Službe pre dve godine. I do sada nisu preduzete nikakve mere. Zahtevamo da se sanacija zida izvrši što je brže mogu e. Jer u slu aju rušenja zida, i eventualnih nesre a odgovornost e biti na direktorijatu. Drugo pitanje se odnosi na pockavanje i ure ivanje centra u selu Grn are. Kroz centra sela prolazi potok koji može biti izvor raznih zaraza. I sobzirom da su ulice koje se ulaze u centar ve pokockane. Zahtevamo da se uredi i sami centar. Projekat je predat Direktorijatu za Javne Službe. Centar sela je mali treg. I kada bude lepo ure en, može da se koristi i za razne kulturne manifestacije.

**Cengis Cesko (KDTP):** Sayın Ba kanım, de erli müdürler, de erli meclis üyeleri hepinizi saygı ile selamlıyorum. Benim ikitane sorum olucak bir de bu konuda Kamu Hizmetler Müdürü Sn. Levent Kasemi'ye bir iki istekte bulunucam özellikle Bajdarhane ve Ralin kısmını ba layan bir sokak var bunlar Kosova 308, Sami Frasheri 307, Emin Pasha 320 sokaklarının herhangi bir asfalt yapılanması ya da bunların yeniden düzenlenmesi ile ilgili herhangi bir çalı manız var mı. Bu kullanılan yolun ciddi anlamda bir bakıma gerekli oldu unu dü ünüyorum bir de kulalar kısmında Rozafa Butrinti adlı semt'te orada da bir asfaltlanmanın ya da yolun yapılanmasının gerekli oldu unu dü ünüyorum bu konuda halkın orada sizden bir beklentisi olmaktadır ve Hafız smail Hakki mahalesinde kanalizasyon sıkıntısı var Sadije Oseku meclis üyemiz Kuriladaki bu kanalizasyon sıkıntısından bahsetti i için ben ayrıca te ekkür ediyorum. kinci sorum ehirle me ve Alan Planlama Müdürü Fatmir Memaj'a bir sorum olucak Ortakoll, Bajdarhane ve Kulalar semtindeki apartmanların çatı kısımlarında özellikle ya murdan sonra ciddi sıkıntıyla ya adıklarını dile getirmektedirler bu konuda halkın beklentisi ve talebi olmaktadır bunlarla herhangi bir çalı manız var mı ya da bununla ilgili herhangi bir i lemlerin yapılması ile ilgili geli me var mı bunu sormak istiyordum te ekkür ediyorum.

I nderuar Kryetar, të nderuar drejtorë dhe anëtarë të kuvendit të gjithë ju përshtëndes. Unë i kam dy pyetje njëra nga këto është për Drejtorin e Shërbimeve Publike z. Levent Kasemin për të cilin i kam dy kërkesa posaçërisht për lagjet Kosova 308, Sami Frashër 307, Emin Pasha 320 të cilat lidhin Bazhdarhanën dhe Ralinin, a do të ketë ndonjë punim si asfaltim apo rirregullim. Sepse kjo rrugë shumë e frekuentuar mendoja se ka nevojë për mirëmbajtje. Po ashtu edhe në lagjen Rozafa Butrinti mendoja se rruga duhet të asfaltohet apo rirregullohet sepse banorët e asaj lagje kanë pritje nga ju. Në mëhallën Hafız smail Hakki kanë probleme me kanalizim nga këtu dëshiroja ta

falënderoj anëtarin e kuvendit Znj. Sadije Oseku-n që përmendi këtë problem të kanalizimit në Kurillë. Pyetja e dytë është për Drejtorin e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinorë z. Fatmir Memaj. Banorët e banesave në Ortakoll, Bazhdarhane dhe të Kullat posaçërisht, pas reshjeve të shumta ankohen se kanë probleme në kulme dhe banorët në fjalë kanë pritje nga ju. Andaj dëshiroja të pyes se a keni apo a do të ketë ndonjë punim lidhur me këtë shqetësim të banorëve. Faleminderit.

**Shukri Quni:** Unë desha kështu si pyetje. Këtë vit është njëzetë vjetori i rënies heroike të Komandant Remzi Ademaj, Komandant Petritit. Pra, është njëzetë vjetori, vit jubilar. Andaj, pyes a ka paraparë komuna të organizoi Akademi me 15 gusht, sepse këtu në Prizren për dëshmorët dhe heronjtë ka organizime shumë pak. Kështu që po kërkoj prej këtij Kuvendi, që në këtë vit jubilar është mirë me organizua akademi përkujtimore. Po në rast se mundet edhe Ilir Baldedaj me intervenua pak në Qeveri atje. Mirë është edhe Qeveria me ndërmarrë diçka. Singërisht po them që për heronjtë e Prizrenit, pak organizon Qeveria atje. Pa marrë parasysh kush ka qenë edhe kush është. Drejtor Levend Kasem për Shërbime Publike, për Mazrek e kam fjalën. E dinë këtë çështje edhe kemi diskutua. Edhe kogja mirë më ke kuptua edhe më ke përkrahë. Po në lagjen Duraj nuk kanë përfunduar rrugët krejt qysh kanë qenë në plan. Ka shkua dikush ka intervenua tash. Se janë disa ma të mëdhenj ndoshta por se unë po, po edhe se ti që ka aty. Edhe i kanë orientuar rrugicat në disa kahe tjera. Kështu që tani kanë lind probleme. Se të kishte vazhdua projekti si që jemi kuptua ne shumë mirë ishte duke shkua puna, s'ka pas problem hiq. E tash kemi probleme sepse e kanë devijua ndërtimin e rrugicave. Unë kam kërkuar edhe nga mbikëqyrësi edhe prej jush, që merret dhe të llogaritet edhe sa metër katror kanë mbet. Edhe le të vazhdohet ai projekt dhe të realizohet. Besoj që nuk ka pas nevojë këtë me ta thënë këtu. Kemi bisedua në zyre, po më kanë detyrua disa, edhe kogja do drejtorë janë këtu që kanë shkua e kanë intervenua aty. Nuk ka nevojë me intervenua sepse kogja do punë janë krye, po kurrë nuk kam shkua mi diferencua njerëzit. Këtij me ju rregullua e këtij jo. Te ne ka shkua gjithnjë rend. Po flas për nga ana ime. E këtu s'kanë bo mirë që kanë intervenua. Për atë punë shkojmë bashkë në vend të ngjarjes edhe e shohim. Drejtorin e Bujqësisë, unë të falënderoj, se nuk dimë veç me kritikua ne PDK-ja, po dimë edhe me falënderua, për një çështje që isha edhe tek ju. Edhe ke reagua menjëherë në mënyrë pozitive e kam fjalën. Edhe është zgjidhë ai problemi, është fjala për ujin e vadës që i themi ne, do më thënë sistemi i ujitjes. Kryesues te pyetjet edhe çështjet e ngritura. Ka qenë dy minuta, po ka qenë vetëm pyetje. Tani me inicimin e Gzim Durajt kur tha jo vetëm pyetje por edhe çështje të ngritura. Tash këtu dy minuta nuk premtojnë me bo pyetje edhe me



ngritë çështje. Kështu që është mirë kjo edhe me shkua edhe në katër minuta, nuk është keq.

**Kryesuesi:** Në mandatin e kaluar kemi diskutua edhe bashkërisht kemi marrë pjesë në hartimin e rregullores. Pikërisht për këtë arsye se po zgjatet shumë si pikë e rendit të ditës. Dhe anëtarët e Kuvendit janë të interesuar me participua në mbledhje më së shumti në këtë pikë. Se gjatë gjithë muajit akumulojnë kërkesa prej qytetarëve edhe vinë edhe këtu kjo po ndikon në kohën në mbarëvajtjen e mbledhjes. Atëherë ka qenë propozimi që me u kufizohet në dy minuta dhe të gjithë jemi pajtua. E di që nuk është e mjaftueshme por në qoftë se Kuvendi mendon që kjo kohë duhet të zgjatët. Atëherë na mbetet veç me ndryshua rregulloren. Në qoftë se jo, detyrohemi me ju përmbajte për aq sa mundemi.

**Sherife Balaj (PDK):** Kërkoj nga DKA-ja të krijohen kushte për hapjen e klasave parafillore në secilën shkollë fillore të ciklit të ulët. Pasi që e dimë se sa është i rëndësishëm edukimi parafillor. Dhe mos të themi më herët prej 0 deri 3 pastaj prej moshave të tjera. Mirëpo, ende nuk i kemi në secilën shkollë fillore klasat parafillore. Kisha dashtë me ditë edhe për përfundimin e punimeve në objektin shkollor në fshatin Lukinaj të Hasit. Ku tash sa kohë veç ka mbet si muze ai objekt i shkollës. Po ashtu kisha dashtë me ditë dhe me ngritë një problematikë dhe një çështje, se çka bo me pozitat e lira të punësimit në komunën e Prizrenit. Ku e kemi një rast specifik. Është zyrtarja ka dalë në pension QPS, tash e dhjetë muaj mos gabofsha dhe ende nuk është bo asgjë me hapjen e konkursit. Dhe pastaj ka edhe vende të tjera të lira. Dhe jemi në një vend dhe në një komunë, ku papunësia është e lartë dhe njerëzit patjetër që presin për me u punësua. Ndoshta po i pritni për me i vendos ose mi rehatua militantët e juve. Po sido çoftë edhe ata janë qytetarë të Prizrenit dhe së paku le të punësohet dikush. Në seancën tjetër kërkoj që të bihet raporti për materialet ndërtimore, jo vetëm nga DPMS, por edhe nga zyra e komuniteteve dhe nga Drejtoria e Emergjencave. Pasi që edhe ata kanë tenderë për materiale ndërtimore. Dhe të jemi të informuar sa më afër dhe ta dimë se qysh ka ec kjo procedurë.

**Agnesa Sinanaj (AAK):** Unë e kam një pyetje shumë të shkurtë edhe shumë të thjeshtë për drejtorin e Mirëqenies Sociale, për ndërtimet e rasteve sociale. Pyes a kanë leje ndërtimi, pasi ju veç jeni duke e luftuar këtë dukuri. Edhe diçka desha me shtua për zonjës Sadije. Zonja Sadije është kryetare e gruas asambleiste tek ne. Edhe mendoj që i takon se i takon privilegje me fol një minutë më shumë se ne, sepse e ka marrë përgjegjësinë mbi supe.

**Skender Sallauka (PDK):** Kryetar unë desha me ngritë një shqetësim këtu, që është pak edhe si çështje më urgjente duhet me u marrë pak më me seriozitet. Fjala është për ndërtesën këtu para neve, para Kuvendit komunal. Ndërtesa e ish Lirisë, është edhe e demoluar. Edhe ajo ndërtesë sipas të gjitha gjasave ka shans edhe mu shit prej AKP-së. Propozoj që të marrim iniciativë, në bashkëpunim me AKP-në në Ministrinë e Pushtetit Lokal, të bëjmë kërkesë që ajo të lirohet. Dhe të na i liron hapësirat aty. Dhe vetvetiu ju mundeni me marrë parasysh se çfarë hapësire krijohet aty dhe çfarë qarkullimi mundet me pas për të gjithë qytetarët e Prizrenit. Ne jemi për me i mbrojtë interesat e qytetarëve të Prizrenit. Në qoftë se shitet ajo, për 100-200 vjet s'ke me mund me heq atë. Qysh s'munden me u heq edhe shumë objekte tjera në Prizren. I kanë lënë gjithnjë për neglizhencë, duke u merr me punë, krejt tjera. E kam edhe një si lloj ideje, propozim tjetër, që me i ndejt hapësirave gati. Është fjala për te sheshi i Lidhjes së Prizrenit, te Ëmbëltorja e Qytetit. Me marrë një iniciativë ne si Kuvend komunal, për lirimin e atij sheshi. Me nis me bo njëfarë lloj strategjie, mi zhvendos ata banorë prej aty. Pse e bëjë këtë ide! Sepse ne kemi tash për tash hapësira si komunë, ku mundemi mi zhvendos ata banorë, në qoftë se ata pranojnë. Edhe mundemi ti vendosim të Qendra sportive, ose te Katër Kullat, është hapësira e komunës. Mundemi te stacioni i autobusëve ku është vendi i komunës, kemi hapësirë te Benafi. Do më thënë ky është një projekt shumë afat gjatë. Dhjetë vjet, pesëmbëdhjetë vjet. Po në qoftë se dikush nuk e merr tash për tash një iniciativë. Nesër, pasnesër ajo zonë e komunës zihet te katër kullat, ku ke mi qua banorët atje. Se ajo është dyfishë më e madhe. Se krejt thonë shumë kushton, shumë kushton. Po ka me të kushtua edhe njëqind fish më shumë. Për deri sa komuna ka tash kushte për me ia kompensua, në qoftë se ata pranojnë. Më mirë është tash me marrë një iniciativë edhe e lenë. Herdo kurdo kur të bëhet te katër kullat edhe te shtrumfat atje. Ti e ke që ata banor sistemohen aty. Normal me marrëveshje qysh merret vesh komuna me banorët e krejt grupet e interesit që janë aty. Edhe poshtë munden me bo parking, dy, tre kate nën tokë që bëhet. Kjo nuk është interes vetëm i komunës së Prizrenit, por interes i krejt qytetarëve të Republikës së Kosovës. Se Prizreni dihet se është një kryeqytet historik. Shqetësime tjera, pyetje tjera ka shumë, por nuk dua me ju marrë kohë. Veç një desha për kryetarin, është shtruar një rrugë andej në lagjen tonë, para syve më ka ra në sy, shumë interesant, njëherë është shtruan vijat e bardha. Para dhjetë ditësh, pas dhjetë dite asfalt. S'di qysh pak edhe banorët u habitën. Ndoshta stil i ri i qeverisjes. Ma së pari kryetar asfalti tani vijat, jo vijat tani asfalti.

**Azem Durmiši (NDS):** Hteo bi dase zahvalim gradona elniku i direktorima koji su se odazvali našem pozivu u Župi. I što smo naišli na

razumevanje sa njima ta nije u Re ane u seoskom domu. Da rešimo odre ene probleme, odnosno naših zahtevi iz Župe i Podgore. Pa ne bi ovde da ih navodim. Je u više slu ajeva smo ih navodili, ne samo ja i upravo i kolegunica Memnuna je iznela neke. Zahvaljujem još jednom na takvom razumevanju. I samo bi podsetio gospodina gradona elnika i direktore koji su bili prisutni. Da te naše molbe kažem, rekoh bi ovde molbe da se u što skorije vrijeme realizuju. Jer sami ste svedoci ondašnjeg putovanja kako je stanje. Da su te molbe zaista urgentne ida se realizuje i što skorije vrijeme. I tih zahtevi ovde ne u da navoim zato što sam i navodio u više navrata na predhodnim seancama. Da ne bi vas zamarao stvarno. Nisu novi, niti su tajni, ve su zaista urgentni. I još jedno bi uputio apel kancelariji za zajednice i Direktorijat za Rad i Socijalno Stanje. Da se zahtevi sociajlnih slu ajeva ne kriju u fijokama. I da se ne zloupotrebljava politiki položaj. I vrši da kažem selekcija neka na osnovu politiki pripandosti. I da zaista je zabrinavaju a za našu zajednicu i neve inske zajednice. Da nijedan zahtev od socijalnih slu ajeva nije udovoljne od strane ovog direktorijata.

**Ilir Baldedaj:** Shkurt kryesues, besoj se është në interes të gjithëve. Është mirë që njëherë e përgjithmonë që kjo çështja e pajisjeve elektronike të Kuvendit të përfundoj, sepse është edhe votimin elektronik, edhe përkthimi. Tash po bije mosrespekt mos me dëgjua kolegun. Sepse nuk po na punon përkthimi dhe nuk po e marrim vesh. Kisha kërkua edhe prej kryetarit edhe prej Drejtorit të Administratës edhe ti kryesues, ta gjeni një formë dhe tash pak pushim. Pasi një muaj ditë janë pushim, le të rregullohet kjo.

**Prof. Dr. Mytaher Haskuka, kryetar i komunës:** Sa pari dua të filloi me ndërtesën e ish Lirisë. Ne kemi biseduar edhe me Kryeministrinë, dhe me ligjin e ri për pronat, në përdorimin e komunave, jemi duke e përpunuar një listë e cila ka të bëjë me pronat e AKP-së, ose që janë nën menaxhimin e AKP-së. Ku ne kërkojmë bllokimin e këtij procesit të privatizimit. Edhe që ato me u shpall tek fundi i fundit interes publik. Edhe ne si komunë, me pas qasje ose me i marrë ato prona. Edhe në atë aspekt, para dy-tri jave ka kaluar një kërkesë lidhur me kinema Lumëbardhin. Edhe besoj që do të jetë ashtu edhe kërkesat tjera që i kemi. Këtu janë shënuar edhe disa lidhur me pronat e Progresit. Besoj që nëse i dorëzoni ato me numra edhe ato i shtim në listë, edhe shikojmë se çka mund të bëjmë lidhur me lagjen Jeta e Re. Se aty mungon më të vërtetë infrastruktura publike, nuk ka vende shumë për banorët e lagjes. Dua të them se ndërtesa e Lirisë, është në atë listë edhe do ta dorëzojmë. Besoj që brenda javës e përfundojmë listën edhe e dorëzojmë në kryeministri, që ato që janë në listë të bllokohen dhe mos të shkojnë në privatizim. Lidhur me pajisje me laptop, folëm me kryesuesin, besoj që së shpejti do të merren ato dhe do të dorëzohen. Po këtu

duhet me kërkua nga ata që kanë qenë më herët në asamblenë komunale që duhet të dorëzojnë laptopin e vjetër, në mënyrë që ta marrin atë të riun. Edhe për asamblastët e vjetër që ta dorëzojnë, se ashtu kërkohet sipas ligjit. Te rruga “Ali Pashë Tepelena”. Ne kemi pas takime të gjata me KOST-in. Edhe pse KOST-i fillimisht ka thënë që nuk është problem që me na dhënë dy, tre metër, edhe pse afër murit të KOST-it kanë qenë afro dy metra apo tre metra të komunës. Ne faktikisht me bo rrugën tek ai trafostacioni i KOST-it për Gurishtën ose “Ali Pashë Tepelenën” shtëpitë aty. Pas tra, katër takimeve, më në fund na është dhënë përgjigje që KOST-i nuk mundën me na dhënë atë vend. Edhe tash mundësia tjetër është shpallja, zonë e interesit, dhe me shpronësua aty një pjesë nga një pronarë privat. Edhe pastaj me bo rrugën aty si është paraparë me plan. Fatkeqësisht vendimi për shpalljen si zonë interesi të asaj është vonua. Në seancën e ardhshme, kurdo që është ajo do ta keni. Edhe shpresoj që të gjithë asamblastët e votojnë, nga se janë diku rreth 200 shtëpi aty që janë pa rrugë. Edhe besoj që pastaj bëhet shpronësimi edhe besoj që nuk do të ketë problem me atë. Lidhur me arsimin kanë qenë shumë pyetje. Por unë i kam disa pika e pastaj mundem me i dërgua, se na merr kohë të gjatë me diskutua problemet në arsim. Po unë jam shumë i kënaqur me drejtorin e Arsimit. Është duke e bërë një punë shumë të mirë. Mundemi me pa raportin e ti gjashtëmujor. Ku faktikisht është publikua në ueb faqe. Edhe në raportin gjashtëmujor të Arsimit janë publikuar të arriturat të cilat janë bo në Arsim në Prizren për gjashtë muaj, të cilat nuk besoj që janë bo më herët. Duke fillua prej numrit të rregulloreve e deri tek investimet e ndryshme. Po a ka probleme arsimit, ka shumë probleme arsimit. Normal brenda gjashtëmujorit është shumë problem mi adresua të gjitha këto probleme. Unë besoj, edhe njëherë desha me tregua mbështetjen time për këtë. Në aspektin e konkurseve, konkurset sidomos në arsim në Prizren nuk janë ditë as më përpara. Do më thënë vetëm i kanë pa drejtorët edhe kush është aty drejtor e kështu më radhë. Tash krejtësisht është ndryshua. Pasi është ndryshua krejtësisht dhe është plotësisht transparente. Procesi edhe me rregullore edhe me këto sende tjera.

**Shukri Quni:** Kryetar, shiko, mua më kujtohet mirë, kur kryetari i juve Albin Kurti, ju thojke atje në Parlament, mos u zgërdhi ju thojke njerëzve. Je me një detyrë...

**Kryetari:** A mundesh me ndal fjalën.

**Quni:** Kush me ndal fjalën.

**Kryetari:** Ti

**Quni:** Ti a...

**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë të Kuvendit, jemi në pjesën e përgjigjeve, dhe le të vazhdojnë me përgjigje. Ju kisha mos dilni prej kontestit të mbledhjes. Prandaj e dëgjuam Kuvendin tash është radha e ekzekutivit. Prandaj ju kisha lut edhe njëherë për përmbajtje. Z. Quni ju lutëm, tash kalojmë në këtë pjesën e përgjigjeve.

**Kryetari:** Unë po ju përgjigjem pyetjeve që janë parashtrua. Edhe tash e ke radhën me dëgjua. Lidhur me këtë proces vetëm për me rrit më shumë edhe sigurimin e imunitetit për komisionin vlerësues. Edhe për me rregullua besimin e publikut në këto procese e cila paraqitet si problematike, e kam marrë këtë vendim. Është edhe përgjegjësi edhe obligim i jem edhe mundem me bo diçka të tillë. Shpresoj që tash do të ketë aplikant edhe më shumë me masat shtesë që i kemi marrë të cilat i kemi publikua, i keni publike ato masa shtesë. Besoj që do të jetë një proces shumë më i mirë. Edhe pse në krahasim me proceset e mëparshme ka qenë shumë, shumë më e mirë. Edhe s'kemi çka me bisedua aty se krejt publiku e dinë. Për çështjet tjera që i ngritët lidhur me arsimin, unë besoj që drejtori mundet edhe drejtpërdrejt me ju paraqit. Lidhur me këto edhe njëherë po them që jam shumë krenar me ato të gjitha që janë bo në arsim deri tash. Duhet të mësohuni me këto gjera. Në aspektin e lypsarëve, kemi pas disa takime me policinë edhe me drejtorinë, edhe me organizatat e ndryshme ndërkombëtare. Me i adresua këto çështje në mënyrë më adekuate. Besoj që do të ketë edhe aksione të policisë këto ditët e ardhshme, lidhur me lypsarët. Po nuk kryhet vetëm me polici. Duhet edhe politika shtetërore. Po duhet edhe politika të cilat duhet të ndermirën për me adresua qëllimin e lypsarëve. Edhe besoj që këto do ti bëjmë. Edhe me rregulloret e reja që jemi duke i përgatit. Po unë pres edhe ligjin për mbrojtjen e fëmijëve. Disa ligje janë në Parlament nëse kalojnë. Besoj që ne do të kemi shumë më shumë mundësi me adresua çështjen e lypsarëve të cilët lidhën zakonisht edhe me fëmijët të cilët janë nën moshën 15 vjeçare. Po disa gjëra nuk mundet me i bo komuna pa i bo qeveria. Unë i kam dhënë komentet e mia lidhur me ligjet që lidhen me këto, në aspektin e komunës. Edhe besoj që në afat të shkurtë do të kemi aksione me polici. Do ta kemi të koordinuar edhe me Drejtorinë e Emergjencës, edhe me Drejtorinë e Mirëqenies, edhe me Drejtorinë e Shëndetësisë. Po në afat të gjatë besoj që duhet një qasje shumë më adekuate lidhur me këto probleme. Edhe lidhur me qenët endacak. Nëse shikojmë Prizreni nuk ka qendër për trajtimin e përkohshëm të qenve, e cila sipas udhëzimit administrativ të qeverisë duhet me pas çdo komunë. Për këtë jemi duke punuar drejtorin me krijua këtë qendër. Po janë ligje të cilat parashohin se si veprohet edhe me qenët endacak. Më shumë janë përgjegjësi të agjencionit të veterinarisë. Edhe adresohet në baza rajonale. Se qenët nuk e dinë se ku është kufiri i komunës. Po çështja, edhe këtu jemi



duke ndërmarrë masa së bashku me shoqërinë civile edhe së bashku me Drejtorinë e Bujqësisë, që me adresua çështjen e qeneve, ose me fillua me adresua çështjen e qeneve endacak. Se për këtë vyen një politikë afatgjate edhe një politikë e koordinuar me qeverinë. Tek çështja e veturave për bartjen e kufomave. Unë nuk besoj që ata kanë leje për këto. Duhet të punojmë prapë edhe me polici se ku i parkojnë dhe ku nuk i parkojnë veturat në hyrje të Prizrenit. Po duhet me gjet edhe ndonjë mënyrë se si qytetarët të cilët kanë nevojë për këto shërbime, me i gjetë ato shërbime më mirë. Edhe mendoj që do ta adresojmë edhe këtë çështje. Benafi, e dini është nënshkruar marrëveshja me Ministrinë e Administratës Publike, që të bëhet shkolla e muzikës. Edhe vendi ku do të krijohet një qendër për rini ose për ansamble të komunës së Prizreni, do të jenë dy ndërtesa. Ne edhe pse kemi prit që në qershor të fillojnë punimet aty. Ajo është në Ministri. Më thanë që tash po përfundon procedura e tenderimit edhe në momentin që fillon ajo pjesa e Benafit pastrohet edhe fillojnë punimet që të rregullohet ai vend. Lidhur me muzeun e artizanateve. Faleminderit për këto edhe këtu e kemi krijuar një ekip i cili do të merret me krijimin e disa muzeve në Prizren. Ndër to është edhe muzeu i artizanateve. Prizreni i cili ka pas dikur rreth 180 artizanate. Është mëkat mos me pas një muze për artizanate. Edhe hapi i parë është, jemi duke kontaktuar me një organizatë ndërkombëtare e cila do të na jep pak konsulencë për krijimin e konceptit të kësaj. Edhe pastaj me na tregua pikat se si shkohet në krijimin e një muzeu për artizanate. Nuk di me rishikim të buxhetit se si shkon, po do të shikojmë se di do ti bëjmë disa hapa për sivjet. Për pronat e uzurpuara. Unë jam i interesuar po ndër to është edhe këtu në listë shumë pika për të cilat jemi duke punua. Edhe njëra prej pikave është lista e lokaleve të cilat kemi konstatua që duhet me shpallë përsëri ankand publik. Për me i dhënë ato në shfrytëzim jo ashtu si janë momentalisht. Tek çështja e komisionit për Zym, ndoshta për këtë drejtori më adekuat përgjigjet. Shumë nga çështjet që po kritikohet Kuvendi komunal edhe shumë nga çështjet që po paraqiten si probleme nuk janë probleme të cilat munden me u zgjidhë brenda një dite ose brenda gjashtë muajve. Po janë probleme afatgjate. Nëse për qenët endacak nuk është bo kurrjë brenda 20 viteve. Po edhe më përpara, ose nuk janë krijuar mekanizma se si mi adresua qenët endacak sipas ligjit. Se e dimë qysh janë adresua më herët. Atëherë neve na vyen kohë për me krijuar mekanizma, për me i adresua këto çështje, njëjtë edhe për lypsar. Po dua me ritheksua diçka, rishikim sivjet nuk ka. Shumë çështje që kemi mendua me i bo me rishikim, pasi s'po bëhet rishikimi. Duhet me shikua mënyra se si me i adresua këto probleme pa e bo rishikimin. Për çështjen e asfaltit edhe ngjyrës e kështu më radhë. Normal herën e parë është shtrua, pse është dashtë mu shtrua vitin e kaluar. Po pasi është bo sivjet është shtrua në fillim. Dhe pastaj janë fillua punimet dhe normal në do vende ka mund me qenë që ka ardhur vija,

pastaj asfalti, pastaj prapë vija. Të drejtën më thënë unë edhe në fillim nuk kam qenë i kënaqur me ngjyrën që është shtrua fillimisht. Edhe besoj që tashmë pasi është shtruar edhe asfalti i ri, do të kemi edhe ngjyrë më të mirë. Edhe më të bukur edhe sipas standardëve, nuk është ndonjë problem ajo. Disa çështje që janë ngrit lidhur me OSHP-në. Po i dimë problemet me OSHP-në. Më shumë janë probleme me OSHP-në se sa me komunën. Po edhe besoj edhe këtu do të ketë edhe zhvillime tjera që do të ndikojnë në këto. Unë do të mundohet që të përgjigjem gjithmonë për ato gjëra që i di. Për ato që nuk i di, do t'ia lë drejtorëve.

**Skender Susuri, drejtor i Drejtorisë për Arsim:** Unë do të mundohem në pyetjet e juaja të japë përgjigje konkrete dhe të shkurta. Po filloj me kuvendaren Sherife. Sherife është e vërtetë që në ente parafillore duhet me pas edukatorë. Sa do të ketë sivjet edukatore të reja nuk e di. Na e kemi një listë prej 2263 të punësuarve të cilën nuk guxojmë me kalua. Kemi marrë 53 i kemi pas mbi listën, e kemi reduktua me pesë. Shpresoj që deri në shtator, kjo listë mu normalizua. Në disa shkolla ka me pas edukatore. Nëse ka me pas në territorin e Hasit, fillimisht do të fillojmë me Gjonajn si shkollë më e madhe edhe ja kemi dhënë premtimin. Sa i përket shkollës në Lukinje, në vitin 2018 nuk ka pas një vijë buxhetore. E dinë ti ke qenë kuvendare, për shkak të disa procedurave me letra aty për pronën. Në vitin 2019 është një pozicion 40.000 € dhe duhet me përfundua ajo shkollë. Sa i përket kuvendares Memnuna Ajdini, shkolla në Drajçiçi e dini që i ka disa probleme të cilat ne jemi dashtë mi zgjidhë. Edhe me miqtë tanë ndërkombëtarë. Sepse aty ka një problem që paraqesin kisha ortodokse serbe. Dhe ne nuk po dojmë me dramatizua edhe me politizua. Kemi fillua negociatat, ku besoj që shumë shpejt do të ketë një zgjidhje të mirë. Nuk është problem fare, po problem është lokacioni. Sa i përket shkollës në Gërçare, ne kemi tentua edhe do të tentojmë prapë. Nëse na lejohet prej një vije buxhetore që e keni në raport 120.000 € nga shkolla e Piranës mi tërheq. Ne sivjet i përfundojmë punimet. Operatori ekonomik aty është duke punuar shumë mirë. Mirëpo, është mungesë e buxhetit. Po përndryshe është duke u zhvillua në bazë të dinamikës. Do më thënë nuk ka ndonjë problem. Problem është se ne para për këtë vit nuk kemi pas të planifikuara. Nëse arrimë mi tërheq nga Pirana. Se operatori ekonomik aktualisht është duke dashtë me ndërpre atë kontratë, për arsye se ka vështirësi dhe me marrëveshje me komunën, atëherë për këtë vit ne do të tentojmë mi bartë mjetet në pozicione tjera. Ndërsa Piranën sigurisht në vitin 2019 me trajtua me prioritet. Sa i përket pyetjeve të kuvendarit Alush Shala, çerdhja publike është duke u zhvillua në dinamikë. Nuk i kam saktë të dhënat këtu, ti jap të dhënat e sakta kur planifikohet e kështu me radhë. Po është ekskluziv buxhet komunal. Shkolla në lagjen “11 Korriku” do të

ndodhe. Ne me drejtorin e Kadastrit jemi në kërkim. Janë të identifikuar tre lokacione. Po nuk është i përcaktuar lokacioni. Unë shpreh interesim që kur të vendosim për lokacione, me marrë edhe ju pjesë që jeni te ajo zonë. Në mënyrë që ju më mirë se ne e identifikoni si terren ku duhet të ndodh shkolla. Shkolla e muzikës e tha edhe kryetari, është në fazën përfundimtare. Më 28 qershor është mbyll afati dhe ka një firmë fituese është projekt i MAP-së. Mirëpo, është procedura ankimore sepse është kosto e lartë dhe po merr kohë 30 apo 45 procesi i ankimor. Pritet fillimi i punimeve. Këto ishin sa i përket infrastrukturës. Sa i përket pyetjes së rivlerësimit të nxënësve në shkollën e mjekësisë dhe në shkollat tjera të mesme. Më duhet me thënë përkundër respektit për Ilirin, që Kuvend duhet me parashtrua pyetjen drejtë dhe duhet me ditë çka ka kërkua drejtori. Drejtori nuk ka kërkuar në asnjë rast përmirësimin e notave. Drejtori ka kërkuar rivlerësimin e nxënësve. Pse ka ardhur deri te kjo. Nga se ne kur e kemi marrë një pasqyrë në Drejtorinë Komunale të Arsimit, që e kap një numër 408 nxënës me përsërit vitin. E kemi shtrua një pyetje, çka bëjnë profesorët aty. A japin mësim, a shkojnë me vlerësua nxënësit pozitiv, apo shkojnë me përsëritë nxënëset. Dhe mbi këtë bazë ne kemi bo një komision si Drejtori Komunale e Arsimit. Komisioni ka dal në vendin e ngjarjes dhe ka konstatua në bazë të procesverbaleve shkelje nga më të ndryshmet sa i përket procesit të vlerësimit. Jo vetëm në shkollën e mjekësisë, po në të gjitha shkollat e mesme. Në të gjitha shkollat e mesme ne kemi gjet gjuhë të përbashkët. Që këta nxënës të rivlerësohen edhe njëherë nga një komision i brendshëm. Përjashtua shkollën e mjekësisë. Atëherë unë kam lëshuar një vendim i cili e mbanë numrin 1981 datë 14.07.2018, me të cilin kam urdhërua shkollën që në afat brenda pesë dite me bo rivlerësim të nxënësve, i cili rivlerësim bëhet në përputhje me Udhëzimin Administrativ 50/04 pika 12 9.1 ku thotë: Çdo ankesë pa marrë parasysh sa nota të dobëta ka, kur parashtron nxënësi ankesë në vlerësimin përfundimtarë duhet ti mundësohet një komision. Këshilli i klasës bashkë me drejtorin e shkollës. Kjo nuk ka ndodh, dhe unë kam kërkua kjo me ndodh. Dhe normalisht në këtë vendim unë i kam dhënë edhe të drejtë ankimore shkollës. Shkolla e ka shfrytëzua të drejtën ankimore dhe është ankua në Inspektorat. Inspektorati është duke e trajtua ankesën e shkollës. Dhe unë po them këtu publikisht do të respektoj çdo vendim që e bjer Inspektorati i Arsimit. Cili do qoftë, në se drejtori i DKA-së ka pas të drejtë duhet të ndodh rivlerësimi. Nëse nuk ka pas të drejtë, atëherë drejtori i DKA-së, shikon mundësit e tjera. Për me ta kënaqë zemrën edhe më mirë, po të kallëzoj që para çdo vendimi drejtori i DKA-së e merr një konsultim prej zyrave ligjore të MASHT-it dhe në këtë rast unë kam kërkuar interpretim ligjor të MASHT-it kur ndërhyjnë drejtori i DKA-së me një institucion çoftë edhe vlerësimi i nxënësve. Dhe kam marrë një përgjigje, po ta tregoj Ilir, që drejtori i DKA-së ndërhyjnë në çdo kohë kur

mendon që një proces nuk p shkon mirë. Qoftë 48 orë, 60 orë, 100 orë, nuk është më rëndësi kur. Por në momentin kur DKA-ja vjen në informacion se nuk është një proces i mirë. Drejtori mund me ndërhy, dhe shkolla mund me ankimua. Prandaj, unë jam shumë i bindur, se drejtori i DKA-së në rastin konkret ka veprua mirë. Nuk ka kërkuar përmirësim të notave. Nuk do kërkoj as në të ardhmen përmirësim të notave. Po rivlerësim po, sa herë ta kërkon nxënësi. Ku ka kënaqësi më të madhe që një nxënës me ushtrua ankesë dhe me marrë një notë kaluese. Që ne nuk kemi dashtë me anashkalua mjekësinë dhe të gjitha shkollat tjera. Unë nuk e kam shfrytëzua dispozitën ligjore që ma lejon ligji që unë me bo komision të jashtëm. Përkundrazi kam thënë rivlerësoni. Tek pas atij rivlerësimi unë mundem me marrë vendimin tjetër. Po unë shpresoj që ky problem do të zgjidhet me mirëkuptim, pas një vendimi që do ta bjer Inspektorati i Arsimit. Sa i përket pyetjeve të tjera që kanë të bëjnë me institucionin e konkursit të drejtorit. Unë është e vërtetë se në këtë kuvend kur s'ka qenë kryetari Haskuka këtu, në udhëtim zyrtarë, e kam mbrojt punon e komisionit. Prapë e mbroj punën e komisionit në katër elemente. Elementet të cilat unë i kam mbrojt në aspektet procedurale. E para është kualifikimi shkollor. Të gjithë kandidatët që janë propozua që nuk janë zgjedhë për drejtor shkolle, kanë pas kualifikim, përkatësisht minimalisht 200 kredi. E dyta, të gjithë kandidatët kanë pas përvojën e duhur. E treta, të gjithë kandidatët kanë pas certifikim për udhëheqje arsimore. E katërta, të gjithë kandidatët kanë pas vërtetim se nuk janë dënuar për vepra ndaj fëmijëve. I kam mbrojt këto dhe vazhdoj me i mbrojt. Këtu ka pas një keqinterpretim, apo një pyetje të njëanshme, nga Bardh Avdaj, i cili ka thënë se një kandidat nuk ka pas përvojën e punë. Po ju them la Lush publikisht, jo vetëm ty por të gjithë kuvendarëve. Në moment kur konstatohet një veprim i tillë, nuk ka nevojë Skender Susurin me shkarkua kryetari Mytahir Haskuka. Po Skender Susuri ofron dorëheqje. Sepse Skender Susuri në asnjë rast, unë mundem me gabua. Po lëshime të qëllimshme nuk bëjë. Le të dele Bardh Avdaj dhe secili le ta thotë emrin nëse konstatohet ajo, Skender Susuri jep dorëheqje. Unë, është e vërtetë që me kryetarin Haskuka jam takua disa herë për çështjen e konkursit. Insistimi i kryetarit e tha edhe vetë ka qenë në besueshmërinë e konkursit që ky konkurs të jetë më i besueshëm për opinionin publik. Unë po shpresoj që kryetari me instrumente të reja, ndoshta ka me bo konkursin më të besueshëm. Edhe pse rrethanat në të cilat ne veprojmë janë të diskutueshme. Po them edhe njëherë publikisht, tri elemente, ky është mendimi jem personal. Që kanë ndikua në vendim marrjen e kryetarit Haskuka. Janë një, raporti që unë e kam quajtur shoqëri civile. E cila ka kalua mandatin, përkatësisht autoritetin e vetë. Kryetari ata i ka emëruar në mënyrën më të mirë që ata ti raportojnë kryetarit, jo opinionin publik. Vetë fakti se ata e kanë informua opinion publik, jo kryetarin. Nënkupton se ata nuk kanë qenë në

shërbim të mirës, po në shërbim të individëve të caktuar. S'po them subjekteve politike, sepse është marre me thënë, po të individëve të cilët janë të interesuar me bo turbulenca. E dyta, ka qenë gjuha jo etike, jo e të gathëve, e disa kandidatëve për drejtorë të shkollave. Të cilët për momentin nuk janë zgjedhë, kanë fillua me fye komisionin, që është shkelje penale. Se ka dalë në modë te na kryetar, kryeministra mu marrë me akuza. Akuzën unë duhet me vërtetua. Kandidatë të tillë nuk meritojnë edhe atëherë kam thënë me u quajt drejtorë. Mirë ka bo komisioni që se ka poentua. Dhe e treta, reagime ka pas edhe nga një pjesë e kuvendarëve të pa argumentuara. Edhe sot po e përsërisë le të dele vetëm një rast i vetëm, që këto katër elemente nuk i ka pas një kandidatë, drejtor Skenderi, jo kryetari me shkarkua, po shkarkohet vet. Emrin e mbiemrin thoni. Edhe njëherë po ju them, atë herë që mendoni që Skenderi e ka bo shkeljen, atëherë lirisht kërkoni dorëheqjen e Skenderit dhe Skenderi automatikisht jep. Nuk jam bo drejtor i DKA-së për me qenë i njëanshëm, as për dëmtua dikë. Unë kam mi trajtua të gjithë të barabartë pozitë opozitë për aq sa ma lejon mundësia edhe kushtet e mia. Po ju them edhe njëherë krejt kuvendarët që jeni këtu, derën e DKA-së e keni të qelë për çdo temë. Dhe kurrë mos më falni nëse bëjë gabim. Ama kur ta thoni ka bërë gatim, ma thoni me emër se kështu pa emra nuk është korrekt. Sa i përket përgjigjeve tjera, kryetari i grupit po them ka me ta dhënë gjithë raportin tim edhe njëherë me shkrim. Edhe pse e kam bo publik në Kuvend. Atë që e kam thënë në Kuvend me qatë nënshkrim, qëndroj prapa tyre. Por pas bisedës me kryetarin Haskuka. Kryetari ka thënë që unë po dua me rrit besueshmërinë edhe më të madhe. Unë uroj që ky konkurs me qenë edhe më i besueshëm. Bardh thuaje emrin qetu në Kuvend nëse e dish.

**Simir Krasniqi:** Unë do të ndërhy...

**Kryesuesi:** Z. Simir, ju lutem më fal. Vazhdoni me pyetje në mbledhje të radhës. I nderuar ka mbarua kjo pjesë. Nuk ju ka përmend emri. Prandaj unë e falënderoj kryetarin e komunës, falënderoj drejtorët e drejtorive të cilët kanë kthye sot përgjigje. Por drejtorët të cilët nuk i kanë kthye përgjigjet, unë i ftoj që në mbledhjet e ardhshme ti kthejnë. Ju faleminderit, pauza deri në orën 12:45, mirupafshim në vazhdimin e seancës.

Pas pauzës.

**Pika e tretë:**

**Shqyrtim – diskutim për Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Prizrenit, për vitin 2017.**

**Kryesuesi:** Raporti i Auditorit të Përgjithshëm në Kuvend është edhe obligim ligjor. Kërkoj nga anëtarët e Kuvendit nëse kanë diçka për të shtuar



rreth të gjeturave të këtij Raporti. Atëherë po vazhdojmë, kush e donë fjalën rreth kësaj pike të rendi të ditës.

**Mimoza Bushrani (LVV):** Dekadat e fundit për qytetin e Prizrenit dhe vetë qytetarët e komunës sonë, në bazë të raportit të zyrës kombëtare të auditimit, dhe pse është vetëm për vitin 2017, tregon më së miri katrahurën në të cilën është gjetur komuna e Prizrenit. Qeverisja e tashme e prirë nga kryetari Haskuka, tashmë ka filluar ti zgjidhë fijet e lëmshit të ngatërruar keq. Ky lëmsh për një kohë do ti pengoj qytetarët e Prizrenit për të ecur lirshëm, për tu shprehur lirshëm dhe për të jetuar në mënyrë më të dinjitetshme. Secili që ka ndihmuar në ngatërrimin keq të këtij lëmshi, fijet e tij do ti ketë nëpër këmbë për një kohë të gjatë. Në këtë raport voluminoz, fillimisht thuhet se gjatë 2017, komuna është paditur për shuma të konsiderueshme të obligimeve. Ku mbi 2.000.000 € janë kryer pagesa direkt nga thesari, si dhe përmes vendimeve gjyqësore. Gjithashtu sqarohet se komuna ka një rritje të obligimeve të papaguara prej 1.900.000 € në raport me vitin e kaluar. Për më tepër afro 3.000.000 € janë në procesin e procedurave gjyqësore. Dhe nëse paditë gjyqësore vendosën në favor të operatorëve pritet të ketë pasoja të rënda financiare. Këto e thotë raporti. Nëse ju kujtohet, para shtatë muajve kur kryetari Haskuka, pati dal me këto shifra alarmante. Pat skeptik që patën thënë që kryetari Haskuka po i zmadhonte gjërat. Nëse dikush është i punësuar për ta mbrojtur komunën në këto 3000 seanca gjyqësore. I bije që brenda vitit atij ose asaj duhet ti mbaj mesatarisht nga 10 seanca në ditë. Me këto veprime që i kemi ditur edhe më parë dhe ato që po dalin në dritë dita ditës. Unë mund të them vetëm një gjë. Personat që e kanë udhëhequr komunën, ia kanë gërditur profesionin secilit jurist në Kosovë, e jo vetëm në Prizren. Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ulët i tij, ka rezultuar në mos arritjen e buxhetit fillestarë edhe pse kishim rritje të buxhetit final. Njëjtë ka ndodhur edhe me ekzekutimin tek mallrat dhe shërbimet. Bile këtu dinamika e realizimit nuk ka qenë në harmoni me planifikimet. Sepse 49% e shpenzimeve janë realizuar në tremujorin e fundit. Pikërisht në periudhën e fushatës për zgjedhje lokale. Pastaj nuk është verifikuar 1/3 e pronave. Keq menaxhimi i kontratave ka rezultuar me humbje të konsiderueshme të qiradhënies. Që kanë rezultuar me humbje të konsiderueshme financiare për komunën. Dhe natyrisht ka vënë në pengesë edhe projekte tjera të mundshme. Gabimisht janë raportuar shpenzimet për mallra dhe shërbime, si dhe subvencione në vlerë prej 1.651.687 € si kategori e investimeve kapitale. Po ashtu edhe shpalosjet në pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë. Këtu nuk mund të jesh as ekonomist për ti par aq më tepër ekonomist i diplomuar për ti kuptuar. Në këtë raport thuhet gjithashtu se qytetarët janë ngarkuar me pagesa në mënyrë të parregullt dhe kjo

e ka dëmtuar raportin e besueshmërisë qytetarë- komunë. Mungesa e kontrolleve adekuate e dokumentimit, ka bërë që të dyshohet për pagesa të dyfishta, për punët që nuk janë kryer nga zyrtarët komunal. E që në fakt është dashur të krehën brenda orarit të punës, e jo ditëve të vikendit, sikur e kanë paraqitur organizatorët. Planifikime jo të sakta të projekteve kanë shkaktuar kosto shtesë. Dhe kanë krijuar dhe po vazhdojnë sfida të reja buxhetore. Realizimi i projekteve jashtë planit, ka sjellë edhe rrezikimin e objektivave të përcaktuara. Në shumë raste janë bërë pagesa për punë të papërfunduara. Njëjtë ka ndodhur edhe për artikuj të papranuar. Komuna ka paguar më shumë se sasia e pranuar. Mjetet e planifikuara të buxhetit të kaluar, nuk kanë shkuar në të mirë të qytetarëve. Kjo është bërë për shkak të vonesave në zbatimin e marrëveshjeve si dhe pagesat për gjoba nga kategoria e investimeve kapitale. Shembulli më i paarsyeshëm i vonesës për kryerjen e obligimit me kohë. Ka të bëjë me shumën prej 388.000 € të cilat janë paguar si gjobë. Pavarësisht arsyetimeve të cilët i kishin paraqitur zyrtarët e komunës. Hyrja në obligimet pa fonde të zotuara, menaxhimi i dobët i kontratave, shmangia nga procedurat e rregullta të prokurimit. Mungesat dhe garancionet e punimeve, kanë qenë vetëm disa nga parregullsitë e qeverisë së kaluar.

**Alush Shala:** Sa i përket raportit të Auditorit, deri në vitin e kaluar komuna e Prizrenit, është vlerësuar nga komunat me të mira të Kosovës sipas auditorit kombëtar. Pastaj ky raport mund të lexohet dhe të dëgjohet dhe në asnjë mënyrë të ndryshohet, sepse nuk është përgjegjësia e Kuvendit apo e anëtarëve të Kuvendit ta ndryshojnë. Nëse është bërë ndonjë shkelje, mendoj që ka organe kompetente që mund të merret çoftë me individ, çoftë edhe me grupe, nëse kanë bërë shkelje. Në asnjë mënyrë Kuvendi dhe kuvendarët nuk duhet ta marrin rolin e gjykatësit dhe të prokurorit. Andaj nëse dëshironi unë propozoj që të lexohet edhe të kalon kjo pikë pa debate, se nuk ndryshojmë gjë.

**Shukri Quni:** Sa i përket raportit, Ju tash e keni pushtetin në dorë, dhe të gjitha gabimet të janë bërë aty, i qitni ato parregullsi. Ai që ka gabuar ose që e ka keqpërdor, për atë është gjykata. Këtu mos me na mbajte ligjërata politike, por le të punon gjykata. Asnjë se kemi mbrojt as në qeverinë e kaluar, as tani s’kemi me mbrojt. Ata drejtor të cilët kanë përgjegjësi, ata japin llogari vetë. Na asnjë drejtor s’mund e detyrojmë për me dhënë përgjegjësi para nesh. Në fakt ato kërkesa që i bëjmë ne, po. Po ato keqpërdorimet është vendi ku është atje. Ne nuk e gjykojmë askënd. Edhe tjetra kryesues, ke thënë do të jem një kryesues shumë transparent edhe do të jesh i barabartë për të gjithë. Rasti i tretë është duke të ndodhur sot, sinqerisht po të them. Kam shpresua tek ti që më të vërtetë ke me udhëheqë këto katër vjet, inshallah si mbërrini këto katër vjet në këtë mënyrë. Se situata është ka del prej kontrollit. Çdo kuvendarë që është

këtu, kur i përmendet emri, ti duhet me ja dhënë fjalën. Pa marrë parasysh, ai le të shprehet, le ta thotë. Unë tani jam duke dyshuar që ti vetë je duke e pru gjendjen në këtë farë forme që me eskalua. Duke i parë që në kuvendin poshtë, policia po rrinë, tre katër policë po rrishin. Mos e ke ndërmend edhe këtu me pru, sigurim apo polici. Gabon, singerisht e kam, gabon. Sepse ne vetë jemi popull që sado që merr hov flaka, ne veç qesim benzinë në te, nuk ka nevojë. E di që këtu ka reagime të ashpra, por jo provokative, jo me provokua këtu. Situatën mos e le me të eskalua më. Nuk ka nevojë me kalua prej pike në pikë, edhe mos mi lënë këtu kuvendarët me fol, le të diskutojnë.

**Ilir Baldedaj:** Seriozisht është bërë modë nga LVV-je, që tetë muaj me këto padi, e çështje tjera të gjykatës dhe të borxhit enorme. Po jua rikujtoj se që tetë muaj jeni në pushtet, komuna e Prizrenit nuk ka zyrtarë që e përfaqëson komunën në gjykatë. Një zyrtarë që e kanë ngarkuar, ai nuk e ka të dhënë provimin e jurisprudencës. Që është në konflikt, se ai nuk ka të drejtë me përfaqësua komunën si avokat i komunës. E keni marrë një kontratë me shërbime të veçanta, dhe ai ka dhënë dorëheqje. Dhe aty ka lëndë që nga 1968-ta. Dhe ka lëndë që nga partneri i juaj LDK-ja i ka lënë. Dhe në vazhdimësi keni me pas. Harroni më këtë çështjen e padive. Se për çdo ditë edhe juve po ju shtohen paditë në gjykata. Për rastet e qytetarëve kontestuese, është e drejtë e secilit qytetarë me u marrë me atë çështje.

**Kryesuesi:** Ta keni parasysh se raportin e Auditorit të përgjithshëm nuk e bënë komuna e Prizrenit. Është organ i pavarur i themeluar me vendim të Kuvendit dhe i nënshtrohen të gjitha komunat një raportit vjetor, ku bënë analizat e pasqyrave financiare dhe në fund publikohet ai raport. Ligji e ka kërkuar që çdo komunë në mbledhje të Kuvendit ta hedh në diskutim tek anëtarët e Kuvendit. Ne nuk mund as ta votojmë, thjesht karakter informues. Është dashtë me bo këtë edhe në mandatin e kaluar. Por se tash thjesht duhet me diskutua. Në qoftë se nuk ka dikush tjetër, atëherë po vazhdojmë me pikën tjetër.

#### **Pika e katërt:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimvendimit për themelimin e Komisionit Komunal, për zgjedhjen e këshillave, të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, në territorin e Komunës së Prizrenit.**

Për këtë pikë ftoj sponsorizuesin e kësaj pike, drejtorin e Administratës Osman Hajdarin, që të merr fjalën d të bëjë sqarime të nevojshme se për çka është fjala.

**Osman Hajdari, drejtor i Drejtorisë për Administratë:** Edhe në KPF-në, pas disa vërejtjeve të anëtarëve të komitetit. Fjala është për një komision, i cili do të vazhdon punën të mandatit të kaluar, i cili për shkak të përfundimit të mandatit e ka përfundua punën. Në bazë Rregullores për organizim dhe bashkëpunim të komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e komunës së Prizrenit të vitit 2014. Mbi bazën e nenit 4. Asambleja komunale e formon një komision për zgjedhjen e kryetarëve të bashkësive lokale. Në ndërkohë, ua kemi përcjellë ndoshta me vonës një material ku është lista e kryetarëve aktual të fshatrave dhe lagjeve edhe viti i emërimit. Realisht vendimet janë bërë pak më vonë. Vendimet janë krejt të vitit 2017. Mirëpo, ato data janë kur janë përzgjedh. Në ato vende ku janë zgjedh me një fshat, mbi bazën e asaj datës prodhohet ky mandat. Kryesisht shumica e kanë edhe ka dy vite, një vit e gjysmë, ka edhe një vit. Mirëpo, është edhe një listë e bashkësive lokale që nuk kanë kryetar. Ta zëmë disa s'po i numëroj, Vlashnja e disa tjera. Mbi bazën e këtij është kjo rregullorja shumë e qartë, edhe anëtarë të Kuvendit të komunës, një nga ekzekutivi, një nga shoqëria civile dhe një përfaqësues i fshatit ose i lagjes kudo që mbahen zgjedhjet. Ky komision formohet edhe vazhdon punën e që tyre shtatë, tetë lagje. Në ndërkohë ka edhe disa lokalitete ku ka zgjedhje ta zëmë ka dhënë dorëheqje. Duhet me rishikua atë proces për me qenë ligjor. Në këtë pjesën tjetër për të cilën kam diskutua edhe në KPF-në, janë pajtua do më thënë mos me diskutua këtu. Do të jetë pastaj një komision për me pa këtë rregullore e të drejtave të këtyre kryetarëve. Krejt poenta sot çka kërkohet është formimi i një komisioni për me vazhdua punën. Krejt materialin çka e ka Drejtoria e Administratës edhe sektori i shërbimit të Kuvendit do ti kenë komisionet edhe ky komision vazhdon punën për disa për zgjedhje të reja që do të mbahen gjatë kësaj periudhe.

**Kryesuesi:** Atëherë para se t'ia kaloj fjalën anëtarëve të Kuvendit. Komisioni do të përbëhet prej pesë anëtarëve. Dy anëtarë zgjidhen nga Kuvendi i komunës, një anëtarë nga ekzekutivi, një përfaqësues i fshatit dhe një anëtarë nga shoqëria civile. Shkojmë me shefat e grupeve fillimisht.

**Simir Krasniqi:** Ne si grup parlamentar i PDK-së edhe në KPF-në, jemi të pajtimit që komision të zgjidhet përkohësisht. Vetëm për zgjedhjen e atyre këshillave të fshatrave dhe lagjeve të qytetit aty ku nuk janë zgjedhur. Apo për arsye të ndryshme ndonjëri prej tyre ka dhënë dorëheqje. Kurse sa i përket zgjedhjes së përhershme të komisionit si e tha edhe drejtori. Që do të ketë kompetenca më shumë dhe do të jetë më profesional, që të zgjidhet më vonë. Po kisha një pyetje për drejtorin. Nuk mu duk e arsyeshme kur tha që vendimet janë bo më vonë, kurse zgjedhja është bo më herët. Si mund ta ndryshosh ti vendimin. Unë e di që vendimi është më i fuqishëm se zgjedhja. Ato ndoshta do

të bëjnë ankese, thotë i kam edhe tri vite. Qysh do ta ndryshon vendimin që do ti thuash edhe një vit ke mandat. Në qoftë se ka mundësi me ma sqarua këtu. Ne do ta përkrahim këtë zgjedhjen.

**Adem Shabanaj:** Tash nuk e di a duhet me propozua apo.

**Kryesuesi:** Jo, njëherë a e mbështetni, pastaj me propozime.

**Shabanaj:** Sigurisht që e mbështesim.

**Haziz Hodaj:** E mbështesim edhe ne.

**Illir Baldedaj:** Desha veç një sqarim për shkak që kam qenë mandatin e kaluar pjesë e atij komisionit. Ata që kanë dhënë dorëheqje rregullorja thotë nga pesë anëtarë apo shtatë anëtarë që janë të përzgjedhur. Njëri prej këtyre do të thotë ai këshillë prapë ka të drejtën nga ai këshillë që ka qenë ta emëroj kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin. Ndërsa ajo është e vërtetë se vendimet janë lëshuar më vonë, sepse e kemi pritë me përmbyllë procesin, ka zgjatë bajagi gjatë. Sepse nuk është lehtë sepse është forma e pagesës që bajagi është problem. Por ne do ta mbështesim në parim, sepse është çështje ligjore. Unë nuk jam më pjesë e atij komisioni, Kujtim Gashi s'është, Hazizi s'është. Dhe natyrisht që duhet të kompletohet ai komision.

**Ganimete Babuna (Nisma Socialdemokrate):** Ne e mbështesim themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, të vendbanimeve dhe të lagjeve. Mirëpo, kemi një propozim që të rishqyrtohet edhe lista me emra të kryetarëve të fshatrave dhe të lagjeve. Sepse në përzgjedhjen që është bërë në të kaluarën ka pas shumë parregullsi. Unë po e përmendi vetëm një. Pra, në fshatin Muradem, ku ky fshat nuk numëron më shumë se 30 shtëpi, kemi dy këshilla të zgjedhur.

**Sencar Karamuço (KDTP):** Edhe ne do të mbështesim formimin e komisionit.

**Memnuna Ajdini:** Koalicija Vakati predlaže da u selima Župe i Podgore obavezno bude jedan član iz manjinskih zajednica. To jest u zavisnosti od toga u koje selo, ko je podenik da jedan član bude upravo iz te partije.

**Kryesuesi:** Atëherë ti marrim propozimet prej Kuvendit, dy anëtarë që duhet ti zgjedhim. Më qenë se edhe më herët ka qenë kështu, atëherë le të mbetet kështu. Një propozim le ta bënë pozita, një propozim le ta bënë opozita.

**Adem Shabanaj:** Karanfil Haxhillari prej koalicionit.

**Simir Krasniqi:** Ne propozojmë Sulltan Badallaj.



**Kryesuesi:** Propozimet prej Kuvendit janë dy: Karanfil Haxhillari, Sulltan Badallaj dhe krahas votimit të këtyre emrave, ne marrim votim edhe për themelimin e këtij komisioni.

**Fatmir Kastrati (AAK):** Unë e kam vetëm një çështje teknike. Drejtori i Administratës është mirë me pas kujdes te emrat e rrugëve, që janë në atë listë e pash. Unë nuk e di cila është lagja Bazhdarhana, ose cila është lagja Ortakoll, ose lagja e UÇK-së. Nuk ka lagje të tilla në Statutin e komunës. Janë lagjet të cilat janë të përcaktuara. Prandaj duhet me pas kujdes, se lagja Bazhdarhana s'po di tash. Edhe Kurilla edhe "2 Korriku" si është e rregulluar kjo punë. Mua ma merr mendja që në Statut të gjitha vendbanimet janë të emëruar ashtu qysh duhet.

**Behar Begaj (LDK):** Edhe pse sot është zgjedhja e këtij komisioni. Unë desha të kyçem edhe të shtoj me këto këshillat lokal. Ne e dimë se këto zgjedhje janë mbajt për herë të parë në vitin 2015. Janë bërë si janë bërë këto zgjedhje, me shkelje pa shkelje e dimë të gjithë atë. Unë kisha me shtua edhe diçka. Ku dihet që janë nëpër fshatra 73 këshilla lokal, e 17 nëpër qytete. Edhe 15 këshilla lokal nuk janë zgjedhur nëpër fshatra. Unë kisha kërkuar nga ju kryesues dhe nga drejtori i administratës, që të shqyrtohet zgjedhja e këtyre dhe në të ardhmen mos të shkon kështu siç ka shkua deri tash. Ku dihet se këshillat lokal nuk kanë qenë shumë funksional, për arsye se nuk kanë pas mbështetje nga Drejtoria e Administratës, apo nga Kuvendi komunal. Jemi të gjithë dëshmitar të kësaj, se unë jam edhe vetë kryetar i bashkësisë lokale në Zhur, këtë e dinë gjithë. Nuk kemi pas një përfillje aq të mirë nga Kuvendi komunal, asnjëherë. Nuk kemi qenë të ftuar si kryetar të bashkësive lokale, përpos që kemi pas disa debate disa ftesa nga KDI-a e shoqata joqeveritare. Unë kisha thënë se është numër ndoshta i madh 90 këshilla. Kisha më thënë që të shqyrtohet dhe të gjendet një mundësi që përafrohen disa këshilla, që të formohet, qoftë edhe një zyre nëpër disa fshatra. Që ti mbuloj edhe disa fshatra përreth dhe aty ti mbulohen shpenzimet e asaj kryesie, aty që zgjidhet në atë lokalitet. Tu mundësohet pajisja me zyre, të pajisen me inventarin i cili i takon me pas. E jo deri tash mund të them deri para një viti, kam ble me shpenzimet e mija gjitha sendet. Edhe sot e atë ditë me shpenzimet e mija personale i shërbej të gjithë qytetarët e Zhurit edhe më gjerë.

**Osman Hajdari:** Sa i përket emërtimit të lagjeve Fatmir, është një listë të cilën e kam gjet në një dosje. Nuk janë procesverbalet e zgjedhjeve. Data e vendimeve Simir është kështu. Këta kanë fillua mi zgjedhë ta zëmë në vitin 2015, përmes një procedure në Kuvend të një fshati ose një lagje. Po shtypjen e vendimeve ish drejtori i Administratës e ka bërë në vitin 2017. Kështu që

mandati i datës së zgjedhjes për atë këshill. Që normal ishte dashtë me pas një procesverbal, nuk ka. Krejt këtë listë që e ka bo shërbimi i Kuvendit është bo mbi bazën e vendimeve. Në Statut nuk i kemi dy Muradem, që e ngriti Ganja. Mirëpo, ndodh janë dy vendime për dy kryetar të asaj bashkësisë lokale. Konsideroj që ndoshta komisioni i ri e rishikon krejt, në bazë të kompetencave që ka. Përndryshe ky komision mandatin e fillon pika 6 e nenit 4, pas përfundimit të procesit zgjedhor. Do më thënë kur të kompletohet krejt të këtyre 73 fshatrave e lagjeve. Ky këshill faktikisht e pushon aktivitetin, mandati i këtij është thjesht përzgjedhja. Në do raste Ilir, ku ta zëmë ata e kanë zgjedhë bashkësinë, po ne që ky komision e rishikon a është brenda atyre kompetencave ligjore a jo. Behar unë e di që keni telashe. Disa jeni edhe kuvendarë, kryetar të fshatrave, ka telashe. Çështjen e vulave jam mundur me rregullua, nuk ka kalua në ministri. Prapë është Kuvendi, po mendoj që ndoshta në seancën kur të kthehemi në shtator, bashkë me grupet parlamentare do sponsorizojmë plotësim-ndryshimin e kësaj rregulloreje. Për me pa formën ligjore njëherë të kompensimit të këtyre këshillave. Kompetenca ligjore, zyrat, pajisja me material teknik, çështja e vulave, çështja e funksionimit. Ndoshta edhe në riorganizimin e administratës komunale, duhet me qenë një sektor i veçantë për bashkësitë lokale. Ka thjesht mundësinë e koordinimit të punëve më mirë në terren. Gane nuk do ta rishikojnë, ky komision nuk ka mandat me rishikua mandatin e kryetarëve të kaluar. Ata janë zgjedh forma ligjore. Nuk dojmë me paragjykua formën e zgjedhjes, a kanë qenë të mira a të këqija, a manipulative, politike, ajo neve s'na takon. Këta anë edhe një vit mandat. Konsideroj që ky komision me bo një punë jashtëzakonisht të mirë mi zgjedh njerëz të përgjegjshëm që donë me punua. Pavarësisht bindjeve politike, pavarësisht këta janë qytetar thjesht që kanë ngritë çështje të qytetarëve, sigurisht që është interes i përgjithshëm. Edhe i qytetit edhe i krejt partive politike, mi pas këta njerëz të përgjegjshëm në rend të parë. Po ndërkohë këta duhet mi stimulua. Se faktikisht krejt puna është aktualisht në baza vullnetare.

**Alush Shala:** Kryesues a mundësi t'ia parashtroi drejtorit një pyetje. Për këto çështje kemi bisedua edhe në KPF-në, dhe realisht je shumë korrekt. Mirëpo a keni mendua dhe pse nuk po kërkon që të krijohet edhe komisioni për ankesa. Sepse ata që i emërojmë, nuk besoj që duhet me pas edhe të drejtë ti qajnë hallet edhe të atyre që ankohen. Pasi veç jemi në qetë procedurë, mos është në rregull, apo t'ia lëmë organeve kompetente nëse ka tjera.

**Hajdari:** Tash nuk kam ndonjë farë përgjigje kështu direkte me dhënë. Se s'kam farë informacioni të saktë. Ndoshta mirë është si Kuvend me pas një komision të ankesave për krejt formimet e trupave të Kuvendit. Nuk e di a duhet për çdo komision me pas komision të ankesave. Po ndoshta është mirë Kuvendi,

nuk e di tash baza ligjore, ligji mbi vetëqeverisjen lokale edhe Statuti i komunës, qysh e lejon. Është ndoshta ide me diskutua një komision i ankesave të Kuvendit që mundet me qenë e trupave të përhershme për krejt mandatin katërvjeçar. Ku kishte mi trajtua këto ankesa. Edhe natyrisht Administrata ta mbështet në aspektin profesional me juristët që ka administrata. Po e shqyrtojmë si ide.

**Ilir Baldedaj:** Drejtor, dosjen e ke në zyrën poshtë, jo në zyrën lartë. Procesverbalet i ke të gjitha aty. Dhe secilin vendim e ke pas në procesverbal. Dhe forma e nënshkrimit dhe të gjitha ato janë dokumentet në zyre. Nëse s'mund ta gjeni, vi ju tregoj, jo në katin e tretë po në katin e parë.

**Haziz Hodaj:** Është e vërtetë që ka pas hapësirë për dyshime edhe për ndërhyrje. Por unë kam kërkuar edhe kur është debatuar rreth statutit të zgjedhjes të këtyre kryetarëve fshatrave. Që nëse nuk e merr KQZ-ja si barrë punën e tyre, gjithmonë ka hapësirë për interpretime të ndryshme edhe për dyshime. Unë po ju lus edhe po ju them që merrni pjesë në zgjedhjen e tyre. Nëse bëhen në këtë formë çfarë janë zgjedh. Sigurisht që ka me pas hapësirë të vazhdueshme, sepse është e pamundur. Sepse nuk ka asnjë lloj infrastrukture për me bo zgjedhje. Thjesht ka qenë ftesë publike e fshatrave nëpër mbledhje të caktuara. Ato parti që kanë qenë më të zëshme edhe më të organizuara, ato kanë arrit mi sigurua votat edhe mi zgjedh kryetarët e fshatrave. Kjo ka ndodh është e vërtetë. Ka ndodh edhe jashtë dëshirës së neve anëtarëve të komisionit ndoshta ndonjë përzgjedhje naj kund. Mirëpo, nuk mundësi asnjëherë as s'ka me pas, derisa nuk e merr KQZ-ja përsipër edhe zgjedhjen e këshillave të fshatrave. Kështu që unë drejtor kërkoj që në të ardhmen në zgjedhjet tjera, në krye të mandatit të këtyre zgjedhjeve të merret KQZ-ja me përzgjedhjen e tyre. Dhe natyrisht të merren përsipër edhe këto shpenzimet edhe kjo kostoja. Sepse asnjë sot s'ka me të bo punë hangarije si përpara që kanë bo. Por nëse e merr dikush mandatin e zgjedhjeve, atëherë do duhej edhe të kompensohen. Përndryshe s'ke me pas efektivitet, as s'ke me pas kualitet në zgjedhje.

**Behar Begaj:** Drejtor, unë kam shumë ankesa prej këtyre përfaqësuesve lokal që janë të zgjedhur të këshillave lokal. Të cilët hasin në probleme me drejtorët, thonë që nuk i pranojnë në takime, nuk ja hapin dyert e kështu me radhë. Ju kisha lut që ta keni parasysh, dhe të bisedoni me të gjithë drejtorët. Që kryetarët e këshillave lokal të kanë të drejtën e tyre për me bisedua me drejtorët shumë.

**Hajdari:** Po e nisi me Hazizin, do të bëjmë përpjekje të bëjmë kërkesë te KQZ-ja edhe me pa kompetencat ligjore të KQZ-së, sipas ligjit të zgjedhjeve, a kanë qasje a jo. Ne po i referohemi një rregulloreje të cilën e ofron ky Kuvend.

Edhe është kompetencë e Kuvendit tash me pa forma ligjore. Nëpër zyre, Behar besoj se secili drejtor i ka ato oraret për takime, nuk besoj që ka telashe. Nëse ka kësi lloj telashe adresoj, bashkë me kryetarin besoj që nuk me pas telashe edhe për qytetarë të thjeshtë mu takua. E mos të folmi për organet që ne vetë i zgjedhim. Ilir, s'desha bre mu marrë me ty, por të ftoj me ardhur në zyre në katin e parë, me mi gjet dosjet. Nëse i gjen dosjet do të qoj në drek. Një follder e ke krejt, me do vendime, pa asnjë procesverbal. Gjysma e vendimeve mungojnë. Bindu që para 2013 i kishin mbajtur do follder pak më mirë. Të vitit 2007-2008 janë do procesverbale, nuk i keni mbajtur. Kështu që mundesh me ardhur. Pse kam lëvizë prej zyrës. Drejtorët më mirë është me lëvizë në katin e tretë, se qytetarët. E ke lënë një Drejtorin të Mirëqenies Sociale me tri zyre. Drejtori në katin e parë, një koordinator në katin e dytë, në zyrtarë në katin e tretë. I kam ul i kam bo bashkë, e kom liruar zyrën e drejtorit të Administratës. Bindu, hajde në katin e tretë jam në kushte më të dobëta teknike, se drejtori ku ke qenë ti. Po qëllimi është thjesht mi shërbye qytetarëve ato shërbime mi bo njëjtë. Përndryshe të ftoj, hajde gjej dosjet, krejt i ke 2015, se 2017 po më duket s'ke punua hiq. Ke qenë nëpër fushata diku a Zoti e di ka je kon Ilir.

**Kryesuesi:** Ka mundësi disa dosje s'jam i sigurt munden me qenë në zyrën time, nuk jam i sigurt.

**Baldedaj:** Drejtorin Osman ju ka rrit mendja, po mendon se Prizreni fillon me administratën dhe përfundon me të. Para Osmanit ka qenë Iliri, para Ilirit ka qenë Miniri, Naseri, Ragip Gajraku, e kanë kalua plot tjerë. Unë që tetë muaj nuk kam qenë në atë zyre Osman. Kur e ke bo pranimit-dorëzimin ke mund me më thirr pas një jave me ti dhënë dosjet. Ato çka të kanë interesua. Po s'ke pas kohë, se ke qenë duke u marrë me çështje tjera. Tash po më fton. Po sido që të jetë, unë do të vij për shkak të korrektesisë. Veç gjithë kuvendarëve për maltretimin që ua bërë ke me pagua drekë.

**Hajdari:** Ilir, mos e kthe personale. Se kam rritë mendjen hiq, edhe pas Osmanit ka me pas drejtorë e drejtorë. Edhe kjo qeveri ka me pas kryetar, e pas kryetar. Të gjithë asamblistëve edhe nëse s'gjenen dosjet, ua qes një drek pa kurrfarë problemi. Shiko, të bëhem pak më serioz. Shumë sinqerisht, ne këtu po japim përgjigje publike. Vetëm një follder është unë kam kërkua edhe prej shërbimit të Kuvendit, përkatësisht Blerim Rakës, edhe ai s'ka mund me gjet. Kështu që këto vendime që ti kam gjet, ajo listë është. Nëse gjejmë ndonjë dokument tjetër prapë i postojmë. Ai komision ndoshta mundet me pas edhe personale. Këtu nuk ka ndonjë gjë personale, nuk është e vërtetë absolut.

**Kryesuesi:** Kuvendi në propozim-vendimin për themelimin e komisionit për zgjedhjen e bashkësive lokale në lagje dhe në fshatra, ka bërë dy propozime:

Karanfil Haxhillari, Sulltan Badallaj. Së bashku me këto dy propozime ne sot marrim vendim edhe për themelimin e këtij komisioni. Duke u bazuar në propozimin që e keni përpara, 33 anëtarë jemi prezentë në sallë dhe e hedhë në votim, kush është për?

Të gjithë.

Kundër? – S’ka.

Abstenim? – S’ka.

Atëherë konstatoj se unanimitisht formohet komisioni Komunal, për zgjedhjen e këshillave, të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, në territorin e Komunës së Prizrenit.

### **Pika e pestë:**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për formimin e Komisionit për Themelimin e Orkestrës së Komunës së Prizrenit.**

Po ashtu edhe në mbledhjen që e patëm në KPF, u diskutua kjo çështje. Ideja është që të themelohet një komision, ku do ta trajtoj mundësin për themelimin e këtij institucioni kulturë, gjithmonë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi. Pastaj, pas takimeve që i bënë ky komision i cili përbëhet nga organet e ndryshme, nga institucionet e ndryshme, nga shoqëritë e ndryshme. Në fund të vije me një vendim valid që është i zbatueshëm, i ekzekutueshëm. Edhe pastaj të merr formën që duhet me marrë dhe uroj që kjo punë të bëhet. Për këtë arsye më qenë se nuk ka rast në Kosovës, ku është themelua një institucion i tillë. E kemi pa të arsyeshme që fillimisht me shkua me një komision. Dhe detyrat për hartimin e krejt këtyre dokumentacioneve, propozimeve, të shqyrtohen brenda këtij komisioni. Dhe në fund neve këtu të na bije si një propozim final, i zbatueshëm dhe në pajtim me ligjin. Ky komision duhet të përbëhet nga gjithsej nëntë anëtarë. Një anëtar propozohet nga kryetari i komunës, dy anëtarë propozohet nga Kuvendi i komunës, një anëtar do të propozohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që kanë thënë se kanë gatishmëri me ardhur, dy anëtarë do të propozohet nga komuniteti i artistëve të qytetit. Dhe në këtë rast e kemi pa të arsyeshme që të jenë këtu dy iniciatorët e formimit të orkestrës. Një anëtar do të propozohet nga rrjeti i organizatave të kulturës rok, një anëtarë do të propozohet nga Filarmonia e Kosovës, më qenë se është orkestra e vetme si institucion publik që funksionon në Kosovë. Dhe do të ishte shumë besoj një bagazh përvojash që mund ti ndante rreth themelimit edhe të kësaj orkestre që po synojmë në Prizren. Dhe në fund një anëtar nga



Drejtoria komunale e Kulturës, Rinis dhe Sportit, e cila do të merren me gjithë mbarëvajtjen e këtij procesi. Natyrisht që i takojnë me ligj. Tani hap diskutimin.

**Simir Krasniqi:** Pasi që ne si grup parlamentar i PDK-së, në mbledhjen e KPF-së, u kërkua që të largohet filarmonia e komunës së Prizrenit. Pra, të jetë vetëm orkestra e komunës së Prizrenit. Ku dihet mirë se në Republikën e Kosovës është vetëm një filarmoni, dhe ajo është e Kosovës. Dhe mund të themi që buxheti i sajë është mbi 1.000.000 € Nuk e di se si komuna e Prizrenit, do ti përballoj kërkesat e filarmonisë së komunës së Prizrenit. Ne kemi kërkuar që të largohet filarmonia dhe vetëm të jetë si orkestër. Kur dihet që në të kaluarën orkestra e komunës së Prizrenit ka funksionuar vetëm si OJQ. Dhe atë ndoshta pas formimit të sajë s'ka pas fonde, apo ka pas vështirësi në funksionimin e sajë, e kështu më radhë. Ne si grup parlamentar e mbështesim si orkestër dhe lusim nga ky komision që ta themeloj sa më shpejt që është e mundur dhe të funksionoj më së miri në qytetin e Prizrenit. Pra si orkestër, por jo si filarmoni. Por unë mendoj se komisioni nuk mund ta themeloj fare, ku puna e keq qeverisjes së Haskukes po shihet. Ku dështoj festivali i "Zambaku i Prizrenit". Një festival tradicional i komunës së Prizrenit. Po ashtu dështoj edhe festivali "Flutura" për fëmijë e kështu më radhë. Andaj ne e mbështesim vetëm si orkestër, dhe jo si filarmoni e komunës së Prizrenit.

**Agnesa Sinanaj:** Unë vetëm desha me pyet se e kam lexua vendimin e anëtarëve të komisionit. A ka ndonjë profesor të shkollës të muzikës aty? Oke mirë.

**Kryesuesi:** Atëherë kështu, ne duhet ti propozojmë dy anëtarë prej Kuvendit. Edhe dy nga komuniteti i artistëve, do të thotë edhe që janë iniciator të kësaj, që në këtë rast është Blerim Byqyqi dhe Nazim Tara këtu. Pastaj këto institucionet tjera që janë OJQ-të, le të propozojnë vetë me një shkresë, apo me një ndonjë gjë të tillë. Shkojmë pra me dy propozime, le ta bënë një propozim pozita, një opozita.

**Simir Krasniqi:** Të sqarohemi, a do të jetë filarmoni apo orkestër.

**Kryesuesi:** I nderuar ne u morëm vesh në KPF. Vërejtja juaj qëndron, është hequr filarmonia dhe ka mbet vetëm orkestra e qytetit.

**Simir Krasniqi:** Në anëtar të komisionit, unë e shohë të tepërt këtu, që të jetë edhe një anëtarë i Filarmonisë së Kosovës, kur është larguar Filarmonia.

**Kryesuesi:** Duke u konsultuar edhe me njerëz, e pamë të arsyeshme më qenë, se Filarmonia është i vetmi institucion në Kosovë, që është i natyrës së tillë. Do të kontribuonte shumë me një anëtar në formimin e orkestrës së qytetit. Nëse e shihni të arsyeshme me heq Filarmoninë, ne e heqim po kam frik që

gabojmë. Se janë të vetmit kompetent që mundën me ndihmua këtë punë. Edhe një herë, fjala është për orkestrën e qytetit, me propozimin në KPF, nga Simir Krasniqi. Është heq pjesa e Filarmonisë, është veç pjesa e orkestrës së komunës së Prizrenit. Atëherë po kalojmë tek marrja e propozimeve. Në këtë rast koalicioni, pozita a keni ndonjë propozim, z. Hodaj.

**Haziz Hodaj:** Po ne e propozojmë Sadije Osaj.

**Kryesuesi:** Nga opozita, ose do të ishte mirë Ilir Baldedaj me qenë këtu, se ai e pat gërit herën e fundit. Po sidoqoftë është çështje e opozitës kjo.

**Simir Krasniqi:** Ne e propozojmë Dafina Bllacën.

**Kryesuesi:** Propozimet nga Kuvendi janë: Sadije Osaj Jakupi, dhe Dafina Bllaca, kurse nga komuniteti i artistëve Blerim Bytyqi, Nazim Tara. Kurse pjesën tjetër i përcjellin këto institucione. Me shpresën të shfaqin gatishmëri me ardhur me ndihmua këtu. Atëherë 32 jemi prezentë në sallë, e hedhë në votim së bashku me propozimet e juaja që i diskutuam këtu, kush është për?

Të gjithë.

Kundër? – S’ka.

Abstenime? – S’ka.

Atëherë unanimisht me 32 vota themelohet komisioni për themelimin e orkestrës së qytetit.

**Pika e gjashtë:**

**Informatë mbi raportin e performancës së Komunës së Prizrenit për vitin 2016 – 2017.**

Fjala është për një raport që bënë vlerësimin e ekzekutivit të viteve të kaluara. Këtu i kemi përfaqësuesit e këtij komisioni që e kanë hartuar raportin. Unë besoj se e keni marrë materialin me kohë. Nëse doni me ardhur me lexua i thërrasim me lexua, nuk është problem. Besoj që e keni pas rastin me shqyrtua. Eventualisht nëse dikush ka pyetje rreth këtij raporti. Besoj e kanë gatishmërinë anëtarët e komisionit me dhënë përgjigje të duhura. E hapim diskutimin. Nëse nuk ka kjo pikë nuk votohet, sepse është vetëm informatë.

**Pika e shtatë:**

**Shqyrtimi i raportit financiar për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2018.**

Për këtë pikë e ftoj drejtorin për Financa z. Ertan Simitçi që ta merr fjalën.

**Ertan Simitçi, drejtor për Ekonomi dhe Financa:** Raporti për realizimin të buxhetit për periudhën janar-qershor i vitit 2018 është përfunduar nga Drejtoria e Financave dhe i ju është shpërndarë të gjithë kuvendarëve, drejtorëve edhe të gjithë zyrtarëve kompetent. Buxheti i komunës së Prizrenit për vitin 2018, është rreth 48.600.000 € Ndërsa nga granditë qeveritare është planifikuar rreth 36.400.000 € Nga të hyrat vetanake rreth 8.100.000 € Të hyrat e bartura nga viti 2017 në vitin 2018, rreth 3.200.000 € Donacionet në total janë 365.519 € Deri në fund të qershorit është alokuar rreth 30.900.000 € Ndërsa shpenzimi është bërë deri në 18.600.000 € Ose 60% të planifikimit sipas alokimit, ose 38% të realizimit të buxhetit në total. Të hyrat vetanake, planifikimi është rreth 8.121.284 € Ndërsa inkasomi i të hyrave është rreth 3.100.000 € ose 39% të realizimit. Në krahasim me vitin e kaluar 5% është rënie. Kurse në krahasim me vitin 2016 rreth 11.5% është rritja. Në kategorinë e tatimit në pronë është inkasuar 1.082.439 € Në menaxhimin e mbeturinave 570.408 € Në lejen e ndërtimit 405.371 € Shfrytëzimi i pronës 153.016 € Nga shpenzimet apo të dalat e buxhetit në kategorinë e pagave 49%, apo 9.700.000 € Në mallra dhe shërbime 38%, ose 2.300.000 € Në shpenzimet komunale 31%. Në subvencione 36% ose 195.546 € Dhe në investimet kapitale me 29% ose 5.600.000 € Vjen në total me 38% të realizimit të buxhetit. Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, realizimi i buxhetit është rreth 50% të realizimit. Në Arsim 40% dhe në Shëndetësi 23%. Obligimet ndaj komunës deri në fund të qershorit kanë qenë 17.100.000 € Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, i keni edhe në raport të gjitha shënimet sipas kategorive. Unë dua ti cek disa kategori të cilat çdo herë në kuvend diskutohen. Shpenzimet për udhëtimet brenda vendit rreth 201.902 € Shpenzimet jashtë vendit 707.278 € Shërbimet kontraktuese 1.138.596 € Drekat zyrtare 23.414 € Vendimet e gjykatës dhe procedurat përmbarimore dhe nga pagesat e thesarit që merren është rreth 1.159.456 € Në investimet kapitale në ndërtimin e rrugëve është shpenzuar rreth 2.100.000 € Në kanalizim 110.468 € Në ujësjellës apo në shërbimin e ujit 589.000 € deri në fund të qershorit. Dhe në mirëmbajtjen e investimeve kapitale është 1.800.000 € Raportin e keni pranuar të gjithë. E tha edhe kryetari që rishikimi i buxhetit sivjet nuk do të bëhet. Në bazë të njoftimit të Qeverisë qendrore. Në shtator jemi duke e përgatit tash rialokimin e mjeteve, që jemi në proces. Besoj që në seancën e shtatorit do ta prezantojmë, që ta aprovoni. Që deri në fund të vitit mos me pas komuna mjete që janë në suficit, apo të pashpenzuara.

**Agnesa Sinanaj:** Gjatë analizimit të raportit gjashtëmujor, del se kjo qeveri është e luksit dhe jo e punës. Për dallim nga premtimet e tyre ku thuan të kundërtën. Dhe këtë e vërteton ky dokument zyrtar i gjashtëmujorit të shpenzimeve. Kjo qeveri në kategorinë e shpenzimeve jashtë vendit ka

shpenzuar rreth 8.000 € Më saktësisht 7.878 € Ndërsa në mëditje dhe udhëtime zyrtare del që janë shpenzuar rreth 10.000 €, apo 9.589 € Artan për kuptua më mirë ju edhe për me ua shpjegua qytetarëve këtë shumë, që ju më herë i konvertojshin në qebapë. Unë po ua konvertojnë mantija edhe po ju kallëzoj që më dalshin sipas llogarive të mia mbi 200.000 copa. 10 cent është një manti, se ato ju nginë më shumë. Për atë e ktheva, se qebapa... Edhe e pyes drejtorin e Financave si ka qenë në mandatin e kaluar gjendja e këtyre kategorive. Te furnizimi për zyrë, kryetari ka thanë se do e shes inventarin e shtëpisë së bardhë. A pikërisht në këtë kategori kjo qeveri ka shpenzua hiq më pak se rreth 100.000 € 98.349 € E kisha lut kryetarin me ma shpjegua, qysh e shpjegon ai këtë send. Kërkoj sqarim me furnizime me dokumente blanko me kodin 13611 në vlerë prej 12.013 € Duke pa shpenzimet për luksin e kësaj qeverie del se më shumë u ka interesua se si ti shpenzojnë taksat e qytetarëve në mëditje e udhëtime brenda e jashtë vendit. Se sa me krijua shpenzime në investime kapitale, ku prekin drejtpërdrejtë mirëqenien e qytetarëve. Në këtë dokument zyrtar del që vetëm 29.05% e shpenzimeve kapitale janë shpenzuar. Jam shumë kureshtarë me ditë, çka do ti thoni qytetarëve ku në fund të vitit deficitit do të jetë enormë më i lartë. Si do të arsyetoheni para atyre. Më besoni që starti i kësaj qeverie nuk është ajo çfarë qytetarët kanë pritë prej juve, në mos premtimeve që i keni dhënë.

**Kryesuesi:** Para se t'ia kaloj fjalën, më la përshtypje kjo puna e mantijave. Këtu kemi shumë përfaqësues nga zona e Hasit, që e punojnë këtë punë. E di që mantija është krejt brumë. Brumi është fukarallëk për dallim prej mishit. Edhe qebapa që është mish i pastër që unë kam llogari. Do më thënë këtë po e marrë si kompliment.

**Ilir Baldedaj:** Çështja e brumit është në kuadër me mishin edhe me kep. Kështu që te tria s'kanë najë farë peshe të mirëqenies së lartë të qyqareve. Kështu që mantijat, bile ju shumë i ndihmon rasteve sociale. Bile me ia pas dhënë mantija atyre një vit kishin hëngër bukë ata.

**Kryesuesi:** Në qoftë se subvencionon me furrën tënde, me gjithë qejf.

**Simir Krasniqi:** Sot kur flasim për realizimin e buxhetit për periudhën gjashtëmujore janar-qershor të vitit 2018, mund të themi që ky realizim nuk është aspak i mirë. Mund të themi me plot fjalën që është i dështuar. Këtu shihet që nuk është duke shkuar mirë. Unë pas analizës që i kam bërë realizimit të buxhetit për periudhën gjashtëmujore janar-qershor 2018, kam parë që ky buxhet shpenzimet i ka bërë vetëm në luks. Më poshtë do të bëjë një krahasim në mes realizimit të buxhetit për periudhën gjashtëmujore janar-qershor të vitit 2017 dhe për realizimin e buxhetit për periudhën gjashtëmujore janar-qershor të

vitit 2018. Të hyrat vetanake në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, janë realizuar 55%. Kurse në vitin 2018 kemi një rënie në 38.83%. Do të shpalos shpenzimet ku do të bëjë një krahasim në mes të qeverisjes të PDK-së në krye me Prof. Dr. Ramadan Mujën dhe qeverisjen e dështuar të VV-së në krye me Mytaher Haskukën. Do të jap një pasqyrë në mes të shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2017 dhe janar-qershor 2018. Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit për periudhën janar-qershor 2017 kanë qenë 34.184 € Kurse në qeverisjen e luksit të Haskukës në periudhën janar-qershor 2018 janë 201.902 € Që i bje 167.778 € më shumë se qeverisja e PDK-së. Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit në periudhën janar-qershor 2017, kanë qenë 882 € Kurse në qeverisjen e luksit të Haskukës janar-qershor 2018, është 7.278 € ose 6.396 € më shumë se qeverisja e PDK-së. Mëditjet e udhëtimit jashtë vendit për periudhën janar-qershor 2017, kanë qenë 1.891 € Kurse në qeverisjen e Haskukës janar-qershor 2018, janë 9.589 € ose 7.986 € më shumë se qeverisja e PDK-së. Shpenzimet për internet për periudhën janar-qershor 2017, kanë qenë 6.549 € Kurse në qeverisjen e Haskukës janar-qershor 2018, janë 7.743 € apo 1.194 € më shumë se qeverisja e PDK-së. Shërbimet e ndryshme shëndetësore për periudhën janar-qershor 2017, kanë qenë 450 € Kurse në qeverisjen e Haskukës janar-qershor 2018, janë 27.908 € ose 27.458 € më shumë se qeverisja e PDK-së. Këtu shihet qeverisja e dështuar e Haskukës. Shërbimet shtypje, jo marketing për periudhën janar-qershor 2017, kanë 6.079 € Kurse në qeverisjen e Haskukës janar-qershor 2018 janë 12.063 € ose 5.984 € më shumë se qeverisja e PDK-së. Mobile më pak se 1.000 € për periudhën janar-qershor 2017, kanë qenë 8.610 € Kurse në qeverisjen e luksit të Haskukës janar-qershor 2018, është 23.834 € ose 15.224 € më shumë se qeverisja e PDK-së. Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve për periudhën janar-qershor 2017, ka qenë 9.284 € Kurse në qeverisjen e juaj të Haskukës është 16.444 € ose 7.160 € më shumë se qeverisja e PDK-së. Furnizimi për zyrë janar-qershor 2017, ka qenë 80.366 € Kurse në qeverisjen e juaj është 98.349 € ose 18.000 € më shumë pra se qeverisja e PDK-së. Kompjuter me vlerë më pak se 1.000 € janar-qershor 2017, kanë 1.320 € Kurse janar-qershor 2018 është 5.038 € ose 3.718 € më shumë se qeverisja e PDK-së. Furnizimi me dokumente blanko ku unë nuk kam vërejt kod ekonomik në 2017. Nuk e di ka i keni marrë edhe këto kodet ekonomike. Aty thuhet që në periudhën 2017 nuk ka kode ekonomik. Kurse në qeverisjen e luksit të juaj janar-qershor 2018 është 12.000 € Akomodimi për periudhën janar-qershor 2017, ka qenë zero. Do të thotë që ka qenë një qeveri kursimtare. Kurse në qeverisjen e luksit të juaj është 3.749 € Ku shihet se si keqpërdorët paraja e taksapaguesve të komunës së Prizrenit. Furnizimi me pije, jo dreka zyrtare për periudhën janar-qershor 2017, ka qenë 11.275 € Kurse në qeverisjen e luksit të kryetarit Haskuka janar-qershor 2018, është 23.352 € ose



10.077 € më shumë. Edhe këtu po shihet qartë se si keqpërdorët paraja e taksapaguesve të qytetarëve të komunës së Prizrenit. Drekat zyrtare për periudhën janar-qershor 2017, kanë qenë 6.957 € Kurse në qeverisjen e Haskukës 23.414 €, ose 16.457 € më shumë. Këtu shihet qartë se qeverisja e PDK-së në krye me Prof. Dr. Ramadan Mujën nuk e paska keqpërdorë buxhetin e komunës së Prizrenit. Të kujtohet kryesues kur ju keni qenë në opozitë, në një seancë ju patet drejtuar kryetarit Muja, dhe qeverisjes së PDK-së, për shpenzime për dreka dhe darka. Ku ju patët thënë se qeverisja e PDK-së ka bërë shpenzime marramendëse në dreka dhe darka. Dhe i patët shndërruar në qebapa, që nuk ishte aspak e vërtetë. Dhe nuk po dal ashtu si ju keni thënë. Po shihet qartë ky raport i shpenzimeve të keq qeverisjes Haskuka me koalicionin në pushtet. Keq qeverisja e juaj në krye me Mytaher Haskuka, si po duket nuk ju kanë mjaftuar qebapat. I keni rrit në pleskavica, apo në këtë shumë të shpenzimeve me ua shndërrua në diçka tjetër. Shërbimet kontraktuese tjera për periudhën janar-qershor 2017, kanë qenë 97.538 € Kurse janar-qershor 2018, është 1.000.138. € ose 1.400.010 € më shumë se qeverisja e PDK-së. Ndërkaq shumë shpenzime tjera që kanë rritje marramendëse nga gjashtëmujori i vitit të kaluar. Por shkak të kohës nuk po i përmendi të gjitha. Ky është keq menaxhimi i taksapaguesve të qytetarëve të nderuar dhe shumë të respektuar të komunës së Prizrenit, nga qeverisja e dështuar e Haskukës me koalicionin e tij.

**Kryesuesi:** Para se t'ia kaloj fjalën Ilirit, pasi që mu përmend emri. Për një kritikë që e paskam dhënë në mandatin e kaluar. Atë gjashtëmujorin kur e kam kritikua unë nuk kanë qenë 6.000 € 63.773 € dhe a e dinë ku është problemi. Ish kryetari i kaluar as që ish kon duke e ditë këtë punë. Qaty kur fola unë e mori vesh. Mandej e ka ulë 6.000 € kur e ka pa se administrata ish kon duke bo puq prapa shpinës, duke hëngër, gërdi duke bo. Po them kryetari s' ishte kon duke e ditë këtë punë. E tash kur po flitni për krahasime gjashtëmujore. Respekt, sepse kritika ime i ka ndal shpenzimet, kritika në Kuvend. Por kur të flisni për shpenzimet për cilat periudhat gjashtëmujore. Dhjet vjet keni qenë gjashtëmujori i vitit 2007, gjashtëmujori i vitit 2012, gjashtëmujori i vitit 2013. Po sidoqoftë në referenca duhet të jemi të kujdesshëm edhe ta dimë se për cilin vit është fjala.

**Simir Krasniqi:** Kryesues, unë shumë i qartë kesh. Mora periudhën e gjashtëmujorit janar-qershor 2017 dhe janar-qershor 2018. Po edhe në qoftë se ta kisha marr janar-qershor 2016, do të dalshin shpenzimet këto që janë. Do të thotë kursimet kanë qenë aq të vogla që të gjitha ato akuza që i keni bo në opozitë kanë qenë të pa baza. Vetëm me iu qit hi popullatës, qytetarëve të shkret. Po shihet në start, ne çfarë keq menaxhimi i luksit është nga ana e qeverisjes suaj në krye me Haskukën. Do të thotë ka edhe shumë kode tjera, të

cilat për shkak të kohës unë thash që të ngutëm pak më shpejt, që ti përmendi disa prej tyre. Janë fakte është drejtori i Financave. Në qoftë se ndryshon një euro ose dhjetë cent prej këtyre që i përmenda unë, i rri mbrapa. Jam për gjithçka mbrapa që i thash.

**Ilir Baldedaj:** Por pse ka ik Ertani në atë qeverisje tash po e kuptoj. Singërisht se kur ka qenë drejtor i Financave bashkë me mu, asnjë drek dhe asnjë darkë zyrtare se ka pas. Ndërsa tash bajagi mirë i luksit. Por kjo po del që edhe në kundërshtim me dy partitë që janë pjesë e koalicionit. Sepse LDK-ja është parti e qendrës së djathtë dhe këta nuk e kanë shumë problem. Po të qendrës së majtë është edhe Nisma edhe Vetëvendosja. Dhe po bie tash është në kundërshtim të parimeve të juaja në bazë të themelimit me tërë këtë luks. Seriozisht, tash ju po merreni me çështje qebapa. Artan po ta përkujtoj që atëherë ka qenë një faturë e ish kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi që e ka shtrua një darkë me arsimtarët dhe me gjithë ato shpenzimet kanë qenë ditët e shkollave. Drejtori i Arsimit këtu, që secila shkollë e ka pas nga një ditë shkolle dhe është pagua me atë kod buxhetor. Dhe ne po flasim vetëm për shpenzimet e qeverisë. Ndërsa ti në atë kohë ke fol për të gjitha shpenzimet edhe të shkollave edhe të ambulancave edhe të gjitha këto. E kuptoj, edhe të qenurit në pushtet është një farë luku. Mirëpo definitivisht kjo për gjashtë muaj 20.000 € të taksave të qytetarëve, që një projekt nuk e keni krye për gjashtë muaj. Në investime kapitale, ma gjeni në këtë raport gjashtëmuajor që një investim kapital është krye me 20.000 € Veç një. Përpos që jeni mbet në aeroporte duke shëtitë dhe cilat të cilat të mira ja keni sjellë Prizrenit nga këto vizita dhe mëditje jashtë Kosovës që i keni marrë. Ma thuani vetëm një! Veç mos më thuani që me Beratin jeni binjakëzua dhe është një investim i jashtëzakonshëm, se cilat janë tjera. Atëherë është mirë, sepse kritika është në anën e të mësuarit. Dhe është e vërtetë Artan pas kritikës tënde edhe të Haziz Hodës, kryetari i komunës masandej edhe një ujë me pi, u duke me marrë leje me ti. Kështu që patëm heq dorë ne krejt për mos me bo kurrjë. Mirëpo, Ertan tash singërisht po të kuptoj pse ke shkua në këtë koalicion. Vërtetë tash e paske më mirë.

**Haziz Hodaj:** Është e vërtetë që njëri ndër ata që e ka ngritë zërin për shpenzimet enorme. Po jo vitet e fundit, po sidomos në mandatin e parë edhe të dytë ato kanë qenë enorme. Ju e dini, ju jeni dëshmitarë të asaj. Këtu ka qenë mandej arsyetimi se ka delegacione zyrtare, vinë e shkojnë etj. etj. E këto vitet e fundit s'keni pas shpenzime. Edhe keni marrë tremë pak prej këtyre kritikave tona dhe prej numrit të madh të qebapava që e pat shndërrua Artani atë shumën e parave në qebapa. Edhe ju duke shumë edhe juve sigërisht. Por që është e vërteta as vizita s'keni pas dhe as s'keni shkua kurrkund, gjatë këtyre viteve të

fundit. Sepse s'ju ka thirr kurrkush. E as se keni pritë kurrkënd se s'ju ka vizitua kurrkush. E tani është krejt një qasje e re e qeverisjes. Një qeveri e re që ka kontakte me shtete me qytete etj. etj. Dhe këto të gjitha e kanë një kosto. Për atë që më the cila është e mira e këtyre takimeve edhe e këtyre shpenzimeve, është mirë atë me ditë. Do më thënë cila është arsyeja dhe cila është e mira e këtyre vizitave. Kjo shumë e arsyeshme.

**Baldedaj:** Veç mos ma përmend vallëzimin në Bingen që e keni bo. Që është e mirë e kësaj vizite.

**Kryesuesi:** Ilir, le ta përfundon, pastaj e lyp fjalën.

**Hodaj:** 50 vjetor Ilir i binjakëzimit të qytetit të Prizrenit me Bingenin dhe ka qenë një ftesë zyrtare. Ka qenë një vizitë shumë e mirë solide. Po, mirë ju s'keni ardhur, se s'ju kanë dashtë bre juve. Po aty është problemi. Tash sigurisht që rriten shpenzimet, sepse vizitat janë edhe nga jashtë brenda edhe nga brenda jashtë, kështu që ka një kosto. Ne qoftë se e kërkon arsyen e këtyre vizitave qoftë dalje, qoftë ardhja, këtë plotësisht ke të drejtë dhe ke arsye. Sigurisht që kryetari do të na informoj. Por që ka një kosto, kjo është e vërtetë. Ju kujtohet shumë mirë, më kujtohem mua se unë kam dal këtu në foltore. Një nëntëmuor kanë qenë dreka pa këto pozicioni i pijeve edhe e ushqimit këtu jashtë dhe brenda. Njëra 19.000 €, tjetra 70.000 € kanë qenë. Shumë mirë e dinë ti. Mirëpo, sigurisht që ato i kanë pas arsyet e veta. Edhe arsyetimin e njerëzve kompetent që i kanë shpenzuar ato. Sigurisht që çdo pushtet që vjen edhe që qeverisë do ta ketë një kosto edhe të këtyre shpenzimeve, që neve na duken ndoshta të luksit. Po në fakt nuk janë të luksit se vizitat na duhen neve. Na duhet kontakti me njerëz, ne jemi shtet demokratik. Dhe sigurisht që dojmë edhe me na vizitua dikush edhe ta vizitojmë dikën.

**Shukri Quni:** Këtu të 23.500 € të drekat zyrtare, këtu hynë edhe ushqimi edhe pijet me 21.352 € Do më thënë diku bëjnë 45.000 € As ju s'ja keni lënë mangu hiq. Bile Artan na ke pas thënë, po ngihuni bre burrë diku tjetër, jo këtu the. Edhe ju hiq s'jeni duke ia lënë mangu ma zi se ata që kanë qenë më herët. Shpenzimet jashtë vendit, edhe ju nuk i keni të vogla hiq. Shpenzimet brenda vendit 201.902 €, edhe këto nuk janë pak. Mëditje edhe udhëtime zyrtare jashtë 9.589 € Kam qenë edhe unë ja dy herë jashtë. Veç nuk e di që na ka pagua kryetari mëditje të jashtme. Unë për veti po flas, për të tjerët nuk po di. Po ju mirë që keni bërë këtë. Është mirë edhe neve nganjëherë me na marr jashtë. Por të këta të Bingenit kanë pas qenë këtu te ne. Edhe kogja mirë i kemi prit edhe ne ata. Bile ren janë kon bo këta.

**Kryesuesi:** Po është e vërtetë. Kishin një mall të papërshkrueshëm ata në Bingen, ju kërkoni. Por se pan fytyra të reja dhe nuk ju erdhi mirë. Sidomos e kërkuan ish drejtorin e juaj, atë e kishte dashtë shumë. Sido çoftë, Hasan Hasanin.

**Illir Baldedaj:** Dorën në zemër për me na pa, jo që jeni ju më të mirë hiç, harroni atë punë. Po ata s'ju kanë thirr juve, se kanë mendua që jemi ne ende në pushtet edhe na kanë ftua me na kthye atje. Se këtu na kanë pas kënaq. Z. Hodaj, çka kanë pas me të puth ty, pash një Zot. Por që s'na kanë ftua neve, na kanë ftua po ne nuk kemi bo diferencime sikur në kohën e Enver Hoxhës. As të Stalinit, sikur keni bo ju pushteti. Që keni shkua vetëm pjesa e pushtetit. Në asnjë delegacion qeverisjet e kaluara nuk e anashkalua opozitën. Keni shkua në mënyrën klandestine. Sepse vetë forma klandestine bëhet, si keni ftua subjektet që përfaqësohen në asamblenë komunale. Jo, jo forma e ftesës ka qenë klandestine. A për që keni bo namin me vallëzim modern, që i keni mahnit ata me bukuritë e juve edhe me vallëzim. Ajo është shumë e vërtetë. Po çka i keni sjellë Prizrenit. Ti ke qenë pjesë e delegacionit, je pagua me taksa të qytetarëve. Për mëditjet, hajde dil në foltore trego, cilën të mirë ia ke sjellë prej asaj vizitës në Prizren. Apo përpos do fotografive edhe postimeve në facebook. Dëgjomë tash ta përfundoj, tani merre fjalën. Po bonu pak parlamentar që 20 vjet në asamble komunale je. Kryesues, ti që kanë pa fytyra më të reja, shumë gabim e ke, se shumë më i vjetër se unë je. Kështu që nuk të dhez as kjo.

**Kryesuesi:** Faleminderit z. Baldedaj, kjo është arsyeja se nuk kam marrë as puthje. Prandaj, në qoftë se më të vërtetë je i mllfosur pse nuk ke pas rastin nga përqaftimet e miqve tonë të Bingenit. Siç e tha z. Hodaj në tetor je i ftuar mu në ballë të delegacionit.

**Petrit Hoxhaj:** Qysh po shihet më duket këto fotografitë e mija veç nisën me nxeh debatin. Kështu që filloj pak me...

**Sulltan Badallaj:** Unë po ndalëm pak te buxheti, pasi edhe drejtori është këtu edhe e dha rezymenë e realizimit të buxhetit. Në faqen 4 drejtor, të hyrat e përgjithshme të komunë për periudhën janar-qershor. Kemi kategorinë donacionet e jashtme. Është mirë me na sqarua edhe njëherë se çka janë këto donacione. Ne në vitin 2016 e kemi pas një donacion prej Demosit, nëse të kujtohet. Është një agjencion që e mbështet USAID-i. Po implementimi është përmes Administratës të Pushtetit Publik. Dhe ju kanë dhënë komunës së Prizrenit 2017 diku 200.000 € donacion për shkak të performancës së mirë. Se nëse s'gaboj ka dal si komuna e tretë me performancë më të mirë. Edhe për atë është dhënë ai donacion. Në faqen 9 te krahasimi i të hyrave vetanake, kemi shfrytëzimi i pronës komunale. Kemi të planifikuar për periudhën janar-qershor

2018, 700.000 € Të realizuara 153.000 € Po e njëjta periudhë e vitit 2017, kemi planifikim 430.000 € Kurse të realizimi është 170.000 € Pra po të kthehen në përqindje, po vërehen çfarë diferenca janë edhe kjo është një faktorë i performancës së në cilën legjislaturë ka qenë performanca më e mirë e këtij buxheti. Po ashtu kemi krahasimin e shpenzimeve komunale sipas kategorive të mallrat dhe shërbimet. Më gjithë që shefi i grupit parlamentar i sqaroj. Po neve nuk na keni dërgua planifikimin e vitit 2017 për të bërë krahasime. Sa po ma merr mendja shefi i grupit tonë i ka nxjerrë vetë ata. Po ju zyrtarisht nuk na keni dërgua.

**Ertan Simitçi:** Po filloj nga ish drejtori Sulltani. Është e vërtetë që komuna e Prizrenit ka fituar një donacion nga Demosi, në bashkëpunim që janë ata me Ministrinë e Administratës të Pushtetit Lokal, lidhur me performacën e buxhetit për vitin 2016. Po bartja e mjeteve, alokimi i mjeteve është bërë për sivjet do më thënë për vitin 2018. Në faqen 36 e ke Qeveria zvicerane 212.681 € Është drejtuar në buxhetin më sa e di për ndriçimin publik. Do më thënë kjo shumë do të shkon në ndriçimin publik, sipas planifikimit apo projektit në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Kuvendarët që kanë qenë edhe në mandatin e kaluar, e dinë që edhe unë jam në vazhdimësi si drejtor i Drejtorisë së Financave. Edhe çdo takim në çdo vend ku kam qenë kam dashtë me qenë transparent. Do më thënë çka ka qenë gabim, gabim, çka është mirë, mirë. Ish kryetari Prof. Dr. Ramadan Muja pas raportit të auditorit për vitin 2014, kur e ka pranua, e kemi vërejt që është në shpenzim në drekat zyrtare mbi 100.000 € Kanë qenë tre fatura në disa takime. Edhe tani ka marrë një vendim që pa nënshkrimin e kryetarit, nuk do të organizohet apo nuk do të realizohet asnjë shpenzim në këtë kategori në drekat zyrtare. Edhe kur kemi pas mysafir nga jashtë edhe nga brenda, kemi qenë të obliguar të njoftojmë kryetarin edhe kryetari, nëse ka dashtë ka marrë vendim, nëse jo, jo. Kemi pagua prej xhepit tanë. Tash kryetari Prof. Dr. Mytaher Haskuka, ka një qëllim tjetër. Që njëjtë bëhen kush ka për qëllim drekat zyrtare, cili drejtor apo cili zyrtarë ka. E njofton kryetarin, kryetari ose lejon ose jo. Por për sivjet është diçka tjetër për drekat zyrtare. E dini të gjithë që në kategorinë e subvencioneve i kemi mjetet e pamjaftueshme, afër 500.000 € është. Dhe disa OJQ, që kanë marrë më herët nga pushteti, nga subvencionet që kanë pasur takime të ndryshme apo takime punuese, punëtori. Na tash e kemi përcjellë atë, që me pagua nga kategoria e drekave zyrtare. Për shkak se në kategorinë e subvencioneve nuk kemi mjete. I kemi ndarë për shëndetësi edhe për shërbime sociale, për shpenzime tjera. Rritja është e vërtet, po sivjet kemi pas edhe shumë mysafirë të jashtëm. Qoftë me organizata të ndryshme, qoftë prej shteteve të ndryshme. Edhe ajo është normal. Te shërbimet kontraktuese, sivjet kemi filluar me planin e ri për shkak se deri



më tani mirëmbajtjen e rrugëve, e dinë edhe ish drejtori, ka qenë nga investimet kapitale. Sivjet po e paguajmë nga mallrat dhe shërbimet. Edhe për këtë arsye kategoria e mallrave dhe shërbimeve është rritë 5.700.000 € planifikimi. Ndërsa te udhëtimet brenda vendit shumë pagesa janë aty nga Drejtoria e Arsimit. Që Drejtoria e Arsimit e ka bo pagesën e transportit të mësimdhënësve dhe nxënësve. Edhe sa e di ka qenë aty një pagesë në janar apo shkurt, lidhur me pagesën e një borxhi të vitit të kaluar.

**Simir Krasniqi:** 168.000 € është diferenca në mes të gjashtëmujorit të kaluar.

**Simitçi:** Ka mundësi, sepse ne në muajin janar edhe shkurt ka shumë pagesa që i kemi pagua borxhe të vitit të kaluar. Që si kemi paraparë në listën e borxheve edhe i kemi pagua në janar dhe shkurt. Nëse doni, me një kërkesë mundem me ju dhënë raportin analitik. Është tjetra akomodimi. Më sa e di është 3.000 e kusur euro. Kemi pas mysafir të jashtëm. Tash bile kemi pas një delegacion të shkollës së muzikës. Shëndetësia që tha z. Simir Krasniqi. E dimë që edhe baca Alush ka pas një kërkesë për me vazhdua kontratën apo marrëveshjen e Karitasit. Aajo shuma që është dallim është në muajin maj. Kemi paguar një muaj shtesë që kanë qenë mbi 70 punëtorë. Do më thënë diferenca është që kjo.

**Krasniqi:** Sa është pagesa e punëtorëve

**Simitçi:** Për shëndetësi që tha është 26.643 € Do më thënë me vitin e kaluar vetëm që kjo është diferenca. Planifikimi i të hyrave, për të gjitha komunat e cakton Ministria e Financave. Në vitin 2016 kemi pas 9.400.000 €, apo afër 9.500.000 € Vitin e kaluar kemi pasur 6.100.000 € Edhe që kjo diferenca rreth 3.400.000 € ka qenë edhe që ky efekt për me zbrit këtë shumën, që ka qenë jo planifikim i mirë. Për shkak se kriteret e komunës nuk ka pasur që me realizuar 9.500.000 € Sivjet planifikimin e të hyrave e kemi 8.100.000 € Sot që e mora raportin nga zyrtari i të hyrave. Në krahasim me vitin e kaluar afër 90.000 € është diferenca. Problemi më i madh i të hyrave vetanake ka qenë te lejet e ndërtimit. Që nëse e shihni raportin afro 300.000 € në krahasim me vitin e kaluar. A ka problem të të hyrat, ka. Obligime ndaj komunës së Prizrenit janë rreth 17.000.000 € Në seancën e kaluar ju kam dhënë premtimin që deri në fund të vitit do të bëjmë një analizë edhe një raport lidhur me borxhin ndaj komunës. Që unë po besoj që në bazë të analizës tani edhe kemi dal me një rekomandim të mirë. Që të shohim ato mundësitë me inkasua të hyrat vetanake. Se edhe shumë projekte kemi nga të hyrat vetanake. Te shpenzimet, që është krahasim. Komuna e Prizrenit për momentin, apo Drejtoria e Financave ka një politik, që pasi nuk ka kaluar rishikimi, që me i shpenzua të gjitha ato mjete që

janë prej grandit qeveritar. Edhe deri në fund të vitit unë po besoj që kemi me pas një buxhet më të mirë, për shkak se dinamika është ashtu. A ka qenë problem te realizimi i investimeve të projekteve. Po, për shkak se ne si qeveria e kemi marrë detyrën me 1 shkurt. Deri sa jemi adaptua, i kemi pas ato probleme për inicimin e procedurave, ka kaluar edhe gati një muaj, një muaj e gjysmë. Do më thënë duhet ti kuptojmë disa sende. Por rekomandimet e mira që vijnë, patjetër ne do ti marrim parasysh. Që unë si drejtor i kam marr parasysh të gjitha rekomandimet në mandatin e kaluar. Besoni edhe tash kam mi marr.

**Shukri Quni:** Po këtu ne krejt po i shohim. Po e dimë që e keni marrë edhe me 1 shkurt. Po ne jemi duke u frikuar se mos po shkon prapë në suficit, e s'po i harxhoni mjetet. Kur kemi qenë ne në opozitë, kuvendarët e PDK-së, vetë ke qenë aty ulur edhe je prapë, qaj drejtor je. I ke pas kritikën më të zëshme prej kuvendarëve të PDK-së. Ke pas kritika prej Gzimit, që kur shkonim atje në parti, pse po kritikon ti, a po kupton. Nuk jemi ata që kemi me mbrojt dikë që është në pushtet. Për disa po flas, ose për hatër. Këto dreka, darka që i përmendem, pak kaluan edhe në humor. Po mirë ke pasi kaluam pak në humor. Se njeri nuk jeton pa u ushqye, është shumë e vërtetë. Po Hazizi na tha, jua kemi ndal tha kaqepin. A 40 mijë e kusur euro kanë qenë të Drejtorisë së Arsimit, që ua ka dhënë për ditë të shkollës, që kanë hy në atë buxhet. Po nëse ne po flasim, besoj që drejtori tash duhet me kthye atë. Që për ditë të shkollës 12 €arsimtari e meriton atë ditë të shkollës me pas një drekë se s'bëhet kiameti. Qëllimi është kështu drejtor. Mos e kurseni, po mos të shkojmë sikur që kemi shkua vitet e kaluar në suficit. Investoni, lëshoni mjetet dhe le të punohet. Se qysh e keni bllokua ju tash dhe nuk është duke u punuar asgjë. Unë po të them që fundi i vitit ka me na gjet ma katastrofë, këtu është problemi. Se ato që kanë kaluar normal, nuk është problemi. E dimë që duhet me harxhua nganjëherë se dhe me dal jashtë. Pa dal jashtë nuk ka. Kur del njeriu jashtë shteti, ai sheh diçka pak më mirë. Edhe që shkoni edhe ju çka jeni në pozitë, se kemi fortë problem. Po është puna këtu në Prizren, ajo që grumbullohet prej qytetarëve, duhet me u investua këtu. Mos e mbani kuletën mbyllur. Po lëshoni edhe le të investohet qysh është investua. Njëmend ju ka lënë borxh ndoshta qeveria e kaluar. Veç kemi punua, sa që sot një drejtor për pesë minuta ka shkua prej komunës e në Mazrrek, me intervenua për njëfarë vendi aty. Se tash po e ndjen vetën pak si gjallë. E këto i ka bo dikush më herë. Edhe kemi kritikua, prapë kemi me kritikua, për atë jemi. Edhe do t'ju kritikojmë. Po sa të mundesh mos qo në Prishtinë të holla, mi kthye. Vetëm investoj në Prizren.

**Simitçi:** Çështja për suficite është, se ne kemi bisedua edhe me kryesuesin edhe me kryetarin, që sot që është seanca, me ju dorëzua propozim për ridestinimin e mjeteve që është 15%. Por pasi që Drejtoria e Shërbimeve

Publike edhe disa drejtori tjera, kanë ende do kontrata që janë në vazhdimësi. Edhe kemi bo planin që në shtator me ju pru. Ju nëse e aproveni rialokimin e mjeteve që është 15% nga grandi qeveritar. Po ju besimin e plot moral dhe politik, që deri në fund të vitit s'kemi me pas suficit. Se e dini krejt, projektet janë, nëse s'ke mjete s'mundesh me bo pagesën. Por do të shikojmë edhe mënyrën që edhe me Ministrinë e Financave, që është ajo procedura që e paguan thesari drejtë. Do më thënë është procesi i parë. Tash rialokimi i mjeteve edhe tani është marrëveshja me Ministrinë e Financave. Të gjitha faturat shkojnë përmes Ministrisë së Financave. Edhe ata janë të gatshëm me bashkëpunua për shkak se nuk ka kaluar rishikimi. Se edhe në vitin e kaluar edhe në vitin 2016 qashtu kemi bo.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë drejtorë për raportimin, faleminderit anëtarëve të Kuvendit, që morën pjesë në diskutime, propozime, vërejtje dhe sugjerime për këtë Raport gjashtëmujor. Më sa unë u informova edhe më aq sa ka qenë praktikë, këto raporte nuk po u votuakan. Do më thënë është raporti vjetor që votohet. Dhe këto që janë periodike çdo tre muaj bihen vetëm për informim të Kuvendit lidhur me punën dhe shpenzimet e ekzekutivit. Kalojmë në pikën e radhës.

#### **Pika e tetë:**

#### **Informatë për përfundimin e vitit shkollor.**

Për këtë pikë ftoj drejtorin e Arsimit z. Skender Susuri, që të na paraqet një raport të shkurtër Kuvendit. Dhe eventualisht ti përgjigjet ndonjë pyetje të anëtarëve të Kuvendit që ka.

**Skender Susuri:** Unë jam mundua që raportin të përmbledh mirë, në mënyrë që kuvendarët me pas hapësirë për të diskutua. Mundësisht aty ku ka dilema dhe paqartësi do të përgjigjem. Unë prej tash po ju siguroj që në mbledhjen e radhës të Kuvendit do të bije edhe specifikacione për shpenzimet materiale të KDA-së, me të holla. Sepse nuk e kam mendua që duhet me qenë pjesë e këtij raporti. Vetëm mundem me thënë që ne me kryetarin Haskuka e kemi marrë një vendim, që përpara ka qenë 10 € për një drekë për ditë shkolle, tash është 7 € Kaq ka qenë gatishmëria e kryetarit për këtë vit. Dhe unë i kam shkrua një rekomandim shkollave që me shkua në 7 € Me përjashtim shkollat që janë të vogla, që nuk i kalon 1000 nxënës, ata munden me bo 10 € sepse nuk i mbulon shpenzimet. Unë do të ndalëm në disa momente. Ka pas një interesim për zhvillimin profesional të arsimtarëve. Ne e kemi dhënë një numër 332, ata që punojnë në arsim e dinë. Të trajnuar dhe të certifikuar për kornizën Kurikulare të Kosovës. Ai është investim i MASHT-it të Kosovës. Ne i kemi

mbështet teknikisht. Me mjetet tona ne si DKA, kemi organizua një trajnim për 40 mësime për gjithëpërfshirës. Dhe kemi planifikua 5.000 € buxhet me fillimin e shtatorit, me vazhdua me vlerësimin e brendshëm të shkollave, ku do të trajnohen edhe ekipet edhe të shkollave të tjera. Ndërsa për vitin 2019 është një shtim i buxhetit i planifikuar për 50.000 € Sepse më të vërtetë si Drejtori komunal do të tentojmë në fuqizim të kapacitet të mësimeve. Sa i përket infrastrukturës shkollore në raportin e parë, unë e kam dhënë vetëm si shënim. Ndërsa sot e morët edhe një pjesë të raportit plotësues, në secilën shkollë ku ndodhët momentalisht procesi. Sa i përket politikave të rrjetëzimit të shkollave, këtë shumë e kom bëre mediale, për arsye se më të vërtetë po mendoj nëpërmjet rrjetëzimit të shkollave me rrit në radhë të parë menaxhimin. Është e pamundshme mu menaxhua në mënyrë efikase një shkollë, ku një drejtor i shkollës ndodhet 20-30 kilometra larg shkollës amë. Kështu që kjo po besoj që i ndihmon edhe njëherë në radhë të parë menaxhimin, pastaj edhe proceseve tjera. Duhet më thënë që nuk ka asnjë kosto këtu. Do më thënë nuk shtohet numri i drejtorëve. Përkundrazi shfrytëzohen kapacitetet e brendshme që i kanë shkollat. Sa i përket funksionalizimit të shërbimit pedagogjik, psikologjik. Edhe këtu jam angazhua që me bo rezultate konkrete. Ne e kemi një marrëveshje me Karitas Kosovën. E cila marrëveshje ka buruar nga qeverisja e kaluar. Mirëpo ne me Karitas Kosovën e kemi ndërrua modalitetin e shtrirjes së psikologëve në shkolla. Aktualisht janë pesë psikolog, punojnë me dhjetë fëmijë po në dy shkolla. Ne kemi bo marrëveshje që me participua nga 2019, sepse ata kanë kontratë deri në 2018. 50% të pagës i paguan Karitas Kosova, 50% i paguan Kuvendi komunal, nga pozicioni mallra dhe shërbime. Nga 1 janari 2019, këto pesë psikologe nuk do të jenë të stacionuar në dy shkolla por do të shpërndahen në pesë shkolla. Ndërsa në bashkëpunim me zyrën e personelit në fillim të vitit shkollor kur kemi bo planifikimin e punëtorëve të ri, kemi arrit me AMPLP mi siguria dy kode për dy pedagog dhe tre psikolog, gjithsej pesë. Edhe pesë që janë bëjnë dhjetë. Ku do të sistemohen këta psikolog edhe pedagog, nuk mund ta di. Sepse ka një premtim publik të kryetarit të komunës, që në çdo shkollë të mesme të ketë një psikolog shkollor. Aktualisht ne jemi duke punuar me zyrtarët e DKA-së, që me bo një pasqyrë e mi shfrytëzua kapacitetet e brendshme. Nëse po e zëmë një shkollë e mesme ka brenda vetit psikolog ose pedagog të diplomuar dhe kanë probleme me normën, ata me kalua me automatizëm në pozicionin e pedagogut dhe të psikologut. Ne e kemi nxjerrë këtu një data bazë, i kemi me emra dhe jemi duke zhvilluar biseda individuale me secilin. Për shkollën e mjekësisë, po e zëmë e kemi arrit një marrëveshje që një nga të punësuarit aty, të kaloj atje. Në shkolla tjera, në gjimnaz e kështu më radhë, jemi duke biseduar. Ne e kemi marrë, nuk po them asnjë në të kaluarën, me -53 punëtor pak mbi qarkoren kemi pas. Kemi arrite me reduktua në pesë.

Në arsimin fillor, klasa e parë nëntë nuk kemi asnjë punëtorë aktualisht që nuk është në listën e pagave. Në arsimin e mesëm këtu i kemi pesë raste. Ku ne do të bëjmë përpjekje që ato me kaluar në arsimin fillor. Po e zëmë i ka tetë orë në shkollën e mesme, dhe 12 orë i man në shkollën fillore. Do ta ndërrojmë nga janari 2019 që ai me kalua në listën e pagave të shkollës fillore. Në fakt aty ata dëmtohen pak me buxhet. Mirëpo nuk mundesh ti me pas vendin e punës në shkollën në listë e me pas më shumë orë në shkollën fillore. Po them edhe njëherë ky funksionalizim edhe për drejtorin rrethizimi edhe i shërbimit pedagogjik, psikologjik, nuk ka me pas për komunën, por ka kapacitete brenda shkollave. Te ndarja e bursave e kemi bërë një lëvizje pozitive. Jo në numër, se numri ka qenë i njëjtë 100, ka qenë 103 nuk e di. Po e kemi bërë një lëvizje pozitive. Sepse për herë të parë nuk ka më nxënës të familjeve të invalidëve që janë në shkollë të mesme. Dhe ata kanë fillua me studime në fakultete. Të 12 studentëve, pavarësisht se a e ka pas kushtin 8 apo jo, ne ua kemi ndarë bursat edhe më të vogël se koeficienti 8, dhe do të vazhdojmë deri kur të kryej studimin. Besoj që çdo kush e kishte bo këtë. Normal kam pas edhe sfida. Sfidën e institucionit të konkursit të mësimdhënësve, është sfidë e vazhdueshme. E ka pas edhe kryetari i grupit të juaj pse nuk janë botua në ueb faqe. Do më thënë ne tre majit e fundit nuk kemi pas asnjë institucion të konkursit për mësimdhënës. Sepse i kemi shfrytëzua kapacitetet e brendshme. I kemi shfrytëzua ata që kanë qenë në marrëdhënie pune me kontratë. I kemi bo nga një vend i punës në një vend tjetër. Deri në përfundimin e vitit shkollor, përkatësisht deri më 30 qershor. Ne aktualisht jemi duke përgatit konkursin. Dhe këtë konkursin jemi duke e përgatit në bashkëpunim me të gjithë drejtorët e shkollave. Asnjë mësimdhënës i cili është në sistem, nuk rrezikohet. Lëvizje ka me pas. Sepse po e zëmë punon në mjekësi, mbulon orë të cilat nuk i takojnë mjekësisë. Mbulon orë ekonomike e kështu më radhë. Ne në bashkëpunim e drejtorët do të tentojmë mi sistemua. Jashtë listës së pagave nuk do të ngel askush. Kjo edhe për faktin se e kemi edhe një qarkore të Ministrisë së Financave e cila thotë: pavarësisht se zvogëlohet numri i personelit, ne nuk mund ti qesim në rrugë. Por duhet me pas parasysh që konkurset e radhës kur hapen, mos me hap konkurs, por me këqyrë mi bashkua mi fuzionua klasat. Tjetër e kam pas institucionin e konkursit të drejtorit, i cili më ka marrë kohë për shumë arsye. Kom pas politikat buxhetore. Unë e kam shënua edhe në raport e keni lexua. Këto janë edhe kontribut që e keni dhënë edhe ju kuvendarët. Sepse na keni votua rishikimin e buxhetit, përkatësisht ne kemi trashëguar një borxh, që ka qenë i arsyeshëm, diku rreth 200.000 €, si Drejtori Komunale. Dhe me rishikimin e këtyre vijave apo kodeve buxhetore, keni votua në këtë Kuvend dhe i kemi la borxhet. Aktualisht mundem me thënë se si Drejtori Komunale, nuk i kemi asnjë cent borxh asnjë kompanie, apo operatori



ekonomik. Riorganizimi i DKA-së ka qenë një premtim që unë kam thënë në fillim, vazhdoj me mbrojt. Do më thënë Drejtoria komunale me kapacitetet që i ka me një staf prej 12 vetëve. Një staf i cili i kanë munguar trajnimet e kështu me radhë, ka nevojë për fuqizim edhe në burime njerëzore edhe trajnim. Unë pres që të bëhet një organogram i ri dhe zyrtarët komunal në arsim mos të jenë të ndarë, apo të klasifikuar në bazë të niveleve. Në nivelin një, dy, tre. Po të jenë të klasifikuar në bazë të zhvillimeve që bëhen në arsim. Përkatësisht zyrtarë për braktisje, për gjithëpërfshirje, për avancim profesional, për Kurikula e kështu më radhë. Më shumë s'po dua me ju rëndua. Nëse keni pyetje do të mundohem me qenë korrekt. Edhe njëherë e përsërisë, gjithmonë, gjithmonë, gjithmonë ejani te drejtori, unë nuk mundem me bo dallime këndeje ose andej. Unë jam partner me ju, dhe të gjitha ato që i keni të arsyeshme, nëse nuk i zbatoj, lirisht thoni në Kuvend. Unë asnjë rast nuk do të shkoj askund me marrë një vendim, pa u konsultuar me ju kuvendarët që e mbuloni atë zonë edhe atë komunitet. Unë nesër po zëmë e kam një takim me disa përfaqësues të Gjonajve, s'di a të kanë thirr a jo, nëse s'të kanë thirr po të thirri unë në orën 09:00. Ka të bëjë pikërisht për temën e pavarësimit të gjimnazit në Gjonaj. Vetëm pak, unë të thirri vazhdimisht, po kam mendua që ata, do më thënë kryetari i fshatit të ka thirr. Nëse s'të ka thirr, unë po të thirri.

**Ilir Baldedaj:** E di vullnetin e tij që vërtetë e ka më dëshirë. Por pak e ka një problem sepse subjekti është bajagi barrë e rëndë drejtor. Vet kemi qenë secili në nëpër pozita udhëheqëse. Po merrna me konkursin. Drejtor më sa e di unë nga 15 korriku, deri më 20 gusht, të gjithë punonjësit e arsimit kanë vendim për pushime. A bie kjo që ata tash po maltretohen dhe po thirren drejtor nëpër telefona, bjerma një anëtar të këshillit të prindërve. Vërtetë kjo ndarja e shkollave, sepse në fshat timin i bije mu pavarësua shkolla. Po besoj që kjo është më shumë për rahatimin e militantëve, se sa për cilësi. Sepse duke parë që ajo i plotëson kushtet. Sepse numri i nxënësve është i vogël. Dhe me formën dhjetë orë, personi adekuat që bëhet drejtor, duhet ti mbajë dhjetë orë mësim në atë shkollë. I bie sikur në shkollën Gjonaj që ka qenë drejtor i shkollës dhe orët të cilat ai i ka pas nuk janë mbajt asnjëherë. Dhe a po dëmtohen nxënëset në këtë aspekt. Ndërsa rreth një punësimi në inspektorat aty të një njeriu me të kaluar jo të mirë. Dhe pak më herët për shkak të kohës nuk munda ta diskutoj, që the rreth kalimit të 400 nxënësve. Tash paramendoni, është drejtor i inspektoratit ai i cili duhet të merret me profesorët e nderuar, të cilët nuk i kanë kaluar studentët apo nxënësit. Dhe ju tash ia besoni detyrën atij si drejtor i inspektoratit, që ka ardhur nga ju, apo nga propozimi i subjektit tuaj politik, me një të kaluar jo të ndershme të tij.

**Alush Shala:** Unë dua ta pyes drejtorin për një çështje që unë e dëgjoj, sepse edhe ju besoj keni dëgjua. Drejtorët e deritanishëm drejtor dhe ky konkursi i juaj i anuluar, më duket që ka sjell konfuzione mjaftë të mëdha nëpër shkolla. Ku besoj që ka me ndikuar drejtpërdrejtë në nxënësit e shkollave përkatëse ku kanë qenë këto konkurse. Të lutëm, a keni ju informata që ish drejtorët nuk kanë fare fuqi ekzekutive në shkollat ku janë. Dhe informatën tjetër që këta të zgjedhurit dhe të anuluar të pretendojnë që të njëjtët kanë me qenë drejtor. A ka me ndikua kjo në politiken. Sepse pavarësisht Drejtoria Komunale që e ka politiken standarde. Edhe vetë drejtori është një super menaxher për shkollën e vetë. Andaj, a do të keni fuqi ti parandaloni këto probleme, që mos të vinë në të ardhmen. Dhe ky konkursi a do të jetë prapë afatgjatë qysh ka qenë, konkursi për drejtorët. Apo do të jetë me një procedurë të shkurtuar.

**Haziz Hodaj:** Drejtor faleminderit shumë për raportin. Sigurisht që as nuk kam dyshua, se ai është shumë korrekt. Shpresojmë që edhe ky institucioni i konkursit me të cilin ke pas problem tash do të eliminohen ato defekte që janë kon, edhe të jetë një konkurs i pranueshëm prej shumicës. Jo prej të gjithëve, s'ka mundësi. Po dola me të pyet për një problem, pak a shumë e di përgjigjen sepse s'ka ndodh rishikimi i buxhetit. Është e pamundur ndoshta edhe me intervenua. Mirëpo, po them kanë ardhur do foto nga shkolla në Gjonaj dhe sinqerisht janë alarmante, ndoshta të kanë ardhur edhe ty. Do më thënë lopët, tash janë pjesa kryesore e ambientit të shkollës. Në hyrje nëpër lulishte e ku do. Nuk i ke fajet ti, i kemi ne së pari që kemi pranua mi qua nxënësit pa u përgatit shkolla komplet. Edhe i kam thënë drejtorit të shkollës, që mos gabo mi qua fëmijët aty pa u kompletua shkolla. Mirëpo, ka qenë vit zgjedhor edhe nuk janë pyet. A do të kishte mundësi që të intervenohet në këtë drejtim diçka që të eliminohet. Të bëhet një rrethoj, qoftë edhe provizore, qoftë edhe më e lira. Derisa të rregullohet qysh duhet, apo nuk ka mundësi.

**Behar Begaj:** I nderuar z. Susuri, desha t'ju drejtohem juve. Së pari ju përgëzoj për punën dhe vullnetin që po e bëni. Po e shoh se vërtetë e keni marrë me shumë seriozitet punën tuaj. Keni një qasje shumë të mirë, po shihet që jeni aktiv dhe shumë i angazhuar. Keni bërë vizita nëpër shkolla të ndryshme. Dhe si rezultat, unë kam besim se do të jetë një rezultat i mirë. Unë desha të kyçem ta salla sportive e cila është duke u punua në Zhur. Më siguri e dini edhe ju se tash e tri vite, ajo sallë ka filluar të punohet, mirëpo ende nuk është në përfundim. Ju e dini se aty përreth ka familje të cilat jetojnë. Dhe më të vërtetë janë bërë të mërzitshme këto punët e këtij operatori i cili po punon atje. Ku e dini shumë mirë se një ditë punon, një muaj nuk punon. Ose tri ditë punon, tre muaj nuk punon. Dhe familjarët përreth më të vërtetë janë të shqetësuar me këto punime,

që nuk mund ta gjejnë asnjëherë qetësinë. Unë po e shoh këtu, ku thuhet se janë problemet e operatorit. Te ne në Zhur problemet e operatorit po janë të pranishme. Unë them lirisht se probleme të tilla kemi edhe në shtrimin e atyre rrugicave, të cilat është e paraparë. Edhe aty thuhet se problemi është i operatorit. Aty thuhet se operatori nuk po arrin mi mbulua me punë ato punime. Mandej kemi ngecjen e ujit, ku është paraparë në buxhet se do të bëhet shtimi edhe rrjeti i kapacitetit të ujit. Do të bëhet ndërrimi i pompave të ujit. Unë tash po i drejtohem kryetarit. Kisha më thënë që kryetar, ta keni parasysh te dhënia e tenderëve. Kisha thënë që të jepen tenderët me aq buxhet sa ka, edhe ta kenë një afat të kufizimit për punët që do të bëhen. E jo të bartën borxhet nga viti në vit siç i kemi tash para vetës. Shihet se është ndarë buxheti për shtimin e kapacitetit të ujit, ose ndërrimi i pompave. Mandej thuhet se këto janë vetëm borxhe të alokuara nga vitet e kaluara. Dhe thirren po me këtë emër, shtimi i kapacitetit, ndërrim i pompave. Atëherë ne po dalim qesharak para qytetarëve, dhe një gjë e tillë nuk po bëhet këtë vit, po duhet me prit vitin tjetër. Kur është paraparë që në vitin 2018 të bëhet shtimi i kapacitetit të ujit dhe ndërrimi i pompave të ujit. Do më thënë që këtë vit nuk po bëhet, po shihet se nuk po bëhet. Sepse mjetet po barten në borxhet e viteve të kaluara. Dhe çka thuhet, thuhet përpos këtyre mjeteve që janë të ndara në këtë vit të parapara, këto do të bartën edhe vitin e ardhshëm rreth 40.000 € Kisha thënë që ti keni parasysh këto sende dhe të jepen tenderë me aq buxhet sa kemi dhe jo të bartën borxhet nga viti në vit.

**Fatmir Kastrati:** Unë në fillim e përsëritës vërtetë punën që është duke e kryer drejtori i Arsimit. Mirëpo në të njëjtën kohë kisha shtruar pyetjen se sa është i kënaqur drejtori i Arsimit. Duke i pasur parasysh këto angazhime në cilësinë e mësimdhënies nëpër shkollat tona. Nuk e di statistikën a e kanë gati Drejtoria e Arsimit. Çfarë kalueshmërie ka qenë e nxënësve në gjysmë vjetorin e parë. Çfarë ka qenë kalueshmëria në gjysmë vjetorin e dytë. Sepse u përmenden ato 400 raste të nxënësve të cilët kanë mbetur me nota të dobëta në fund. Duhet me pas parasysh se si kanë mbetur dhe në çfarë forme kanë mbetur me ato nota të dobëta. Ne e dimë që punojmë në arsim, Sepse ndodh një nxënës i ka dhjetë nota të dobëta, e dymbëdhjetë deri në fund të vitit. E mandej fillojnë ato pazaret brenda individëve nëpër shkolla. E mandej mbetet me tri nota të dobëta. Në mënyrë që me marrë vendim këshilli i arsimtarëve meja fal një notë të dobët, e pastaj ai nxënës me kalua. Në disa shkolla arsimtarët nuk kanë qenë të gatshëm me krye këtë. Edhe nuk ka pranuar që këshilli i arsimtarëve t'ju falet nota. Kështu që nuk është ligjore. Është vetëm një marrëveshje brenda shkollave. Edhe unë mendoj se pikërisht këtu qëndron problemi. Edhe pikërisht janë ankua ata nxënës të cilët edhe kanë pas një gjendje të tillë, që kanë ardhur nga dhjetë nota të dobëta, ndoshta me tri nota të dobëta kanë ardhur në fund.

Edhe dëshirojnë me e kalua klasën. Kjo është një çështje e cila është ajo pika, ose thembra e Akilit nëpër shkolla tona, te cilësia. Krejt këto janë rregullua, edhe trajnimet edhe krejt këto po bëhet prej mbas luste. Me qindra trajnime i kemi krye edhe po vazhdojmë ti kryejmë. Mirëpo cilësi në arsim po mbetet ajo që ka qenë. Shumë pak ka dallime do të thotë nga viti në vit. Prandaj ndoshta këtu është mirë që ndalët edhe Drejtoria e Arsimit edhe ne këtu si Kuvend, çka mundemi me bo te mënyra e cilësimit të nxënësve. Sepse po bien në pozitë të keqe edhe ata profesorë të cilët janë, e kryejnë punën e tyre me ndërgjegje të plotë. Edhe në fund mbesin në pozita jashtëzakonisht të vështira. Në njëfarë mënyre llogaritën si arsimtar të cilët janë këmbëngulës, janë tendencioz ose forma tjera. Drejtor unë të inkurajoj që edhe me këtë çështje të merresh, përveç çështjeve tjera. Edhe besoj se një seancë tjetër, në shtator ndoshta do të debatojmë pak më tepër lidhur me cilësinë edhe me mënyrën dhe sistemin e notimit të nxënësve nëpër shkollat tona.

**Dafina Bllaca:** Drejtor të përgëzoj për punën dhe vullnetin e mirë që e keni edhe pse ndoshta ju jeni koka. Mirëpo qafa e gjithë kësaj pune është Mytaher Haskuka. Dhe nga ta udhëheq qafa shkon edhe koka. Do të thotë nuk po mundeni me i bo punët ashtu siç dini ju më të vërtetë. Desha edhe unë në fakt mu kyç me këta 408 nxënës që kanë shkua në rivlerësim. Unë jam mësimdhënëse që dhjet vite. Edhe e shoh që të drejtat të fëmijëve nganjëherë që janë të shumta. Sepse ka fëmijë që gjatë gjithë vitit nuk vjen fare në shkollë, apo vjen fare pak. Dhe i ka dymbëdhjetë të dobëta apo edhe më shumë. Vetëm në edukatë fizike e ka notë kaluese. Edhe në fund politikat e ndryshme apo njerëz të ndryshëm të detyrojnë pikërisht atyre nxënësve mi vendos not kaluese. Apo bëhet ku rivlerësimi qysh e keni bo tash ju. Mirëpo qysh dhe në çfarë shtate ka shkua nuk e di. Mua nuk po më duket kjo një diçka e mirë, për shkak se cilësia e arsimit nuk ngritët në këtë masë kështu. Sepse kur ne kemi qenë nxënës kemi pas mësimdhënës stërkit. Por jemi ata që jemi sot, apo jeni ata që jeni edhe ju sot. Ndërsa sot duke i dhënë shumë liri fëmijëve tanë, ata janë duke s'postua. Sepse po e marrin atë që ne kemi të drejtë, kemi të drejtë. Edhe me mësu s'mësojnë fare. E dinë që kanë krahun e fortë, kanë dikë tjetër. Desha një pyetje të bëjë të plotësimi i raportit që na e keni dorëzua. Te pika e 14 nën 6 aty, transporti i mësimdhënësve në proces, ofertomi publik ka konkluzion dhe vendim. Desha me ju pyet, të kam pyet edhe njëherë. Mirëpo edhe njëherë po të pyes për shkollën e mesme teknike "11 Marsi". Çka po ndodh për mësimdhënësit e shkollës "11 Marsi". Edhe ata kanë të drejtën ta gëzojnë këtë transport.

**Xhavit Uka (LDK):** E dëgjova më vëmendje drejtorin e DKA-së z. Susuri, kur tha se 120.000 € nga shkolla fillore e Piranës do ti akumuloni diku

tjetër. Dhe e pash aty që operatori i fundit i cili e ka fitua atë tender paska bërë kërkesë për tërheqje të kontratës. Desha ta di arsyen e tërheqjes së kësaj kontrate.

**Shukri Quni:** Drejtor unë të përgëzoj për punën që je duke e bërë. Të kam njohtë edhe më herët, të njoh. Besoj që do të jesh prapë, e tha Dafina shumë bukur. Po nuk besoj se edhe ti je punëtori i 90-tës, 99-tës që kemi punua na në sistemin paralel të Serbisë, jemi edhe kolegë. E kështu që ne nuk durojmë fort me diktate edhe me na ngrit zonin. Se është mundua boll Serbia në ato aspekte, por do po mendojnë që janë hala ato masat e dhunshme, e me na diferencua. E kështu që te unë është në pyetje, sado që i hedh benzinë në flak aq më keq është. Edhe të përgëzoj, po tash politika po ta bënë, s’kam çka të bëjë. Të kisha mbështet deri në fund. E kam fjalën te konkurset që njëherë keni thënë shumë janë mirë. Pastaj u anuluan konkursi i drejtorëve, që për ty nuk ka qenë mirë. Se ti ke shkua në mënyrën më të mirë të mundshme. Ishte 7 € për një arsimitar për drekë, për ditë të shkollës. Kjo ka qenë edhe në kohën e qeverisjes të Prof. Dr. Ramadan Mujës, ka qenë 10 €. Pas ankesave është heq krejt kjo. Ju propozuat 7 € Unë po them 12 € Se një punëtor i arsimit që punon 12 muaj. Nëse ia ndan një euro në muaj, nuk është ku më ditë sa, me ja dhënë për një ditë të shkollës është fjala. Se edhe kjo ka hy në atë buxhetin që e përmendëm ne më herët, ato drekat e darkat, e qebapat e pleskavicat.. Do më thënë po propozoj të jetë 12 €, se s’bëhet nami. Kur pi hamë do dreka e darka këta zyrtarët këtu, edhe ne punëtorët e arsimit nuk është kushedi sa kiamet me bo një drekë. Më gjithë se këto i kemi organizua edhe pa ndihmën e qeverisë. Pastaj të java e ‘Remzi Ademit’ manifestimi tradicional ka qenë këtë vit prej 4 qershorit deri me 12 qershor 2018. E keni organizua, nuk kanë marrë pjesë, kështu ju kam këqyrë prej anash. Është një manifestim që organizohet për 17 vite me radhë, veç je i njoftuar. Tash si drejtor ke marr pjesë për herë të parë, e ke organizua. Sa ke qenë i kënaqur atë e dini ju. Po ky manifestim është mbulua, krejtësisht ka qenë nën ombrellën e ditëve të Lidhjes së Prizrenit. Kjo mos të na ndodh se ne gjithnjë kemi shkua diku kah 29 maj edhe me 3 qershor e kemi përfundua. Se jam themelues, po më vjen keq që po e them publikisht sot. Po jam themelues prej vitit 2001. Edhe është një manifestim, që përpos që është Hasi Jehon, e mbanë aq bukur edhe e nuk ia luajnë fort datën. Edhe ky është i dyti. Edhe përfitojnë nxënësit, jo arsimtaret, as ju hiq si drejtor. Veç që ke me pas shumë kritika në këtë drejtim. Kështu që kërkoj që ky manifestim të mos jetë më nën ombrellë të dikujt. Po i ka ditët e veta. Edhe është pikërisht në fund të vitit që organizohen kuize, e pastaj vrapime e sporte të ndryshme, përfitojnë nxënësit në atë drejtim. Edhe te tenderimi druve këtu po e shoh, te lënda djegëse. Tash unë sa e di që ende nuk janë shpërndarë lënda djegëse nëpër



shkolla, ndoshta ka fillua diku. Në një kohë tash sa vjet ka nuk e di, kështu është bllokua edhe ish- drejtori i mëhershëm. Po jo nga faji i tij, po nga faji i politikës. Diku në dhjetor kur ka ardhur puna mu shpërnda lënda djegëse. Unë i di që i keni ato problemet e brendshme. Po arsimi këto nuk i pret. Do më thënë të kryhet sa më shpejt shpërndarja e lëndëve djegëse nëpër shkolla. Po ashtu edhe te ljerja e objekteve shkollore, që e ke parapa këtu në program po flas. Ti e ke programin që ke punua në këtë drejtim, edhe të përgëzoj për punën që e ke bo. Po e shoh që këtu mos është pak vonë. Po e shoh që te ljerja e objekteve shkollore, veç është sot fundi i korrikut edhe na diku kah 20 gusht fillon puna nëpër shkolla. Kështu që a ka kohë a jo. Edhe të kulmi i shkollës “Remzi Ademi”, po e shoh edhe këtu që mos është vonë. Të kam pas dhënë kritika edhe më herët. Edhe nuk di a ka pas nevojë ajo shkollë mu ngjit me stiropol. Çfarë inxhinier janë ata. Kur ajo e ka murin gjysmë metër, a nuk e di sa e ka. Është e nxehtë sa të duash, nuk ka pas nevojë asaj stiropol mi qit fare. Po i keni do inxhinier, që medet për ne. Medet për ne se çfarë projekte po na ofrojnë, edhe kanë me vazhdua ata ende atë. Përderisa del dikush që i mëshon në krye. Se kështu janë mësua me vazhdua këtë punë. Edhe kjo është kah vazhdon. E kështu që me diktate ato ne i kemi shkal vitin 1990, kur s’jemi dorëzua hiç. Kanë vdek ato, që dikush e ngrenë zërin këtu në asamble, edhe na thotë shuni. Mos ta fiksoj temën.

**Cengis Cesko:** Sayın Müdürümüz Skender Susuri’ye pedagog bir de psikologlarla ilgili bir önerim olacak. Prizrende malumunuz Türkçe dilinde de e itim oldu una göre psikolog ve pedagogun Türk toplumundan da bir tane olması gerekti ini dü ünüyorum. Bir de ikinci bir sorum olacak özellikle bunu uzun zamandır dile getirmek istiyorum, okullarda özellikle liselerde güvenli in sa lanması için özel irketlerden güvenlikçiler ayarlanmaktadır ve bunların maa larının ödenmesi için ö rencilerden para toplanmaktadır. Bunun bundan sonra olmaması gerekti ini dü ünüyorum ve bu konuyla daha yakından ilgilenmeniz gerekti ini dü ünüyorum.

Kam një pyetje për drejtorin Skender Susuri lidhur me pedagogët dhe psikologët. Siç e dini në Prizren arsimi është edhe në gjuhen turke. Andaj mendoja se do të duhej që edhe nga komuniteti turk të ketë nga një pedagog dhe psikolog. Po ashtu kam edhe një pyetje të cilën ka shumë kohë që dëshiroja të them. Nëpër shkolla e posaçërisht në gjimnaze për të sjellë siguri merren rojet e sigurisë nga firmat private dhe për të paguar pagat e tyre mbledhen para nga nxënësit. Unë mendoja se kjo gjë më nuk duhet të vazhdojë dhe mendoja se duhet së afërmi të merreni me këtë çështje.

**Sadije Osaj Jakupi:** Më sa e di unë shumë shkolla të mesme të ulëta dhe të larta, sallat e edukatës fizike shfrytëzohen nga shumë klube sportive. Qoftë ato basketbolliste, apo futbolla. Pyetja ime është se, të kush bëhet pagesa. Dhe ato a shkojnë në buxhet të shkollës apo diku tjetër.

**Petrit Hoxhaj:** Kam një pyetje për drejtorin. Kur do të bëhet pavarësia e shkollës fillore të fshatit Kobi, me këtë të Vlashnjes. Dhe kur do të jetë bartja e nxënësve të fshatit Muradem, që vijnë në këmbë në fshatin Vlashnje në shkollën fillore.

**Memnuna Ajdini:** Obzirom da dolazim iz obrazovanja i da sam prosvetni radnik. Ja u preneti neke primedbe od kolega. A ti u se službeni obrazaca, obaveštenja, dakle službeni dokumenata. U gradskim školama pre svega da oni idu i na bosanskom jeziku. Jer u pojedinim školama nemamo ta obaveštenja, ili pak nekih od tih dokumenata i na bosanskom jeziku. Dakle to je jedan od zahteva koji bi trebalo da se ispuni. I u narednoj godini da ne bi imali takvih propusta. Što se ti e anuliranih konkursa. Ja u samo re i da oni kriterijumi koji su zasnovani. Svakako da imaju osnova. I svakako o ekujemo da se tih kriterijuma ponovo pridržavate i da ne budete pod političkim pritiscima. Za pedagoge i psihologe koji budu bivalni zapošljeni o ekujemo da nekih od njih budu bošnjaci primljeni. Ili pak da ljudi koji budu primljeni znaju sva tri jezika.

**Ilir Gashi:** Z. Susuri i kam dy pyetje nëse janë në kompetencë të DKA-së. E dimë që niveli i arsimit, niveli i vlerësimit të nxënësve është në rënie. A është bërë ndonjë hulumtim. Cila është arsyeja, a është mësimitdhënia, a është te tekstet shkollore. A është tek vet nxënësit, apo ka faktor tjerë. Dhe e dyta, këtu në raport po shoh që kryesisht janë projekte infrastrukturore. A ka ndonjë projekt për kurse, trajnime për mësimitdhënës, për ngritjen dhe avancimin e metodave të mësimitdhënies. Nëse janë kuptohet në kompetence të DKA-së.

**Kujtesa Kabashi Shatri (LDK):** Unë desha një pyetje për drejtorin e DKA-së. Në fshatin Kushnin në shkollën “Hysni Temaj”, klasën e parë nxënësit e kanë zhvilluar mësimin me 37 nxënës. Duke e ditur se numri i nxënësve për një klasë është 22 maksimumi. A mund të bëhet ndarja e klasës së parë në dy klasë, pasi që numri është i madh. Duke e ditur se mësimitdhënia është e vështirë me kaq numër të madh të nxënësve 37. Vetëm, desha me ditë a mundet me unë në dy paralele, për me vijua mësimin më mirë me shkua, në kushte më të mira.

**Simir Krasniqi:** Unë lus që ky konkurs i drejtorëve kësaj radhe mos të anulohet. Kryetar mos të vepron sikur se tash që të del mbi ligjin, e thash edhe më herët si sulltan këtu. Se shkollat mbesin, vaj medet se çka do ti gjënë

shkollat në qoftë se anulohet prapë konkursi, sa janë 36 shkolla, apo sa janë drejtorë dhe zëvendësdrejtorë. Te raporti i juaj e kam lexuar me vëmendje. Këtu e pash që të kalueshmëria e testit të maturës. Këtu është marrë pra në total 78.73%. Do të ishte mirë që kalueshmëria e çdo shkolle. Pra duke filluar nga gjimnazi natyror, gjimnazi shoqëror, shkolla ekonomike, shkolla e mjekëses, të ishte ndaras, që ne si kuvendarë ta dimë se sa është përqindja e të gjitha shkollave. Do të thotë këtu do të ishte mirë që ta kemi këtë raportin, për kalueshmërinë e çdo shkolle. Kurse te konkurset e nxënësve për shkollat e mesme, ju drejtor e dini shumë mirë, ndoshta kryetari nuk e di. Udhëzimi Administrativ për numrin e nxënësve dhe të mësimdhënësve, nuk është 24-28, por është 32-35 nxënës, mësimi teorik. Kurse mësimi praktik mund të jetë nga 16 deri në 19 nxënës. Këtu i bije se mund të jetë një shkelje. Pse e them këtë! Në qoftë se kemi kërkesa, ne, me të drejtat ndërkombëtare të fëmijëve duhet ti sigurojmë shkollim. Është e drejtë e atyre që ti sigurojmë shkollim. Po në qoftë se ne shtojmë edhe gjashtë klasë, apo edhe dhjetë klasë tjera me nga 24 nxënës, neve na shtohen edhe 15 norma mësimore. Si do ti fusim ata mësimdhënës në listën e pagave. Do të thotë është e pamundur që ta bëjmë këtë. Në këtë raport ndoshta ka qenë ndonjë lëshim pa dashje, mirëpo nuk e pash se sa konkurse të mësimdhënësve kanë qenë për periudhën 2017-2018. Sa mësimdhënës janë pranuar, sa mësimdhënës janë pensionuar për këtë kohë 2017-2018. Sa masa disiplinore ndaj mësimdhënësve, ndaj nxënësve e kështu më radhë. Sa vendime pa pagesë e kështu më radhë. Do të ishte mirë që herëve tjera që ti kemi edhe këto të dhëna.

**Skender Susuri:** Është e vërtetë që unë i kam ato, se dihet që janë ato. Po nuk kam dashtë mi dhënë ato individuale për shkolla për disa arsye. Nëse ju thoni s'ka problem i bij se aty ka shkolla që nuk i bëjnë 50, ka shkolla që i bëjnë mbi 90. Nëse doni ua sjelli. Asnjë konkurs nuk e kom bërë në vitin 2017-2018, unë i kam trashëguar ato konkurse. Jua sjelli kush ka themelua marrëdhënie pune prej 1 janari deri në qershor. Po personalisht nuk kam hap konkurse, se qashtu ka qenë situata. Numri 28 është e vërtetë 32, po ne për shkak duke e përcjellë situatën numrin e nxënësve që janë përsëritës etj. etj. E kemi lënë këtë numrin rezervë. Për çdo nevojë jemi këtu. Unë nuk kam dashtë mu marrë me spekulime qysh janë marrë shokët e tu atje. Do më thënë kur unë kam kërkuar rivlerësim ata kanë thënë i marrë me nota dyshe. Po ata, po ia tregoj edhe njëherë Ilir Baldedës, që nuk është këtu. Që drejtori nuk ka ndërhy arbitrarisht, po drejtori ka ndërhy pikërisht se ka qenë dashtë me bo rivlerësim. Kur një profesor, një nxënës i thotë a bënë edhe njëherë profesor me më pyet, duhet me ndie kënaqësi. E jo me ndëshkuar nxënësin me notë të dobët. Nuk qëndrojnë ata nxënës që i kanë ka dhjetë të dobëta. Po nuk po dua me ju maltretua. Aty ka nxënës që tërë vitin tre dobëta. Dhe këta kanë marrë guximin me tre të dobëta me lënë. Do më thënë ka qenë një lloj politike, e dinë drejtori

çka po dua me i thënë po kam me kërkua procesverbalet e inspektorëve me pa çfarë ka qenë gjendja. Dhe unë do të jem në shtator këtu te ju. Edhe ju do ta shihni që drejtori ka pas të drejtë. Sa i përket pyetjes së Ilirit. Po Ilir, nuk mundem me dhënë klasifikime për nivelin, dihet çfarë është niveli. Ne thash i kemi 50.000 € buxhet të ndara me kryetarin, për avancimin profesional të arsimtarëve. Jo që s'ka pas deri tash avancime, mirëpo pikërisht do të jetë vlerësimi i brendshëm i shkollave edhe vlerësimi i nxënësve do të jetë prioritet i DKA-së. Sepse më të vërtetë po kemi telashe. Sa i përket Gjimnazit "Remzi Ademaj", është plotësisht e vërtetë që aty bëhen edhe investime tjera. Nuk është investim i jonë, po është investim i Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik për Eficiencë. Edhe ata vetë e kanë bo këtë tender, vetë ecin më tutje. Ne nuk mundemi mi thënë pse e bëni këtë. Ata mendojnë që duhet me bo. Kanë mi ndërrua me dritare me nxehje qendrore, me krejt. E jona është tenderin për pllakën, pjesën andej e ka fitua operatori ekonomik. Nuk ka sot, nesër pasnesër fillojnë punët. A ka mu vonua do ditë nuk mundem me ditë. Për fat të keq që është edhe Skenda këtu, shumë herë ministrit qendrore nuk na japin neve informacion të, ose nuk koordinohen me ne. Po kjo është një problem gjeneral. Sa i përket Cengis Cesko. Po Cengis ne do të bëjmë përpjekjeve sipas psikologëve edhe pedagogëve edhe prej komuniteteve. Nuk e di qysh ka me qenë me gjuhën turke. Për gjuhën boshnjake është i sigurt. Sepse ne edhe kemi kontaktua me drejtorët atje. Brenda listave ka pedagog shkollorë, të cilët aktualisht nuk punojnë pedagog. Punojnë edukatorë e kështu më radhë e kemi barrë ata mi bo pedagog. Për momentin kemi me fillua me një pedagog, një psikolog. Me kalimin e kohës kemi me shtua. Po sigurisht do të mendojmë edhe për gjuhën... Të mbeta borxh la Shuk, java "Remzi Ademaj", po është organizua në qershor. Unë në atë kohë la Lush menduam mos po e rriti javën "Remzi Ademaj". Kam dashtë me lidh me Lidhjen Shqiptare, me bo ma madhështore. Oke në rregull është reflektojmë e bëjmë në maj, s'ka asnjë problem. Jo, jo javën "Remzi Ademaj" unë e kam lidh me Lidhjen Shqiptare edhe e kam bo përfundimin pikërisht me 12 Qershor, duke mendua që jam duke bërë mirë. Po unë e kam pas një vendim të kryetarit për 7 € i kam propozua 10 € Kryetari ka thënë 7 € Po në rastet e shkollave të vogla nuk po i përmendi me emër. Aty unë kam nënshkrua pëlqim i kam dhënë. Dhe ato shkollat e vogla nuk kanë pas telashe. Një prej tyre ka qenë Vërmica, Nasheci, kam reagua me 10 € Ma ka lejua mua atë të drejtë kryetari, po për shkollat gjigante. Për shkollat të cilat kanë pak dhe nuk e mbulon shpenzimin me reagua, kam reagua. Për kuvendarin Xhavit Uka. Po Xhavit është e vërtetë 120.000 € janë planifikua. Mua më vjen marre mi përmend operatorët ekonomik, se ti vetë je operator, ata i kanë sfidat e veta. Unë edhe i kuptoj ata operator. Aty operatori ekonomik i ka marrë dy vërejtje, prej inxhinierëve tonë. Vërejtjen e tretë nëse e merr, ai ka

shpreh gatishmërinë vetë mu tërheqë. Pasi ka shpreh gatishmërinë, ne në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës aktuale. Nëse na lejon, normal kalon në këtë Kuvend, se duhet këtu ai ndërrimi në buxhet. Këto 120.000 € mi kanalizua në projekte ku janë duke përfundua. Normalisht që në vitin 2019, kjo shkollë me qenë prioritet edhe mu mbyll. Po kjo është gjithmonë marrëveshje. Tash operatori ekonomik e ka shprehë këtë. Dhe ma ke bo pyetjen se tash për atë kohë ndahet ajo. Ne e kemi nxjerr një tabelë cilat shkolla kanë më shumë. Nuk ndodhet këtu shkolla e Kushninit. Shkolla e Kushninit ja bëjmë këtu dy paralele. Është brenda limitëve të qarkorëve të ministrisë. Plus po të tregoj që atëherë që kemi qenë në vizitë, e kemi pa aty që e kemi kalua kulmi me ju ndërtua shkollës. Dafinë 408 nxënës janë, je profesoreshë që ka me ardhur raporti, ke me u bind që drejtori ka pas të drejtë, që nuk janë nxënës me nota të dobëta. Profesorët e “11 Marsit” hynë në atë, do më thënë kanë kalua ata, i ka kalua profesori. Pajtohem me Fatmir Kastratin, që vlerësimi është politike e madhe. Edhe ju duhet me më ndihmua të gjithë për me mund me kalua. Kur doni ne jemi për ta bërë një debat për këtë temë. Salla në Zhur, Behar mjetet janë. Do më thënë vetëm 40.000 € ne i kemi borxh operatorit ekonomik. Që përbën vetëm 10% të shumës së përgjithshme. Qe Sulltoni, që merret. Sulltan ne këtë shumë nuk guxojmë me ia dhënë operatorit ekonomik pa e bo komisioni pranimin teknik. Operatori ekonomik që është shok i joni edhe i juaji është krizë të madhe. Ne kemi shkua si delegacion i DKA-së, kemi kalua më shumë se çka na lejohet mundësia. I kemi thënë Sulltan vazhdo punën pak të shohim që po punosh, po ti lëshojmë edhe këta përfundo. Nuk është vetëm Zhuri, këtu hynë edhe Velezha. I njëjti operator i ka të dy. Çka mundemi me bo se. Te Velezha ne si kemi asnjë borxh, as në Zhur si kemi. Po ai është në gjendje të rënd, ju mundeni me ditë kush është operatori. S’ di çka me thënë la Shuk, kemi pas një situatë të rëndë, ku njëra prej operatorëve ka dashtë me heq edhe dritaren aty që e kanë vu. Më shumë s’po hy me fol, po më kuptoni. Oborri la Haziz, s’qenka këtu. Kemi qenë ne atje me këta zyrtarët tanë, i kemi pa lopët. Ne për sivjet nuk mundemi me reagua se është muri i madh. Nëse dojnë këta me improvizua një tel të KFOR-it munden me bo mos mi shti lopët. Në vitin 2019 sigurisht është në projekt. Do më thënë ka mu trajtua me prioritet, se më të vërtetë është objekt i madh. Ndërsa ato fotot tjera, se unë mendova se ka edhe do defekte me ujin, ato i riparojmë edhe i lyejmë brenda shkollës. Vllaga profesoreshë e kishte kap atje me një pjesë, ja qesim. Konkursi për drejtorë la Lush, a ndikon, sigurisht ndikon. Po unë nuk mundem mi ndal ata që janë të papërgjegjshëm. E pa u bo drejtorë, thonë jemi bo drejtorë. Atyre le t’ua bare vetë ndërgjegjja si sillen. Unë të jesh i bindur që i kam njoftua të gjithë drejtorët aktual që janë këtu edhe besoj që qashtu ka me qenë. Po më vjen keq prapë që po duhet emër me thënë. Po unë kur të dal këtu, lirisht ma thoni ku është gabimi, nuk po dua se është Iliri. Nuk



ka të bëjë kjo me Inspektoratin e Arsimit, me DKA-në. Inspektorati i arsimit është një organ që është nga Ministria. Nuk është e vërtetë që ai personi që punon aty, është drejtor i inspektoratit. Ai është në shërbim me kontratë mbi vepër. Është vetëm është një zyrtarë. Probleme me ligjin nuk ka. Se ne krejt mundemi me gabua ligjin. E ka vuajt dënimin, kështu që është marre në Kuvend kuvendarët me dhënë tema të tilla. Prandaj ky nuk lidhet me DKA-në, po më vjen keq që shoku jem ma i mirë Iliri që po bënë pyetje edhe po del pi Kuvendit.

**Kryesuesi:** Drejtori i tha përgjigjet çka pati me i dhënë, përfundoj debati. Drejtor të lutëm shumë shkurt përgjigjen jepe edhe po vazhdojmë se i kemi edhe tri pika të rendit të ditës.

**Skender Susuri:** Dy pyetje mi ke bo, të dyja janë pozitive. Dhe pavarësisht shkollës e kam pëlqimin edhe të komunitetit atje. Ndodh me 1 shtator. Në ato shkolla ku po e zëmë ne nuk kemi një pëlqim. Nëse është rasti Dedaj, po unë kam bisedua me komunitetin Dedaj. Kam biseduar edhe me drejtorin e Lugizhdës. Nuk është me rendësi a është numri 60-70. Është numri 120-130 nxënës. Është shumë më mirë drejtori aty me qenë e shërben cilësisë. Edhe Muradema transporti është me 1 shtator se ka kalua në atë raportin.

**Kryesuesi:** Zonja Bllaca me gjithë respektin, mirëpo më të vërtetë duhet të vazhdojmë me rendin e ditës. E di që ka shumë çështje që doni mi diskutua sa i përket arsimit. Mirëpo, ju kisha lut që po vazhdojmë me rend dite. Përfundoj kjo pjesa e diskutimeve të anëtarëve të Kuvendit, edhe pjesa e përgjigjeve të drejtorit të Arsimit.

#### **Pika e nëntë:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimvendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-4, të datës 29 dhjetor 2005.**

Fjala është për një vendim të vitit 2005, i cili është marrë në Kuvendin komunal, ku subjekteve politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin komunal, i jepet në shfrytëzim nga një zyrë që është pronë e Kuvendit komunal. Për kohën kur është marrë ky vendim, sigurisht kjo ka qenë në përputhshmëri me dispozitat. Mirëpo, në vitin 2012 kemi miratimin e ligjit të ri për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Ku që nga ajo kohë, ky vendim ka qenë në kundërshtim të plotë me ligjin në fuqi. Gjithashtu së fundmi në takimin që e kemi pasur të gjitha komunat e Kosovës, me Kryeministrin e Republikës së Kosovës. Takim i cili është organizua prej Zyrës për reforma shtetërore, ku ka qenë, s'qenka Iliri. Po ashtu në projektligjin e ri nuk po parashihen një formë e tillë e dhënies në shfrytëzim në shumë simbolike prej 1€ Kjo përveç se është një problem me dispozitat ligjore. Gjithashtu shkakton mjaft telashe edhe të

hyrat e komunës. Pra 1 € shfrytëzim qira, është le e kundërligjshme, po e dëmshme edhe për buxhetin. Rrjedhimisht ky vendim as nuk mund të zbatohet. Por se për hir të respektit ndaj institucioneve, pra është fjala Kuvendit komunal, që e ka nxjerr atë vendim. Vetëm ai institucion mundet me pas mandatin me shfuqizua dhe rrjedhimisht, ne duhet ta vëmë këtu si pikë të rendi të ditës, të diskutojmë dhe në fund ta marrim një vendim në pajtueshmëri me ligjin. Kjo ka qenë edhe vërejtja e auditorit tani që e patëm pikën e mëhershme. Ku vit pas viti auditori, do të thotë se problemin kryesor me komunën e Prizrenit, tash e sa kohë e ka pikërisht këtë vendim dhe se jemi të detyruar me lëvizë. Se çka do të ndodh me partitë politike pastaj diskutojmë edhe në pikën në vijim. Ku do të shikojmë me bo një zgjidhje. Por se për këtë pikë njëherë kryetari ka kërkuar fjalën. Jo, atëherë kalojmë tek subjektet politike, ose te shefat e grupeve. Apo po doni me hap si diskutim.

**Alush Shala:** Ne edhe në KPF-në e kemi diskutua këtë çështje. Dhe ne si PDK-e me shefin e grupit e kemi dhënë mendimin tonë. Edhe duhet, ne jemi për ta respektuar ligjin dhe vendimet. Por edhe ju duhet ta shihni edhe Udhëzimin administrativ. Atë ua kam përkujtua si anëtar i komisionit për prona të komunës. Decidivisht shkruan se për ambasadat, për partitë politike, për organizatat me karakter kombëtar, po e marrim edhe për ministritë. Këto janë, nuk mundesh ti mi qit në tender, zyrën e partisë dhe partitë politike me konkurrue në tenderin për zyra. Andaj mirë është me respektua Udhëzimin administrativ, nuk po flasim për PDK-në, por po flasim për të gjitha partitë. Unë kisha kërkuar dhe do të pajtohem prapë me një qira simbolike. Që të dihet prona e kujt është, do më thënë që të dihet që prona është e komunës dhe ka të zotë ajo pronë. Përndryshe për shumën simbolike për 1 € apo për 2 € apo 5 € është shumë pak, nuk ka shumë rëndësi. Edhe pajtohem plotësisht për partitë politike, që nuk përfaqësohen në Kuvend. Mos të kenë zyre së paku sikur që kanë partitë tjera. Ne e kemi kaluar si komision edhe LDK-ja e ka ndërrua zyrën dhe ka qenë brenda ligjit dhe brenda Udhëzimit administrativ. Nëse respektohet udhëzimi administrativ, partitë politike që përfaqësohen në Kuvend ta kenë të drejtën të kenë zyrën, me një qira prapë po them simbolike. Ose, ose ju tash jeni në pushtet mund t'ia rritni vetit qiranë. Kurse ne që jemi në opozitë, ne s'kemi mundësi mi përballua shumat që mund ti caktoni.

**Kastriot Krasniqi (PDK):** Unë kryesues e kam një propozim. Pasi që është edhe ligji i ri, në punim e sipër. Pse nuk e shtymë këtë pikë pas shtatorit e diskutojmë. E kam fjalën për zyrat e subjekteve politike.

**Kryesuesi:** Po ligji i ri është në hartim. Urojmë që shumë shpejt do të kaloj në Kuvendin e Kosovës. Deri atëherë sigurisht ne do të vazhdojmë disi.

Në dispozitat e ligjit të ri sipas të gjitha gjasave që po shihen. Kryetarit të komunës do ti jepen kompetenca shtesë, në dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Duke i shmang procedurat e ankandit publik. Ky është problemi, te partitë politike. Mënyra se qysh i është dhënë drejtpërdrejtë, ku sipas ligjit që është në fuqi nuk kemi të drejtë. Edhe çështja e dytë është tek të hyrat. Kurse me ligjin e ri do të ketë lehtësira. Po urojmë që të kalon në Kuvend të Kosovës. Por se problemi ky vendim në asnjë version të ligjit qoftë kësaj që është në fuqi, qoftë atij që pritet, nuk ka bazë. Dhe rrjedhimisht është i pazbatueshëm. Thjesht ne duhet me krye punën tonë si Kuvend për mi shfuqizua vendimet që nuk i kemi në fuqi. Kjo është ajo pjesa e arsytimit që mund ta jap.

**Kastriot Krasniqi:** Kryesues, këtë po e shfuqizojmë. Po me çfarë vendimi me çfarë ligji donë mi dhënë një subjekti politik një zyrë apo pavarësisht diçka të tillë.

**Kryesuesi:** Po e thash në qoftë se ligji i ri është ashtu siç është në projekt tash. Mundet me ju dhënë mundësia që partive politike me ua dhënë drejtpërdrejtë, pa ankand. Do më thënë bëhet një zgjidhje. Sigurisht në këtë rast këtu te zyrat të gjithë jemi të prekun. LVV, PDK, LDK, të gjitha partitë politike në Kuvend shfrytëzojnë pronat komunal. Rrjedhimisht ne duhet me bo një zgjidhje që është në pajtim me ligjin. Por se ky vendim është më i tejkaluar dhe për këtë punë nuk do koment. A ka dikush tjetër diçka?

**Shukri Quni:** Unë nuk jam për tu anuluar ky vendim, që është marrë nga ish kryetari Eqrem Kryeziu. Sepse në atë kohë e kanë marrë një vendim të mirë për të gjitha partitë politike. Edhe për atë jem që ky vendim mos mu shfuqizua fare, po me ekzistua. Ju thatë se ne si Kuvend kemi marrë vendime edhe tjera për me anulua. Ne si Kuvend kemi marrë shumë vendime edhe kanë tejkalua. Po këtu ka njerëz përmbi ligjin edhe përmbi Kuvendin që i anulojnë. Edhe këtë keni mundur mos me na pru fare hiq. Edhe e kishit anulua ju vetë, pa na pyet neve hiq. Edhe kur keni kesi lloj vendimesh me marr mos na pyetni neve fare, merrni vendime të tilla. Se kryetari do vendime i ka marrë pa e pyet këtë Kuvend, që ne i kemi marrë këtu. Edhe unë i kisha lut kuvendarët që ky shfuqizim mos të bëhet. Po le të funksionon, pra le të fuqizohet edhe më tepër. Se ato që i paguan ti për partin tënde, ato i paguajnë edhe ata. Unë nuk e kam dert se a paguan partia qira, a s'paguan, asnjë tro hiq. Po, po më pëlqen ky vendimi edhe që ky nënshkrimi këtu poshtë, që shumë i bukur qenka.

**Kryesuesi:** A e anulon Kuvendi apo jo, një gjë është shumë e sigurt. Ky vendim është i pazbatueshëm. Po ideja është që me respektua institucionin që e ka nxjerr. Në vitin 2005 Kuvendi komunal e ka nxjerr këtë vendim. Dhe vetëm Kuvendi komunal në këtë rast, ju me mandat të ri, keni të drejtën për me

shfuqizua në kuptimin formalo-juridik. Do më thënë kjo është linja se si duhet ta ndjekim si institucion serioz. Nëse doni që mi lënë dokumentet që me u pluhuros nëpër sirtarë, kjo është çështje tjetër. Por se si Kuvend ne jemi të obliguar.

**Fatmir Kastrati:** Unë nuk e di, po ne si subjekte politike në një farë mënyre po duhet me marrë një qëndrim që është kundër vetvetes. Kundër të gjitha subjekteve politike që janë prezentë sot këtu. Ne po e kuptojmë edhe ligjin, i kuptojmë ndoshta edhe të gjitha ato procedura që duhet mi ndjek. Por duhet që edhe këtu të gjendet një zgjidhje. Nuk e di a është qëllimi që ti ngritët qiraja subjekteve politike, apo ku është qëllimi. Në qoftë se është qëllimi mu ngrit qiraja, atëherë vërtetë duhet ju si kryesues, edhe ky Kuvend, të merr një vendim që partitë politike të financohen nga Kuvendi komunal. Ose ta merr përsipër Kuvendi komunal pagesën e qeras të partive politike që janë prezentë këtu. Sepse e dinë ti se në çfarë pozite janë subjektet politike. Në qoftë se dojnë me na qit me një pozitë të keqe, që të rritet qiraja. Të shkon ndoshta me këto firmat që punojnë nëpër institucione, ose që punojnë me pronën komunale. Atëherë më të vërtetë është e pamundur të na bihet një gjë e tillë. Edhe unë shumë e kam të pa qartë. A është vetëm të zbatohet ligji pastaj të merret një vendim që ti jepet me qira një partie politike që të paguna 300 ose 500 €qiranë. Duhet të jeni edhe ju të informuar se çka do të ndodh më tutje. Asnjë subjekt politik s'ma merr mendja që mund ta bëjë një gjë të tillë. Unë e di që partitë politike që participojnë në Kuvendin e Kosovës, e kanë buxhetin e vetë që i paguan Kuvendi. Kurse ne absolutisht as një cent nuk e marrim prej askujt tjetër. Edhe krejt me mjete vetanake funksionojmë. Në qoftë se edhe kjo bëhet shtesë, atëherë do të jetë një barrë shumë e madhe. Unë jam për me i respektua ligjet. Por duhet ta di se çka më tutje.

**Kryesuesi:** Në pikën pas kësaj, është shpallja e ankandit të tenderit publik për dhënien me qira të objekteve dhe lokaleve. Do më thënë që lidhet me këtë pikë. Rrjedhimisht kam kërkuar, të kryetari, që edhe vetë do ta sqaroj. Që subjektet politike të hiqen nga propozimi që do ta kemi në fund. Pra shoqatat humanitare, subjektet politike, të hiqen derisa të miratohet ligji i ri. Që ia jep të drejtën pastaj drejtpërdrejtë me ia dhënë subjekteve politike. Se si do ta bëjmë ne zgjidhjen! Sigurisht se bashkërisht, se është një diçka se të gjithëve na intereson. Dhe se këtu nuk është ideja këtu mi lënë partitë politike pa objekte. Po veç se ne duhet me marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. I nderuar prej viti 2012 ne, partitë politike të Prizrenit, objektet komunale jemi duke i shfrytëzuar në mënyrë joligjore, a qashtu po doni me ju thënë a. Dakord, jemi duke i shfrytëzua të gjitha partitë politike në mënyrë joligjore. Ne duhet me marrë një vendim ku këtë e shfuqizojmë si institucion. Sepse edhe nëse e lëmë, i

pazbatueshëm është. Bashkërisht do ta përgatisim këtë vendim. Mirëpo, kjo në formën se si është, më nuk mund të jetë në fuqi. Pavarësisht, se as mua nuk po më pëlqen definitivisht. Ideja është se a po e respektojmë institucionin ku edhe ne jemi pjesë e sajë.

**Alush Shala:** Nëse e shfuqizojmë këtë vendim dhe ne do të veprojmë dhe do të qëndrojmë nëpër objekte pa ligj, pa një vendim tjetër. Të lutëm është edhe në nderin tënd edhe në përgjegjësinë e juaj dhe të kryetarit. Të përpilohet një vendim tjetër, i cili do ta anashkalojë këtë ligjin dhe ne do ta votojmë. Ne kemi qenë edhe në KPF-ca. Nuk kemi qenë kundër. Por duhet së pari me na tregua se çfarë ligji. Por s'ka ligj, po thoni nuk është miratua akoma në Parlament. Po e presim atë le të miratohet. Na ngarkon me qira, na ngarkon. Po nëse e shfuqizojmë këtë, mendoj që ne do të rrimë ilegalisht pa asnjë vendim.

**Shukri Quni:** Nuk jemi ne këtu duke ndej ilegalisht, sepse është një vendim nga ish kryetari Eqrem Kryeziu, që është marrë më 29 dhjetor 2005, i vulosur dhe i nënshkruar. Bile me emblemën e vitit 1878 është vendimi i Eqrem Kryeziut, mos të harrojmë. E kështu që ky vendim le të rrinë qysh është. Kur ta bjen ti ligjin tjetër, atëherë marrim vendim tjetër. Mirë, prej vitit 2012, koka, po ti asnjëherë se ke qitë këtë në asamble. Qysh paske pranua ti me shkel ligjin atëherë. Edhe ti e ke partinë tënde pa kurrfarë pagese, 1 € paguan, a sa paguan nuk e di. Tash ku paska ndej ku më ditë sa. E tash i paskit ra në fije kësaj pune. Le të rrinë deri sa të vjen tjetri. Vendimi është, unë se di kolegët tjerë qysh po e presin këtë. Kur vendimi është. Unë nuk e kam dert dert a ke pare ti apo partia jem, me pagua atë. Hiq nuk jem te nije. Bile me mund ia marrë krejt. Sinqerisht e kam. Se këta nuk e meritojnë me qenë as parti. Po ky vendim është edhe që ky le të vazhdon derisa të vjen ligji tjetër. S'ka nevojë ne me shfuqizua këtë. Unë s'jam për atë.

**Kryesuesi:** Faleminderit, sigurisht se në fund Kuvendi e ka fjalën. Unë kam për obligim me pru një çështje që është ngritë në nivel të tillë të seriozitetit. Është vërejtje e auditorit. Tashmë vërejtja e auditorit të Kosovës, ka marrë më trajtat e seriozitetit. Edhe e kemi për obligim me pru në Kuvend këtu. Pastaj Kuvendi le ta thotë fjalën. Në fund të fundit Kuvendi përbëhet nga partitë politike, të cilat angazhohen dhe thirrën në interes publik. Edhe vendosin edhe për interes të vetin, po duhet me këqyrë pak edhe interesin publik, s'kemi çka me bo.

**Xhavit Uka:** Ne si LDK, jemi marrë vesh që pas pushimeve me pritë. Edhe me pritë ligjin e ri, pastaj do ta shohim si do të veprojmë.



**Sadije Osaj:** E patëm të njëjtin mendim, që me këtë pikë mos me u marrë hiq. Nëse ky vendim është në kundërshtim me ligjin, atëherë si e votuam, si nuk e votuam nuk ka rëndësi.

**Kryetari i komunës:** Ju e keni pas raportin e auditorit të përgjithshëm. Aty është vërejtje që ky vendim nuk është në rregull. Edhe mënyra se është marrë në shfrytëzim nga partitë politike, prona komunale nuk është në përputhje me ligjin. Po ajo ka qenë e bazuar në këtë vendim. Edhe kjo ka qenë arsyeja pse e kanë shti këtu. Po nëse shikoni realisht, ligji është mbi rregulloret e Kuvendit. Në momentin që ligji është mbi vendimet e Kuvendit, atëherë edhe s'keni nevojë edhe me votua. Po çështja është që është parashtrua, jo vetëm në raportin e fundit të auditorit po edhe në dy raportet paraprake. Do më thënë hera e tretë që po tërhiqet vërejtja nga auditori për shfrytëzimin e pronës komunale, nga ana e partive politike. Edhe pasi kjo është bo me këtë rregullore, e cila faktikisht tanimë është e vjetër, edhe e tejkaluar me ligin momental. Edhe ligji momental, edhe ligji i ardhshëm prapë ka me qenë njëjtë. Do më thënë kjo ka qenë arsyeja pse është qit këtu. Po fundi i fundit ju vendosni. Unë mendova që është detyrë që mi qit problemet që i ka komuna në aspektin e rekomandimeve të auditorit. Edhe me i adresua ato çështje. Njëra prej çështjeve që është kërkuar tre herë në raportet e fundit, është edhe çështja e partive politike. Ose pronës së përdorur nga partitë politike. Kjo është arsyeja.

**Fatmir Memaj, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm:** Në kohën kur është marrë ky vendim, realisht nuk ka qenë i pa ligjshëm. Mirëpo, me kalimin e kohës edhe me miratimin e ligjit të ri i cili është në fuqi për dhënie në këmbim të pronës komunale. Sigurisht që disa dispozita të atij vendimi janë në kundërshtim. Edhe pritet edhe me ligjin e ri ndoshta me qenë në kundërshtim. Shpresojmë që ligji i ri ti parasheh kompetencat e kryetarit. Edhe kështu që me pas mundësi me menaxhua me pronën në interes të partive politike. Mirëpo në këtë rast jam dakord me mendimin e shumicës së anëtarëve. Sepse nuk dua në votim. Po si u votua ky vendim për shfuqizim, si nuk u votua. Nëse është në kundërshtim me ligjin, ai është vetvetiu në kundërshtim. Prandaj, nuk e shoh të arsyeshme për ta votua tash në këtë seancë.

**Shukri Quni:** Në rast se është ky mbi ligjin, ose është ligji mbi Kuvendin. Unë nuk e di atëherë pse na bini vendimin këtu. Ty të kujtohet edhe Kujtimin kur i thosha shpeshherë, mos bjer vendime të cilat ligji është mbi ta. E ne me votua vetëm me një dorë. Në rast se ka mundësi këtu tash Sulltani me marrë edhe me pre me shpat, që kjo shkon në këtë mënyrë, pse po na qet me votua. Merre hiqe, s'është problem. Unë po të them këtu është vendimi i nënshkruar edhe i vulosur prej ish kryetarit. Edhe s'ka nevojë ne sot këtë punë

me marrë edhe me krye menjëherë. Pse po thotë kryetari, punë e madhe në rast se thotë. Nuk jemi bash qysh po ua marr mendja juve para viteve 1999 me diktate e sende. Mos harro krejt jemi të zgjedhur këtu prej dikujt. Edhe mos na bjer vendime të këtilla tjetër herë.

**Kryesuesi:** Nuk është kërkesë e kryetarit, është kërkesë ligjore, por sidoqoftë ky është vendim i Kuvendit. Edhe Kuvendi merr vendim për ose kundër. Kurse ligji është ligj, ajo është tjetër çështje. Atëherë po ia japim fjalën shefave të grupeve parlamentare një nga një le të deklarohen.

**Simir Krasniqi:** Ne si grup parlamentar i PDK-së, nuk e mbështesim deri në sjelljen e një ligji të ri për zgjidhjen e këtij problemi të vendimit.

**Adem Shabanaj:** LVV-je e mbështet.

**Xhavit Uka:** Ne si LDK abstenojmë.

**Fatmir Kastrati:** Po ashtu qysh diskutua, do më thënë e lëmë për ma vonë. Kur të aprovohet ligji i ri, shohim e bëjmë pastaj. Tash për tash nuk jemi për. Vërtetë është mirë ndoshta mos mu qit fare në votim, mos me qenë kundër ligjit ne. Se po bijmë në pozicion me qen kundër ligjit. Po pasi që është gjendja kësisoj. E lëmë për më vonë. Ne nuk do ta votojmë.

**Lirije Bytyqi:** Edhe ne Nisma Socialdemokrate e mbështesim.

**Sencar Karamuço:** Edhe ne do të abstenojmë.

**Memnuna Ajdini:** Tako e koalicioni Vakati o ekujemo da se preispita ovaj predlog. I bi emo uzdržani.

**Kryesuesi:** Atëherë 27 anëtarë të kuvendit jemi në sallë, e e hedh këtë propozimvendim në votim, dhe le të vendos Kuvendi. Kush është për shfuqizimin e vendimit?

Për – 8.

Kundër? – 10.

Abstenim? – 7.

Atëherë me 8 vota për, 10 kundër dhe 7 abstenim nuk shfuqizohet vendimi për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-4, të datës 29 dhjetor 2005.

**Pika e dhjetë:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimvendimit për shpalljen e ankandit-tenderit publik për dhënien në shfrytëzim-qira të objekteve dhe lokaleve pronë komunale.**

Për këtë qëllim ftoj sektorin e pronës, z. Gyrsel Skenderin, i cili do të na bëjë këtu një sqarim. Është një procedurë e përcaktuar me ligj. Lokaleve pronë komunale shumicë ju ka skaduar kontrata. Dhe sipas ligjit në fuqi ne duhet të marrim vendim, që atë listë të proceduar ta hedhim në procedura të ankandit.

**Gyrsel Skenderi, përfaqësues i Sektorit të Pronës:** Shfrytëzuesve momental, të lokaleve në pronë komunale nuk ju ka skaduar afati më fal kryesues, po ju skadon me 31 tetor 80% të lokaleve. Në bazë të ligjit, ligji përcakton se para procedurave për dhënien e pronave komunale të merret një vendim nga asambleja. Pas marrjes së vendimit atëherë komisioni për dhënën e pronës komunale i zhvillon procedurat dhe pas zhvillimit të procedurës i shpall fituesit e atyre për katër vite. Ne në bashkëpunim me juve edhe me kryetarin, është përcaktuar që afati i fundit i shfrytëzimi të jetë më 31.12.2022. Që mos të jetë që ndonjë lokal të ndonjë lokal afat më të shkurtë, po të gjithë skadimi i afatit të kontratës, të ju skadojë më 31.12.2022. Edhe njëherë po them në bazë të nenit 7 të ligjit në zbatim me rregulloren neni 5 të Udhëzimit administrativ, duhet së pari të merret vendim, mandej të zhvillohen procedurat për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim. Listën e keni ku gjenet hapësirat.

**Xhavit Uka:** Unë s' di si mundeni me ia ndërpre kontratën njerëzit të cilët janë nëpër objekte, pa i kalua afati. Ose sqaroni pak më mirë, më ndryshe.

**Kryesuesi:** Po sqarimin e bëri Gyrseli. Ndoshta unë ishe i gabuar. Do të thotë kontrata ju skadon pasi ne të marrim vendim për mi qua në ankand publik. Dhe në momentin që i skadon. Komisioni që e votuam në Kuvend këtu, mbledhet edhe e kryen atë procedurë dhe vazhdon procedura pastaj në momentin kur t'ju skadon kontrata. Definitivisht po, se atëherë i bije shkëputje e hershme. Besoj se Gyrseli e sqaroi dhe se ishte gabim i imi.

**Alush Shala:** Unë kam qenë pjesë e këtij komisioni, dhe kjo nuk është diçka risi. Po kjo duhet me ndodh. Por unë kam një kërkesë, po flas personale, se s'po flas në emër të grupit. Të gjithë kontraktorët ata të pronave të komunës që kanë qenë të ndërgjegjshëm, dhe që kanë bërë investime, unë jo vetëm që jam për me i lejua mi qit në ankand. Unë personalisht jam për me i lejua. Por edhe jam për me dëmtua asnjë nga ata. Po flasim gjatë qeverisjes së PDK-së, kemi pas edhe biznesmenë të dëmtuar dhe nuk e kemi marrë parasysh. Është mirë që edhe komisioni që është i themeluar ta ketë parasysh. Po edhe ju si kryesues dhe kryetari i komunës, ti keni parasysh njerëzit që kanë qenë të ndërgjegjshëm. E kanë mbajtur, kanë investua. Duhet të kenë ata pak përparësi, gjithmonë bazuar në ligj.

**Shukri Quni:** Kryesues, a i keni shpall të gjitha lokalet, apo ku keni gjet më butë, aty keni shkua ndoshta i keni shpallë. Ata tjerët që s'keni guxua ndoshta si keni prek. Kështu që gjithnjë pëson ai i dobëti. Se unë për veti shyqyr për veti, as vet po as farefis nuk kam që kanë lokale këtu. Po zakonisht shkojnë te ata të cilët nuk e kanë dikë, ose janë më të rregullt që i paguajnë këto. Edhe kështu që i shpallin këto edhe i marrin dikush tjetër, që ndoshta nuk e meriton. Për këtë po pyes unë tash, a janë për të gjithë, a janë vetëm për ata që nuk kanë fuqi me mbrojt qatë lokal. Se e pash duke i mbledh karriget në Shatërvan. S'qenka këtu drejtori tash, po patjetër po duhet me thënë. Se qëndrova rastësisht në Therandë. Andej i mblidheshin, karrige në Therandë s'kishin kah me kalua për rreth kerreve, kështu që krejt trotuari ishte zënë. E kështu që mos të shkojmë vetëm ata të dobëtit ti shkelim. Po në rast se merret vendim le të merret vendim për të gjithë edhe le të qiten krejt. Edhe në rast se është kjo që deri më 31 dhjetor kanë kontratë. A tetor ke a. Unë mendova që deri më 31 dhjetor. Më fal pra.

**Kryesuesi:** Na ka ardhur neve një listë që është me prona komunale dhe të gjitha ato do të dërgohen në procedurë të ankandit. I fort e i but të gjitha. Edhe njëherë po e sqaroj. Kam kërkuar që vetëm partitë politike të hiqen. Se jeni duke menduar që po dojmë me ju qit prej zyrave, jo. Kam kërkuar që partitë politike të hiqen, që të shkojnë në ankand publik. Edhe kam kërkuar organizatat humanitare. P.sh. është strehimorja e grave, shoqata sindrom down. E keni listën aty, ka qenë dashtë mi pa ju materialet. Këto deri që të miratohet që ky ligji që po e diskutojmë. Se përndryshe i bije mi qit prej aty. Por lokalet të cilat janë shfrytëzua, nëse s'gaboj z. Gyrsel më korrigjo. Që janë shfrytëzua për qëllime afariste biznisore dhe veprimtari profitabile me quajt kështu. Të gjitha do të shkojnë në ankand publik, sepse na thotë edhe ligji, nuk kemi çka me bo të kundërtën.

**Petrit Hoxhaj:** Këtu jam duke i vërejtur numër 7 edhe 11 që janë këto lokale bashkëpronësi. Qysh është mënyra e këtyre me bashkëpronësi. Nëse ka mundësi një shpjegim. Dhe kush e merr qiranë prej këtyre dy lokaleve.

**Gyrsel Skenderi:** Po janë dy lokale me bashkëpronësi. Banka BKT, dhe është një lokal te Xhamia e Sinan Pashës. Zakonisht edhe këto i kemi qit. Komisioni i kaluar i ka bërë të gjitha procedurat dhe jemi marrë vesh. Asnjë vërejtje nuk e ka pas prej auditorit. Shumë komision profesional ka qenë. Edhe për këto me bashkëpronësi fillimi i qirasë ka me qenë sikur për këto lokalet që nuk kanë bashkëpronësi. Po këto dy lokale BKT, që është përball Beskës edhe lokali te Xhamia e Sinan Pashës 8.75 metër katror. Edhe këto e kanë çmimin fillestar.

**Kryesuesi:** Nëse nuk ka edhe dikush tjetër, atëherë 25 anëtarë të Kuvendit janë në sallë, e hedhim këtë propozimvendim në votim, me sqarimet që i dha Sektori i Pronës, kush është për?

Të gjithë.

Kundër? – S’ka.

Abstenime? – S’ka.

Atëherë konstatoj se unanimisht është miratua propozimvendimi për shpalljen e ankandit-tenderit publik për dhënien në shfrytëzim-qira të objekteve dhe lokaleve pronë komunale.

**Pika e njëmbëdhjetë:**

**Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës, Nr. 001/011-96211, të datës 28 qershor 2018, sipas rekomandimeve të MMPH-së.**

E ftoj drejtorin e Urbanizimit që ta marr fjalën. Një korigjim, tek pika e nëntë, kanë qenë 8 vota për, 11 kundër dhe 8 abstenime. Veç një përmirësim, që të regjistrohet në procesverbal. Drejtor fjala është e juaja.

**Fatmir Memaj, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm:** Në seancën e kaluar në fakt një zyrtare nga Drejtoria e jonë e ka arsyetua këtë vendimin e kaluar. Mirëpo është e vërtetë që kemi mbet mangu me disa pjesë teknike. Për shkak të mos njohurive tona sepse nuk kemi qenë të informuar deri më tani zyrtarisht për daljen e një udhëzimi administrativ në ndërkohë, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Dhe në këtë rast Ministria gjatë shqyrtimit të këtij vendimi, ka rekomandua edhe ka sugjerime se si duhet të plotësohet në preambulë dhe forma e këtij vendimi. Në qoftë se dëshirojnë anëtarët e Kuvendit e lexoi propozimvendimin e tërësishëm. Do më thënë ka të bëjë vetëm me aspektin teknik. Nuk ka të bëjë me përmbajtjen. Përmbajtja është esencialisht e njëjtë, përveç formës që janë ndryshua me renditje edhe me forma ashtu siç e kërkon një standardë i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Prandaj ka të bëjë me pjesën e parkut që e quajmë tash parku i trajnimit dhe inovacionit. Në hapësirat e ish kazermës së KFOR-it. Kërkoj mirëkuptimin e juaj.

**Simir Krasniqi:** Ne si grup parlamentar i PDK-së e mbështesim. Po tjera herë mos me na pru vendime dy herë. Pritni ligjet kur të dalin, se për një javë apo dhjetë nuk po shihet e rrugës që dy herë ti votojmë ligjet. Edhe pse ndërkohë tha që ka dal ky udhëzim administrativ. Në qoftë se Ministria ndoshta



paralajmëron më herët që ky udhëzim do të del që mos ti votojmë dy herë. Po e mbështesim.

**Kryesuesi:** Jo, kjo ka qenë shqyrtimi i ligjshmërisë, qysh e bënë çdo herë ministria edhe ka kërkuar që mu plotësua me këto kërkesa. Është procedurë e rregullt.

**LVV:** Edhe LVV-je e mbështet këtë.

**Xhavit Uka:** Edhe LDK e mbështet.

**Fatmir Kastrati:** Edhe ne do ta mbështesim.

**Lirija Bytyqi:** Edhe ne Nisma Socialdemokrate e përkrahim, e mbështesim.

**Sencar Karamuço:** Edhe ne do ta mbështesim.

**Memnuna Ajdini:** Tako e koalicioni Vakrat poddržava.

**Kryesuesi:** NDS, sqenka. Nëse s'ka dikush tjetër çka me shtua, atëherë 25 anëtarë janë prezentë, e hedh në votim, kush është për?

Të gjithë.

Kundër? - S'ka.

Abstenim? – S'ka.

Atëherë konstatoj se unanimisht aprovohet rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës, Nr. 001/011-96211, të datës 28 qershor 2018, sipas rekomandimeve të MMPH-së.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit ju falënderoj për pjesëmarrje. Në gusht e kemi pushim. Dhe mirupafshim në shtator në seanca të reja.

Përfundoi në orën 15:50.

Procesmbajtës;  
Sehat Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit  
Artan Abrashi

